



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit /
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of
Education, Science, Technology and Innovation*

**KATALOGU I PROGRAMEVE TË AKREDITUARA DHE
TË APROVUARA PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË
MËSIMDHËNËSVE DHE UDHËHEQËSVE TË
ARSIMIT**

EDICIONI I PESTË

Prishtinë, 2021

Botues:

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

Përgatitur nga:

Luan Sahitaj

Habibe Buzuku

Dizajni:

**Katalogu i programeve të akredituara/të njohura nga MASHT-i për
zhvillim profesional të mësimeve dhe udhëheqësve të arsimit
është në dispozicion**

për shkarkim në uebfaqe të MASHT-it: <http://www.masht.gov.net>

Titujt e programeve të aprovuara të katalogut të edicionit të pestë 2021 për
Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Udhëheqësve të Arsimit

1.“Përgatitja e Edukatorëve Parafillor për Përkrahjen dhe Zhvillimin e Potencialit të Fëmijëve përmes Lojës dhe Kreativitetit”	9
2.Ciklet e trajnimeve modulare për mësimdhënësit e AAP në lëmin e mekatronikës	12
3.Ciklet e trajnimeve modulare për mësimdhënësit e AAP në lëmin e teknikës dhe ndërtimtaris.....	15
4.Edukimi muzikor dhe aspekte të rëndësishme në procesin e mësimdhënies së integruar/diferencuar	18
Menaxhimi i stresit tek nxënësit pas Pandemise COVID-19, veprimet parandaluese të atakimit të jetës	21
5.Metodologjia e mësimdhënies në seksion muzikorë instrumental.....	25
Pedagogjia e Edukimit Psiko-Fizik dhe Shëndetësor	29
6.Planifikimi sipas nevojave të nxënësit (nxënës me nevoja të veçanta). Hartimi i planit individual të edukimit (PEI) për nxënës me AK	32
<u>7.Qasja dhe mësimdhënia e diferencuar për fëmijët me nevoja të veçanta.....</u>	<u>34</u>
8.Zhvillimi i të menduarit kritik dhe kreativ tek nxënësit në arsimin fillor.....	37
9.GJITHËPËRFSHIRJA DHE INDIVIDUALIZIMI I MËSIMIT PËR NXËNËS ME NEVOJA TË VEÇANTA (PIA).....	39
10.APLIKIMI I PROGRAMEVE ONLINE NË SIGURIMIN E CILËSISË NË MËSIMDHËNIE	41
11.Puna e kujdestarit të klasës – Kujdestari i mirë.....	43
12.Zbatimi i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës.....	48
13.Vlerësimi i leximit në klasat e hershme – A-EGRA.....	50
14.Integrimi i edukimit për qëndrueshmëri në klasa.....	52
15.Vlerësimi përmbledhës i nxënësve: Hartimi i testit.....	54
16.Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore.....	56

17.Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie.....	59
18.Mësimdhënia dhe të nxëniet e shkencave natyrore në klasat 1-5.....	61
19.Metodologjia Montessori për edukimin në fëmijërinë e hershme (mosha 0-6 vjeç).....	63
20.Mentorimi i studentëve gjatë praktikës pedagogjike.....	65
21.Mentorimi kolegjal në arsim.....	67
22.Bazat e bashkëpunimit online.....	69
23.Bazat e kompjuterit.....	71
24.Bazat e të dhënave.....	73
25.Kalkulimi i tabelave	75
26.Komunikimi elektronik.....	77
27.Përpunimi i teksteve.....	79
28.Prezantimet	81
29.Programi për projekte	83
30.Siguria në TI	85
31.Mbrojtja e Fëmijëve nga abuzimi	87
32.Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve.....	90
33.Shkathtësitë e buta në kurrikulin shkollor	92
34.Y – RINIA.....	94
<i>35.Metodologjia me nxënësin në qendër dhe menaxhimi gjithëpërfshirës i klasës</i>	<i>97</i>
36.Mësimdhënia në distance.....	101
37.Metodologjia me nxënësin në qendër	104
38.Qasja për Zhvillim të Integruar të Shkollës.....	107
40.BASHKËPUNIMI CILËSOR EDUKATOR - PRIND NË INSTITUCIONE EDUKATIVE	
---	112
41.Metodologjitë e reja në mësimdhënie.....	113
42.Mësimdhënia me teknologji informative.....	115

43.Edukimi Inkluziv/ Gjithëpërfshirës.....	117
44.Bashkëpunimi me prinder dhe komunitet.....	119
45.Hartimi i Planit Individual te Arsimit –PIA.....	122
47.Parandalimi i dhunës ne shkollë.....	125
48.Vizioni dhe konceptet e arsimit gjithëpërfshirës, puna e përbashkët dhe mjediset e ndihmojnë të nxënësit të individualizuar.....	127
49. Identifikimi i nxënësve me vështirësi në shkrim e lexim dhe ofrimi i mbështetjes për tejkalimin e vështirësive.....	130
50.Mbrojtja e shëndetit mendor të fëmijëve përmes programeve psiko-pedagogjike në vendet e prekura nga varfëria”.....	132
51.“Ndihmë fëmijëve me vështirësi specifike në mësim dhe fëmijëve me nevojë të veçanta”.....	134
52.Edukimi për të drejtat e fëmijëve “Të drejtat tona”.....	136
53.Qasja metodologjike në mësimdhënien e gjuhës angleze përmes hulumtimit në veprim.....	138
54.Komuniteti i të nxënësit demokratik dhe gjithëpërfshirës.....	140
55.Ngritja e Kapaciteteve për Arsim Gjithëpërfshirës.....	143
Moduli I : Aftësia e kufizuar dhe arsimi gjithëpërfshirës	
56.MENAXHIMI I KLASËS DHE DISPLINA.....	146
57.IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE SHËNDETËSORE TË FËMIJËVE NË KOPSHT DHE NË SHKOLLË.....	148
58.TË MËSUARIT PËRMES TEKNOLOGJISË – PËRDORIMI I PROGRAMEVE APLIKATIVE	151
59.Lions Quest -Shprehjet për adoleshencën.....	154
60.MENAXHIMI I CILËSISË NË SHKOLLË.....	158
61. Identifikimi, parandalimi dhe trajtimi i llojeve të dhunës në shkollë	162
62.Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie.....	164
63.Të mësuarit e kombinuar (BLENDED LEARNING).....	169

64.Zhvillimi dhe edukimi praktik- fëmijë të suksesshëm.....	172
65.Zhvillimi i shkollës me vizion dhe strategji dhe menaxhimi i ndryshimit.....	176
66.Administrim, Menaxhim dhe Udhëheqje në Arsim.....	179
67.Vlerësimi i nxënësve bazuar në dëshmi	182
68.Kujdesi dhe zhvillimi gjatë fëmijërisë së hershme.....	185
69.Disiplina Pozitive në Mësimdhënien e Përditshme.....	189
70.Planifikimi dhe Udhëheqja Strategjike në Arsimin Parauniversitar.....	191
71.Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm-----	193
72.Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie.....	195
73.Edukimi dhe menaxhimi mjedisor ne Arsimin Parauniversitar.....	197
74.Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës.....	199
75.Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik.....	203
76.Roli i aktiviteteve kreative ne mesimdhënie dhe zbatimi i tyre ne shkolla fillore.....	206
77.Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social.....	208
78.Sigurimi i cilësisë në shkollat e AAP-së.....	210
79.Programi për Autonomi dhe Aftësim Profesional.....	213
80.Programi i Intervenimit dhe Edukimit të Hershëm.....	215
81.Përgatitje Profesionale të Mësimdhënësve-Lider.....	217
82. CBET – Udhëzues virtual për praktikuesit e AAP-së	219
83.VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SHKOLLËS.....	222
84.Përdorimi dhe përshtatja e teknologjisë informative për të verbër”	225
85.“Plani individual i arsimit”	227
86.“Trajnimi për orientim dhe mobilitet”	229
87.“Intervenimi i hershëm të fëmijët e verbër dhe me dëmtime pamore”	231
88.“Gjithpërfshirja në sistemin arsimor në Kosovë, integrimi i fëmijëve të verbër”	233
“Mësimi i shkrimit braj”	235
89.Y – RINIA.....	237
90.Abuzimi i fëmijëve; Roli i mësimdhënësve në identifikim, raportim dhe përkrahje.....	240

91.Bazat e sigurisë në teknologjinë informative.....	243
92.Bazat e sigurisë së të dhënave.....	245
93.Gjuhë angleze.....	247
95.Instrumentet bashkëkohore të teknologjisë në edukim.....	250
96.Integrimi i shkathtësive të buta në mësimdhënie I.....	253
97.Integrimi i shkathtësive të buta në mësimdhënie II.....	256
98.Inteligenca e shumëfishte tek fëmijët.....	259
99.Menaxhimi efektiv në klasë.....	262
100.Menaxhimi i Projekteve	264
101.Mësimdhënia e aftësive të shekullit XXI.....	266
102.Mësimi online.....	268
103.Motivimi i adoleshentëve dhe sfidat në edukim.....	272
104.Nxënës të ndryshëm dhe nevoja të ndryshme të të nxënës gjatë procesit të mësimdhënies	275
105.Orientimi në karrierë dhe zhvillimi profesional.....	278
105.Prezantimi profesional.....	280
107.Qasja e mësimdhënësve tek fëmijët me nevoja të veçanta.....	283
108.hkrimi akademik në shkollë.....	286
109.Të mësuarit përmes projekteve.....	289
110.Të nxënës bashkëveprues përmes kompjuterit.....	291
111.Zhvillimi kognitiv dhe social i fëmijëve të moshave 3-6.....	296
112.Zhvillimi kognitiv dhe social i fëmijëve të moshave 6-12.....	297
113.PLAYDAGOGY– Shkollimi i Suksesshëm.....	300
114.“Trajtimi i stereotipave dhe diskriminimit: Kultivimi i pranimi dhe gjithë përfshirjes”	303
115.UDHEZUES PËR ZBATIM TË KURRIKULES.....	306

HYRJE

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në përputhje me UA 04/2010 dhe UA 06/2017 për kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillim

profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimor, ka akredituar ofertuesit dhe aprovuar programet për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Bazuar në të dhënat në dispozicion të MASHTI-, përkatësisht Divizionit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve, është përgatitur botimi i katalogut të programeve trajnuese. Në këtë katalog janë përfshirë ofertuesit e akredituar dhe programet e aprovuara në vitin 2021.

Katalogu ofron një përshkrim të përgjithshëm të ofertuesve të programeve trajnuese duke përfshirë kontaktin dhe adresën e tyre. Ndërsa, programet trajnuese të secilit ofertues janë përshkruar në mënyrë më specifike, sipas formularit të caktuar nga MASHTI dhe të plotësuar nga ofertuesit e programit. *Përshkrimi i programeve përmban: tipin e programit, ofertuesin, kohëzgjatjen, përfituesit, rezultatet e pritura, përmbajtjen, metodologjinë dhe procesin e certifikimit, numrin e trajnerëve dhe datën e aplikimit.* Të gjitha këto informacione janë të rëndësishme sepse me rastin e licencimit, rilicencimit apo avancimit në karrierë, mësimdhënësit duhet të ofrojnë dëshmi për përfundimin me sukses të programeve themelore dhe atyre plotësuese për zhvillim profesional.

Kërkesat dhe kriteret për përfundimin me sukses të trajnimeve në programe bazike apo plotësuese janë përcaktuar me UA 05/2017 për sistemin e licencimit dhe zhvillimin në karrierë të mësimdhënësve. Përmbajtja e programeve të trajnimit do të ndihmojë mësimdhënësit të identifikojnë programet, vijueshmëria e të cilave do të ndihmojë ata/o të avancohen gjatë karrieres dhe të arrijnë standardet e mësimdhënies të përcaktuara me *Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë 2017*. Përfundimi me suksese i programeve themelore dhe plotësuese do të ndikojë në rritjen e nivelit të performancës së mësimdhënësve.

Titulli i Programit	“Përgatitja e Edukatorëve Parafillor për Përkrahjen dhe Zhvillimin e Potencialit të Fëmijëve përmes Lojës dhe Kreativitetit”
Titulli i organizatës	Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe Caritasi Zviceran në Kosovë
Tipi i programit:	Program themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe Caritasi Zviceran në Kosovë
Adresa:	Musine Kokalari nr. 83, Prishtinë
E-mail:	nezir.cocaj@rks-gov.net
Telefoni:	+38345210073
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 47/2021 Dt. 19.05.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	58 orë
Përfituesit:	Edukatorët parafillorë Në kuadër të Projektit SHPRESE është paraparë që të trajnohen 28 grupe të edukatorëve parafillorë nga komuna të ndryshme të Kosovës, ku në një grup planifikohet të këtë 22-25 edukatore , apo gjithsej 700 edukatore pritet të marrin pjesë në këtë program të trajnimit.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 pjesëmarrës për një grup trajnimi
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Trajnimi ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të edukatorëve për punë cilësore dhe kreative me fëmijë parafillor, bazuar në teori dhe praktika të avancuara për zhvillimin e potencialit të fëmijëve parafillor përmes lojës dhe kreativitetit. Rezultatet që priten nga programi i trajnimit. Në përfundim të programit të trajnimit edukatorët pjesëmarrës në trajnim do të jenë në gjendje të: ▪ shpjegojnë konstruktin shumëdimensional të lojës për zhvillimin e potencialit të fëmijëve; ▪ zhvillojnë plane mësimore që përfshijnë lojërat për t'i ndihmuar fëmijët që të jenë të suksesshëm në rutina; ▪ praktikojnë mësimin përmes lojës, kreativitetit dhe didaktikës; ▪ identifikojnë komponentët e mjedisit mësimor që i ndihmon fëmijët të ndihen të sigurt, të rehatshëm, të mirëpritur dhe të gatshëm për të mësuar dhe eksploruar; ▪ demonstrojnë strategji të ndryshme për krijimin e një mjedisi pozitiv;

	▪ përgatisin dhe përdorin materiale dhe mjetet didaktike kreative dhe praktike në punën me fëmijë parafillor; ▪ përdorin instrumente të ndryshme konceptuale për ta menaxhuar grupin e fëmijëve me të cilët punojnë; ▪ përdorin takimet në grup me të gjithë fëmijët si mundësi thelbësore për t'i zgjidhur konfliktet ose vështirësitë brenda grupit; ▪ krijojnë instrumente vëzhgimi për vlerësim për të nxënë/vlerësim formativ; ▪ përdorin rezultatet e vëzhgimeve në funksion të rezultateve të nxënës dhe përzgjedhjes së aktiviteteve për zhvillimin e potencialit të fëmijëve; etj.		
Përmbajtja:	Programi i trajnimit	Temat kryesore	Kohëzgjatja
	Moduli 1	Mësimi përmes lojës, kreativitetit dhe didaktikës	12 orë
	Moduli 2	Mjedisi mësimor, materialet dhe mjetet didaktike	12 orë
	Moduli 3	Menaxhimi i kohës, menaxhimi i grupit, marrëdhëniet	12 orë
	Moduli 4	Vëzhgimi dhe vlerësimi për të nxënë	12 orë
	Monitorim dhe mentorim		2 orë
	Përgatitja e Portfolios		8 orë
	Gjithsej		58 orë
	Ky program trajnimi është i strukturuar në katër module, ku secili modul zgjat dy ditë. Pra 8 ditë gjithsej nga 6 orë për një ditë. Programi gjithashtu shoqërohet me seanca monitorimi dhe mentorimi dhe përgatitje dhe vlerësim të portfolios me detyra që dalin nga programi trajnues. 48 orë trajnimi 2 orë monitorim dhe mentorim: (minimum një (1) seancë e plotë prej dy (2) orësh për një edukator). 8 orë për përgatitjen e detyrave të cilat bëhen pjesë e portfolios.		
Metodat e realizimit të programit	Sesionet e trajnimit për secilin modul, janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, lojë me role, mësim përmes lojës, punë në grupe, ndërveprim, video prezantimeve, demonstrim dhe aktivitete atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete në kuadër të programit të trajnimit. Elementi kryesor i metodologjisë së punës së edukatorëve parafillor në këtë program të trajnimit, është lidhja e teorisë me praktikën edukative, me fokus të veçantë në aktivitete praktike. Trajnerët e programit janë përgatitur që të		

	përdorin forma dhe metoda të trajnimit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë e vijuesve, por edhe shkathtësitë praktike dhe qëndrimet e tyre për proceset që lidhen me zhvillimin e potencialit të fëmijëve parafillor përmes lojës dhe kreativitetit. Pjesë e metodologjisë për ofrimin e programit të trajnimit, janë: aktivitetet praktike, prezantime në Power-Point për secilin modul, ligjërata, punë në grupe, prezantime, video prezantime, diskutime, reflektim, detyra praktike për përgatitje dhe realizim në vendin e punës.
Certifikimi	Certifikatat lëshohen pas përfundimit me sukses të programit të trajnimit, bazuar në kriteret e certifikimit të programit. Kriteret e kalueshmërisë në formë të përmbledhur: 1. Pjesëmarrja e rregullt/aktive 90 % ose 7 ditë trajnimi 2. Vlerësimet dalëse të moduleve mbi 50 % për secilin modul 3. Portfolio 12 nga 17 detyrat e dhëna Rrjedhimisht, programi i trajnimit ka gjithsej 58 orë për certifikim.
Trajner	Trajnimet ofrohen nga 10 Master Trajnerë që janë trajnuar nga Caritasi Zviceran në Kosovë në bashkëpunim me Institutin Pedagogjik të Kosovës dhe ekspertë të jashtëm dhe të brendshëm dhe po ashtu janë të certifikuar edhe nga MASHTI. Prej tyre, 6 trajnerë janë nga IPK dhe 4 trajnerë të jashtëm, me përvojë në fushën e edukimit parafillor. Trajnerët: 1. Agim Bujari 2. Arbnesha Mexhuani 3. Delvina Hajdari 4. Lirije Bytyqi Beqiri 5. Mevlude Aliu Gashi 6. Sahare Recica Havolli 7. Shpetim Azemi 8. Valona Gashi 9. Valdete Spahiu Çollaku 10. Zehrije Plakolli
Data	Trajnimet do të ofrohen në raunde të ndara, secili raund me nga 5 komuna të ndryshme të Kosovës dhe do të zgjasin deri në Prill/Maj të vitit 2022.

Titulli i Programit	Ciklet e trajnimeve modulare për mësimdhënësit e AAP në lëmin e mekatronikës
Titulli i organizatës	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Tipi i programit:	Trajnim/ ZHPM
Ofertuesi i programit:	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Adresa:	Gazmend Zajmi No 24, Prishtinë, Kosovë
E-mail:	edona.nahi@giz.de
Telefoni:	+383 38 233002-610
Numrat dhe data e aprovimit:	26/ 2021 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	480 orë pune
Përfituesit:	Mësimdhënësit e shkollave profesionale
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	1. Edukimi integruar i mësimdhënësve në Arsimin Profesional me elemente teorike, praktike, metodologjike si dhe organizative. 2. Përmirësimi i qëndrueshmërisë së edukimit përmes mbikëqyrjes dhe mbështetjes së pjesëmarrësve të seminareve në një infrastrukturë të “mësimi të kombinuar” para dhe pas moduleve të trajnimit. 3. Edukimi profesional i orientuar drejt kërkesave, të përshtatura kërkesave dinamike të ndryshimit të ndërmarrjeve si dhe kërkesave ligjore 4. Prezantimi dhe thellimi i metodave praktike të mësimdhënies dhe të edukimit të orientuara drejt praktikës në lidhje me situatat profesionale vepruese në ndërmarrje. 5. Integrimi i elementeve në organizimin e laboratorit dhe

	punëtorisë për përdorim më të mirë të objekteve të edukimit.
Përmbajtja:	Në kuadër të 2 moduleve (moduli i parë dhe i tretë), do të punohet në objektet e edukimit të mësuesve në Kosovë, për të mundësuar kështu zbatimin dhe shfrytëzimin e drejtpërdrejtë të koncepteve të zhvilluara të mësimdhënies. Zbatimi i modulit 2 zhvillohet në një institucion gjerman të edukimit. Me këtë dhe me vizitat shoqëruese të institucioneve qendrore të arsimit dual, pjesëmarrësve u ofrohet një pasqyrë në sistemin e aftësimit profesional gjerman. Modulet e seminareve janë sistematikisht të orientuara drejt koncepteve të edukimit të orientuara drejt veprimit me detyra përkatëse të punës nga fusha profesionale. Strukturimi i situatave të të mësuarit tipik për punë bëhet përmes moduleve me një rritje në kompleksitet dhe fushëveprim: Moduli 1: Të mësuarit dhe detyrat e punës me kompleksitet dhe fushëveprim të kufizuar Moduli 2: Të mësuarit si detyra të projekteve me kompleksitet dhe fushëveprim të mesëm Moduli 3: Të mësuarit si detyra të kllentit me kompleksitet dhe fushëveprim të lartë Moduli 4: Projekte të të mësuarit të bashkëpunimit me kompleksitet dhe fushëveprim të lartë Në fund të të gjitha moduleve, do të dakordohen detyrat e punës me pjesëmarrësit, për të përshtatur, testuar dhe dokumentuar përmbajtjet e trajnimit të mëtejshëm teknikisht dhe metodikisht në mjedisin e tyre të punës. Për njohjen dhe certifikimin e serive të seminareve, në fund do të kryhet një ekzaminim përfundimtar si vlerësim i projektit. Pjesët e vlerësimit të projektit janë dokumentacioni i projektit, prezantimi dhe diskutimi i ekspertëve. Subjekti i projektit të provimit është zakonisht planifikimi, ekzekutimi dhe vlerësimi i një sekuence mësimore
Metodat e realizimit të programit	Të mësuarit dhe detyrat e punës → Detyrat e projektit → Detyrat e

	klientit → Bashkëpunimet e vendeve të mësim Edukimi i orientuar drejt veprimeve • Rënja e udhëheqjes dhe drejtimi nga instruktorët. • Rritja e përgjegjësisë dhe kompleksitetit të detyrave për të trajnuarit. Të mësuarit dhe detyrat e punës - Planifikimi, ekzekutimi, vlerësimi Detyrat e projektit - Analiza, mbledhja e informacioneve, planifikimi, ekzekutimi, testimi (dokumentacioni) Detyrat e klientit - Analiza, mbledhja e informacioneve, planifikimi, përlllogaritja, ekzekutimi, testimi, dokumentimi, prezantimi Seria e trajnimit është planifikuar me 480 orë pune me ndarje të punës si në vijim: 3 Seminare nga 2 javë ($3 \times 2 \times 40h$) = 240h 10 x 0,5 ditë mësim virtual = 40h 10 x 0,5 ditë Moderim/Lifecat = 40h + 160h për zbatimin e detyrave të punës = 160h
Certifikimi	Për njohjen dhe certifikimin e serive të seminareve, në fund do të kryhet një ekzaminim përfundimtar si vlerësim i projektit. Pjesët e vlerësimit të projektit janë dokumentacioni i projektit, prezantimi dhe diskutimi i ekspertëve. Subjekti i projektit të provimit është zakonisht planifikimi, ekzekutimi dhe vlerësimi i një sekuence mësimore
Trajner	Grup ekspertësh
Data	16.11.2021

Titulli i Programit	Ciklet e trajnimeve modulare për mësimdhënësit e AAP në lëmin e teknikës dhe ndertimtarisë
Titulli i organizatës	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Tipi i programit:	Trajnim/ ZHPM
Ofertuesi i programit:	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Adresa:	Gazmend Zajmi No 24, Prishtinë, Kosovë
E-mail:	edona.nahi@giz.de
Telefoni:	+383 38 233002-610
Numrat dhe data e aprovimit:	26/ 2021 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	480 orë pune
Përfituesit:	Mësimdhënësit e shkollave profesionale
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	1. Edukimi integruar i mësimdhënësve në Arsimin Profesional me elemente teorike, praktike, metodologjike si dhe organizative. 2. Përmirësimi i qëndrueshmërisë së edukimit përmes mbikëqyrjes dhe mbështetjes së pjesëmarrësve të seminareve në një infrastrukturë të “mësimit të kombinuar” para dhe pas moduleve të trajnimit. 3. Edukimi profesional i orientuar drejt kërkesave, të përshtatura kërkesave dinamike të ndryshimit të ndërmarrjeve si dhe kërkesave ligjore. 4. Prezantimi dhe thellimi i metodave praktike të mësimdhënies dhe të edukimit të orientuara drejt praktikës në lidhje me situatat profesionale vepruese në ndërmarrje. 5. Integrimi i elementeve në organizimin e laboratorit dhe punëtorisë për përdorim më të mirë të objekteve të edukimit.

Përmbajtja:	Në kuadër të 2 moduleve (moduli i parë dhe i tretë), do të punohet në objektet e edukimit të mësuesve në Kosovë, për të mundësuar kështu zbatimin dhe shfrytëzimin e drejtpërdrejtë të koncepteve të zhvilluara të mësimdhënies. Zbatimi i modulit 2 zhvillohet në një institucion gjerman të edukimit. Me këtë dhe me vizitat shoqëruese të institucioneve qendrore të arsimit dual, pjesëmarrësve u ofrohet një pasqyrë në sistemin e aftësimit profesional gjerman. Modulet e seminareve janë sistematikisht të orientuara drejt koncepteve të edukimit të orientuara drejt veprimit me detyra përkatëse të punës nga fusha profesionale. Strukturimi i situatave të të mësuarit tipik për punë bëhet përmes moduleve me një rritje në kompleksitet dhe fushëveprim: Moduli 1: Të mësuarit dhe detyrat e punës me kompleksitet dhe fushëveprim të kufizuar Moduli 2: Të mësuarit si detyra të projekteve me kompleksitet dhe fushëveprim të mesëm Moduli 3: Të mësuarit si detyra të klientit me kompleksitet dhe fushëveprim të lartë Moduli 4: Projekte të të mësuarit të bashkëpunimit me kompleksitet dhe fushëveprim të lartë Në fund të të gjitha moduleve, do të dakordohen detyrat e punës me pjesëmarrësit, për të përshtatur, testuar dhe dokumentuar përmbajtjet e trajnimit të mëtejshëm teknikisht dhe metodikisht në mjedisin e tyre të punës. Për njohjen dhe certifikimin e serive të seminareve, në fund do të kryhet një ekzaminim përfundimtar si vlerësim i projektit. Pjesët e vlerësimit të projektit janë dokumentacioni i projektit, prezantimi dhe diskutimi i ekspertëve. Subjekti i projektit të provimit është zakonisht planifikimi, ekzekutimi dhe vlerësimi i një sekuence mësimore
Metodat e realizimit të programit	Të mësuarit dhe detyrat e punës → Detyrat e projektit → Detyrat e klientit →

	Bashkëpunimet e vendeve të mësim Edukimi i orientuar drejt veprimeve • Rënja e udhëheqjes dhe drejtimi nga instruktorët • Rritja e përgjegjësisë dhe kompleksitetit të detyrave për të trajnuarit Të mësuarit dhe detyrat e punës – Planifikimi, ekzekutimi, vlerësimi Detyrat e projektit - Analiza, mbledhja e informacioneve, planifikimi, ekzekutimi, testimi (dokumentacioni) Detyrat e klientit - Analiza, mbledhja e informacioneve, planifikimi, përlllogaritja, ekzekutimi, testimi, dokumentimi, prezantimi Seria e trajnimit është planifikuar me 480 orë pune me ndarje të punës si në vijim: 3 Seminare nga 2 javë (3 x 2 x 40h) = 240h 10 x 0,5 ditë mësim virtual = 40h 10 x 0,5 ditë Moderim/Lifechat = 40 h + 160 h për zbatimin e detyrave të punës = 160 h
Certifikimi	Për njohjen dhe certifikimin e serive të seminareve, në fund do të kryhet një ekzamin përfundimtar si vlerësim i projektit. Pjesët e vlerësimit të projektit janë dokumentacioni i projektit, prezantimi dhe diskutimi i ekspertëve. Subjekti i projektit të provimit është zakonisht planifikimi, ekzekutimi dhe vlerësimi i një sekuence mësimore.
Trajner	Grup ekspertësh
Data	16.11.2021

Titulli i Programit	Edukimi muzikor dhe aspekte të rëndësishme në procesin e mësimdhënies së integruar/diferencuar
Titulli i organizatës	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë
Adresa:	Çagllavicë Magjistranja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	048-751-752
Numrat dhe data e aprovimit:	Numër: 486 25.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Në total janë të planifikuara 16 orë: - 10 orë në auditor dhe 6 orë praktikë, me mentorim (nëse zhvillohet mësim fizik) - 16 orë mësim teorik (nëse mësimi zhvillohet online)
Përfituesit:	Mësimdhënësit e karrierës si dhe edukatorët janë ata mësimdhënës/edukatorë të cilët synojnë këtë trajnim. Trajnimi synon të rrisë performancën e tyre në rrafshin teorik dhe praktik, me qëllim të avansimit të shkathtësive mbi aspekte të rëndësishme të edukimit muzikor dhe rolit të tij në punën me nxënës respektivisht fëmijë. Kjo kategori mësimdhënësish që bëjnë përpjekje të rriten në karrierën e tyre, kanë mundësinë që të njohin, përvetësojnë dhe të thellohen në fushën e muzikës dhe aspekte metodologjike të saj, si dhe të aftësohen për njohuri dhe metoda të reja, të panjohura ose pak të dëguara prej tyre.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i grupeve të trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 – 30 pjesëmarrës. Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosovës.

Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	1. Njohja me parimet themelore dhe rëndësinë edukimit muzikor; 2. Njohja e metodave të mësimdhënies në fushën e muzikës; 3. Implementimi i shkathtësive të fituara të bazuara në një proces efektiv mësimor
Përmbajtja:	Programi i trajnimit do të synojë që mësimdhënësit/edukatorët t'i përmbushë me njohuritë bazike që dalin nga Kurrikula Bërthamë për klasët përgatitore dhe arsimin fillor të Republikës së Kosovës e cila thotë: artet edukojnë në mënyrë të suksesshme për arritjen e kompetencave të parapara në kurrikulën e Kosovës, vetëm nëse gjatë mësimdhënies zbatohen në mënyrë të duhur parimet didaktike dhe metodike përkatëse në secilën prej lëndëve mësimore në fushën-Artet. Metodologjia e mësimdhënies në lëndët artistike përfshin teknika dhe metoda mësimore specifike për zhvillimin e kompetencave artistike. Në këtë nivel duhet të përdoret kryesisht loja kreative, intuïta, mësimdhënia e integruar, e diferencuar (në bazë të prirjeve dhe interesimeve individuale të nxënësit) si dhe qasja konstruktive e të nxënësit me nxënësin në qendër. Përjetimi artistik, nxitja e kërkshorisë, e imagjinatës dhe liria e të shprehurit e inkurajimi i kreativitetit janë parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve. Qasja integruese tematike e ndërlëndore e ndihmojnë nxënësin që të njohë dhe zbatojë më lehtë konceptet e ndryshme artistike.
Metodat e realizimit të programit	Në këtë trajnim si metodologji kryesore do të përdoret ndërveprimi mes trajnuesit dhe nxënësit, puna konkrete përmes detyrave të shkurtra për të dëgjuar mendimin e mësimdhënësve, qasjen e tyre mbi trajnimin por edhe për të parë në kohë reale rezultatet: Sa dhe si ka ndryshuar koncepti mbi rëndësinë dhe aspektet e fushës së muzikës në procesin mësimor, duke u bazuar nga informata e fituar gjatë trajnimit.
Certifikimi	Cilësia e programit të trajnimit varet në një shkallë të gjerë nga pjesëmarrja e mësimdhënësve në trajnim, ndërlidhja e ambicies së tyre për të përthithur dijet e fituara, si dhe ndërveprimi me trajnuesin. Çdo njëri prej tyre varësisht këtyre treguesve, do të ketë vlerësimin e trajnuesit për ta. Do të merren shembuj nga praktika të krijuara dhe përvoja të ndryshme.

	Vlerësimi final i mësimdhënësve do të realizohet me testim.
Trajner	PhD (c) Elizabetë Qarri
Data	01.11.2021

Titulli i Programit	Menaxhimi i stresit tek nxënësit pas Pandemise COVID-19, veprimet parandaluese të atakimit të jetës së njerëzve në të ardhmen
Titulli i organizatës	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë
Adresa:	Çagllavicë Magjistralka- Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	048-751-752
Numrat dhe data e aprovimit:	Numër: 486 25.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	24 orë
Përfituesit:	Mësimdhënës fillestar dhe Mësimdhënës i karrierës, Mësimdhënësit e avancuar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i grupeve të trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 – 30 pjesëmarrës. Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosovës.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përdorimit të trajnimit, vijuesit do të jenë në gjendje: -Të kuptojnë dhe të njohin rëndësinë e shendetit mendor në aspektin e menaxhimit të stresit të shkaktuar nga Pandemia COVID-19. Vijuesit aftësohen që inovacionet e fituara t'i jetësojnë në procesin e mësimdhënies me qëllim të nxënësve të suksesshëm nga nxënësit. Gjithashtu, përfituesit më të mëdhenjë do të jenë nxënësit të cilët do të kenë afër vetes mësimdhënës të cilët tanimë janë të trajnuar se si do të menaxhojnë stresin eventual të shkaktuar si pasojë e Pandemisë COVID – 19.
Përmbajtja:	Fëmijëria dhe adoleshenca janë konsideruar si një periudhë

	tranzicioni, një periudhë eksituese dhe tepër e zhurmshme. Përballja me sfidat e vazhdueshme si në jetën sociale, ashtu edhe në çështjet tjera bën që kjo periudhë të konsiderohet tepër delikate. I konceptuar si një proces nëpërmjet të cilit një person percepton dhe regjion ndaj ngjarjeve që i gjykon të jenë sfiduese apo kërcnuese, stresi është kthyer në një fenomen shqetësues veçanërisht për nxënësit e të gjitha moshave, veçanërisht për adoleshentët. Studimet tregojnë se nxënësit janë më të stresuar se sa të rriturit. Pandemia Covid -19, do të lë pas vetës çrregullime të shumta emocionale dhe stres tek nxënësit . Mësimi në distancë është zhvilluar praktikisht me muaj dhe mësimdhënësit ndjehen në presion për të rritur ngarkesat e kursit të tyre për të kompenzuar mungesën e mësimi fizik në klasë. Gjatë periudhës së Pandemisë COVID -19, shenjat tradicionale të përvojës në shkollë janë pothuaj të gjitha. Ndërsa të gjithë vendosen në rutina të reja brenda në shtëpi, nxënësit po ndjehen të zemëruar, të shqetësuar dhe të pambështetur. Identiteti i tyre është duke u thyer në izolim. Ata më shumë se asnjëherë tjetër duan ta ndjejnë përkrahjen dhe afërsinë e njerëzve përreth që i duan ata, i mësojnë dhe i edukojnë. Dhe kjo mund të arrihet parasegjithash me trajnime profesionale të cilat ju dedikohen nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve. Prandaj, vazhdimi i projektit “Menaxhimin e stresit tek nxënësit pas Pandemisë COVID- 19 , veprimet parandaluese të atakimit të jetës së njerëzve në të ardhmen”, si njëra nga nismat më serioze dhe mbase e vetme në Kosovë e rajon, ofron një mundësi të mirë që përmes trajnimeve profesionale në fushën e psikologjisë, pedagogjisë dhe kujdesit shëndetësor me higjienë, të arrihen rezultatet e pritshme në kuadër të një tërësie të përbashkët. • Fusha e Psikologjisë <i>Temat bazë</i>
--	---

	Definimi i nocionit të Stresit	
	Identifikimi i stresit tek nxënësit e grup moshave të ndrsyhme	
	Teknikat për intervenim të hershëm për menaxhim të stresit në fushën psiko-sociale	
	Aktivitete praktike për menaxhimin e stresit tek nxënësit përmes lëndëve të ndrsyhme mësimore	
	Fusha e Pedagogjisë	
	Temat bazë	
	Reformimi pedagogjik	
	Transformimi i praktikës pedagogjike	
	Përfshirja e aftësive socio-emocionale në procesin mësimor	
	Shfrytëzimi i potencialit të mjediseve të nxënësve online	
	Edukimi shëndetësor Përmbajtje e modulit në fushën e Edukimit Shëndetësor	
	Temat bazë	
	Hyrje në kujdesin shëndetësor	
	Masat mbrojtse në ruajtjen e shëndetit	
	Higjena e duarve	
	Dezinfektuesit dhe protokolet e përdorimit të dezinfektuesve	
Metodat e realizimit të programit	- Mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve - Mësimdhënia algoritmike - Mësimdhënie përmes përdorimit të TIK-t - Mësimdhënia kooperative dhe ndërvepruese	
Certifikimi	Përfshirja aktive në debat dhe pjesë praktike gjatë trajnimit llogaritet deri në 5% të pikëve gjatë procesit të vlerësimit. Gjithashtu stafi i organizatës monitoron procesin e trajnimit duke u siguruar që trajneret zbatojnë me përpikmëri agjendën e paraparë dhe përdorimin e metodologjisë së aplikuar gjatë trajnimit.	

	<i>Perfshirja aktive 5%</i> <i>Pjesa praktike 25%</i> <i>Testi vlerësues 70%</i>
Trajner	• Dr. Ndriçim Mehmeti • Dr. Gazmend Bojaj • Dr. Saranda Shatri • Dr. Armen Mustafa • Msc. Aferdita Mustafa • Dr. Nalan Kazas • Dr. Rina Meha
Data	01.11.2021

Titulli i Programit	Metodologjia e mësimdhënies në seksion muzikor instrumental
Titulli i organizatës	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë
Adresa:	Çakllavicë, Magjistranja Prishtinë -Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	048-751-752
Numrat dhe data e aprovimit:	Numër: 486 25.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Në total janë të planifikuara 24 orë: - 16 orë teori dhe 8 orë praktike
Përfituesit:	Mësimdhënësit e karrierës si dhe edukatorët janë ata mësimdhënës/edukatorë të cilët synojnë këtë trajnim. Trajnimi synon të rrisë performancën e tyre në rrafshin teorik dhe praktik, me qëllim të avansimit të shkathtësive mbi aspekte të rëndësishme të edukimit muzikor dhe rolit të tij në punën me nxënës respektivisht fëmijë. Kjo kategori mësimdhënësish që bëjnë përpjekje të rriten në karrierën e tyre, kanë mundësinë që të njohin, përvetësojnë dhe të thellohen në fushën e muzikës dhe aspekte metodologjike të saj, si dhe të aftësohen për njohuri dhe metoda të reja, të panjohura ose pak të dëgjuara prej tyre.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i grupeve të trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 - 30 pjesëmarrës. Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosovës.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në fund të kursit, kandidatet do të jenë në gjendje: ☐ artikulojnë filozofinë e tyre drejt edukimit muzikor instrumental të studentëve dhe detajojnë një arsyetim për edukimin muzikor instrumental në shkollat

	☐ diskutojnë shumë çështje aktuale dhe tendencat në lidhje me mësimdhënien muzikë instrumentale ☐ demonstrojnë dhe përmirësojnë aftësitë themelore të mësimdhënies dhe prezantimit ☐ demonstrojnë aftësi kërkimore dhe mbledhëse të burimeve për kurrikulën e dizajnit duke marrë parasysh procedurat e dizajnit udhëzues, muzikantin gjithëpërfshirës dhe standardet kombëtare të muzikës ☐ detaje dhe plan për aftësitë zhvillimore të instrumentistëve në nivele të ndryshme (fillestar, i mesëm, i përparuar) ☐ të analizojnë dhe planifikojë praktikën administrative pasi ato lidhen me mësimin e kurseve instrumentale në shkollë ☐ demonstrojnë mësim muzikor dhe strategji provash ☐ demonstrojnë profesionalizmin e pritur të praktikuesve të muzikës instrumentale.
Përmbajtja:	Ky program përmbledh tërë procesin arsimor-edukativ në mësimin e edukatës muzikore. Metodika e edukatës muzikore bën pjesë në grupin e disiplinave shkencore-pedagogjike, duke shfrytëzuar zbatimin specifik të metodave të saj. Në fushën e veprimtarisë së saj, shpjegon detyrat dhe qëllimet të cilat objektivist na paraqiten gjatë punës edukative-mësimore. Duke i parashtruar kërkesat dhe parimet didaktike, si lëndë në veçanti, ndihmon që të dime si të përdorim format dhe metodat e ndryshme, qëndrimet, organizimin e faktorëve ndihmës. Mësimdhënësit në fillim duhet të kenë orientim të qartë në tërë procesin mësimor-edukativ të muzikës. Pastaj, gjatë procesit të punës, duke pasqyruar kushtet konkrete të shkollës, të klasës apo të individëve, mund të zgjedhë ato orientime didaktike, që përmbajnë ide të qarta dhe që do t'i ndihmojnë dhe t'i a plotësojnë punën teoriko-praktike muzikore. Gjithnjë e më shumë rritet kërkesa që të më mësojmë se si mësohen të tjerët në mënyrë më efektive, sepse vetëm kështu arrihet qëllimi i plotë në procesin mësimor. Qëllimi duhet të jetë që në formë sa më të frytshme dhe racionale të plotësohen kërkesat në ngritjen e nivelit edukativomësimor në muzikë. Gjithnjë duhet të gjejmë mundësi për përparim të procesit mësimor, por duke qenë sa më racionale dhe efektive. Programi është krijuar për të siguruar një themel kurrikular për pedagogët e ardhshëm të muzikës për të përshkruar "qasjet administrative, teknikat e provave dhe stilet moderne

	gjithëpërfshirëse të mësimdhënies për mësuesin e mesëm të instrumenteve. ” Mësimi i Muzikës dhe Zhvillimi, Metodatat e Përbërjes dhe Metodatat e Përgjithshme të Muzikës me kërkesat e nevojshme praktikë e përgjithshme e muzikës. Qëllimet e këtij trajnimi janë: ☐përgatitni edukatorët e ardhshëm të muzikës instrumentale për sukses (suksesi zhvillimi / mësimdhënia në një program të qëndrueshëm, muzikor, të madh instrumental ku studentët e shkollave publike janë të angazhuar dhe bëhen më të interesuar për muzikë, krijues dhe të pavarur në krijimin e muzikës së tyre). ☐të përgatisë të gjithë arsimtarët e ardhshëm të muzikës për metodologjinë e mësimdhënies në muzikë ☐ofrojnë mundësi që të përsosin muzikën e tyre instrumentale mësimdhënia, ngritja e vetëdijes për repertorin instrumental dhe njohja e një larmie strategjish provash ☐sigurojmë mundësi për të praktikuar dhe zhvilluar modelin udhëzues muzikor
Metodat e realizimit të programit	Në këtë trajnim si metodologji kryesore do të përdoret ndërveprimi mes trajnuesit dhe nxënësit, puna konkrete përmes detyrave të shkurtra për të dëgjuar mendimin e mësimdhënësve, qasjen e tyre mbi trajnimin por edhe për të parë në kohë reale rezultatet: Sa dhe si ka ndryshuar koncepti mbi rëndësinë dhe aspektet e fushës së muzikës në procesin mësimor, duke u bazuar nga informata e fituar gjatë trajnimit. Diskutim në klasë, nxënie bashkëpunuese / projekte në grup, diskutime në grupe të vogla, projekte të pavarura analitike, lexime, mbledhje burimesh, prezantime, mësimdhënie dhe leksione përbënin shumicën e aktiviteteve me detyra të lidhura. Mësimi muzikor një për një është një lloj i veçantë i situatës së mësimdhënies dhe si të tilla përdorin strategji mësimore që janë unike për atë mjedis. Kërkimet ekzistuese kanë hetuar aspekte të caktuara të mësimdhënies së muzikës (shpesh në vendosja në klasë) siç janë intensiteti i mësimdhënies, vëmendja e kandidatit, modelimi, përforsimi, pyetja dhe praktikimi.
Certifikimi	Pjesëmarrësit u nënshtrohen testit që lidhet: Test mbi njohuritë e perfituara gjatë trajnimit

	Për certifikim pjesëmarrësit janë të obliguar të jene të rregullt dhe të ndjekin tri ditët e trajnimit.
Trajner	Prof. Dr. Besa Luzha Msc. Naser Dula Prof.dr. Selami Kolonja
Data	01.11.2021

Titulli i Programit	
----------------------------	--

	Pedagogjia e Edukimit Psiko-Fizik dhe Shëndetësor
Titulli i organizatës	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë
Adresa:	Çagllavicë Magjistrallja Prishtinë -Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	048-751-752
Numrat dhe data e aprovimit:	Numër: 486 25.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Numri i ditëve të trajnimit: 4 Numri i orëve të trajnimit: 30 Mjekesi Sportive –8 orë (Nga ky modul janë të paraparë të zhvillohet ligjërata me këtë strukturë të shpërndarjes së zhvillimit të orëve 4 orë teori dhe 4 orë praktikë). Psikologji Sportive – 8 orë (Nga ky modul janë të paraparë të zhvillohet ligjërata me këtë strukturë të shpërndarjes së zhvillimit të orëve 6 orë teori dhe 2orë praktikë) Edukim Shendetesore – 8 orë (Nga ky modul janë të paraparë të zhvillohet ligjërata me këtë strukturë të shpërndarjes së zhvillimit të orëve 6 orë teori dhe 2 orë praktikë). Permbledhje dhe vlerësim – 6 orë.
Përfituesit:	Mësimdhënësit fillestar, të karrieres dhe ata të avancuar të lëndës së Edukatës Fizike, me mësim në gjuhën shqipe dhe gjuhët tjera të komuniteteve (turke, boshnjake, serbe etj), të nivelit të mesëm të ulët (klasa 6-9) dhe nivelit të mesëm të lartë (klasa 10-12). Mësimdhënesit e Edukatës Fizike e kanë të domosdoshme ndjekjen e trajnimeve të cilat ndërlidhen me edukimin psiko-fizik dhe shëndetësor të nxënësve. Gjithashtu ky trajnim mund të ofrohet edhe për mësuesit e ciklit fillor (klasa 1-5) e reduktuar në një dite trajnim në vlerë prej 8 orëve, (reduktimi bëhet në fondin e orëve nga totali i përgjithshëm në këtë shtrirje: Mjekesia sportive,2 orë, Psikologjia Sportive 2 orë,

Metodat e realizimit të programit	Zhvillimi i trajnimit do të udhëhiqet me thënien e më sipërme të psikologut të shquar <i>KurtLevinit</i>. Gjatë trajnimit 50% e kohës do të jetë punë teorike dhe 50 % e kohës praktik Ligjerim Pune individuale dhe Pune ne grupe Studime rasti Demonstrim praktik Diskutim
Certifikimi	Gjate trajnimit, trajneret monitorojne dhe vleresojne perfshirjen e pjesemarresve ne diskutime gjate pjeses se debatimit per rastet konkrete te paraqitura si pjese e zbatimit praktik. Trajneri vlereson analizen dhe qendrimin kritik te pjesemarresve per rastet e paraqitura si pjese e ushtrimeve duke vleresuar qendrimin kritik per rastet ne fjale. Perfshirja aktive ne debat dhe pjese praktike gjate trajnimit llogaritet deri ne 10% te pikeve gjate procesit te vleresimit. Gjithashtu stafi i organizates monitoron procesin e trajnimit duke u siguruar qe trajneret zbatojne me perpikmeri agjenden e parapare dhe perdorimin e metodologjise se aplikuar gjate trajnimit. <i>Perfshirja aktive ne debat 5%</i> <i>Pjesa praktike 15%</i> <i>Testi vlerësues 80%</i>
Trajner	PhD. Cand Rilind Obertinca PhD. Cand Rina Meha
Data	01.11.2021

Titulli i Programit	Planifikimi sipas nevojave te nxënësit (nxënës me nevoja te
----------------------------	--

	veçanta). Hartimi i planit individual te edukimit (PEI) per nxënës me AK
Titulli i organizatës	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë
Adresa:	Çagllavicë Magjistralja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	048-751-752
Numrat dhe data e aprovimit:	Numër: 486 25.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	16 orë në total: 10 orë në auditor, 6 orë përgatitje individuale për hartimin e një plani Individual Arsimor dhe 2 orë praktikë në shkollë. Kjo e fundit është opsionale në varësi të kohës dhe mundësisë që kemi. Pra nëse kemi mësim fizik, do të kemi edhe mentorim, përndryshe na mbetet vetëm trajnim teorik.
Përfituesit:	Nga ky program do të përfitojnë: • Edukatorët të niveleve: ISCED:01 dhe (ISCED:02); • Mesimdhënesit fillestar • mesimdhënesit të avancuar, • mesimdhënesit mentor dhe të mesimdhënesit të merituar; kordinatorët e cilësisë
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i grupeve te trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 – 30 pjesëmarrës. Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosovës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Programi i këtij trajnimi synon, të aftësojë mesimdhënësin për: 1. Mënyrën e hartimit të PIA në përputhje me nevojat e nxënësve 2. Procesin e monitorimit dhe të rishikimit të tij. 3. Përshtatja e kurrikulës (përmbajtja e individualizuar) të lëndëve mësimore ose të fushave të aktiviteteve 4. Format e vlerësimit të fëmijës

Përmbajtja:	Programi i trajnimit synon të rrënjosë tek mësimdhënësit rëndësinë që ka trajtimi me një plan individual arsimor i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të demonstrojë se qëllimi kryesor i PIA-s është që fëmija maksimalisht të përftojë nga procesi mësimor, bazuar në nevojat, mundësitë dhe potencialin e tij/saj. Për të arritur rezultatet e synuara, mësimdhënësi duhet të përcaktojë, qëllime të qarta dhe të arritshme për fëmijën, bazuar në aftësitë e tij/saj. Mësimdhënësi aftësohet në këtë trajnim që qëllimet të përcaktojë varësisht nga lënda apo fusha ku fëmija ka nevojë (lexim, shkrim, komunikim, përfshirje në lojëra që socializojnë fëmijët etj.). Trajnimi i demonstroi mësuesit se rezultatet e të nxënësve përkufizohen, si: “Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një nxënës/se në fund të një klase, shkalle apo niveli”. Mësimdhënësi në përfundim të trajnimit duhet të jetë i qartë se: Rezultatet e nxënësve duhet të caktohen në bazë të aftësive dhe prirjeve të fëmijës, e jo sipas kërkesave të lëndës në nivel të klasës.
Metodat e realizimit të programit	Në këtë trajnim do të përdoret si metodologji kryesore, metoda kooperuese dhe ndërvepruese mes trajnuesit dhe mësimdhënësit, e jetësuar në punën konkrete përmes hartimit të PIA (punë individuale dy orë). Në këtë trajnim do të ishte me interes edhe metoda demonstruese, në rast se do të kishim mundësinë të ndiqnim sesi zbaton PIA në klasë një mësimdhënësi që është trajnuar për këtë qëllim. Gjithsesi me rëndësi do të ishte edhe të dëgjohet mendimi dhe të shikohet nga ana e trajnerit sesi është hartuar konkretisht një PIA, për nxënësit në nevojë.
Certifikimi	Gjatë trajnimit, trajneret monitorojnë dhe në përfundim bëjnë dhe vlerësimin me testim dhe gjithashtu vlerësimin e dosjes ku shpërndarja e përqindjes së vlerësimit është kjo: <i>Pjesa praktike 50%</i> <i>Testi vlerësues 50%</i>
Trajner	• Dr. Ndrim Mehmeti • MA. Anila Beshaj • Dr. Saranda Shatri • Dr. Armen Mustafa
Data	
Titulli i Programit	

	<u>Qasja dhe mësimdhënia e diferencuar për fëmijët me nevoja të veçanta</u>
Titulli i organizatës	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	EDUMEN-K - Edukimi dhe Menaxhmenti në Kosovë
Adresa:	Çagllavicë Magjistralka Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	Edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	048751752
Numrat dhe data e aprovimit:	Numër: 486 25.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	60 orë
Përfituesit:	Edukatorët të niveleve: ISCED:01 dhe (ISCED:02); Mësimdhënësit e licencuar me gradat e mësimdhënësit të karrierës, mësimdhënësit të avancuar, mësimdhënësit mentor dhe të mësimdhënësit të merituar; Kordinatorët e cilësisë
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i kandidateve është i limituar jo më shumë se 25 kandidatë
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në kuadër të këtij programi synohet të arrihen këto objektiva: • Zhvillojnë qasje për të kuptuar më të thellë për parimet e mësimdhënies së diferencuar; • Planifikojnë qasje të ndryshme në mësimdhënie të nevojshme për arritjen e rezultateve të dëshiruara për nxënësit e ndryshëm; • Demonstrjnë modifikimin e materialeve dhe detyrave mësimore si dhe përshtatjen e aktiviteteve mësimore nevojave grupore dhe individuale të nxënësve; • Argumentojnë përdorimin e programeve të individualizuara për nxënësit me vështirësi specifike në të nxënë apo për nxënësit e talentuar dhe me dhunti. Zhvillojnë një të kuptuar të ndjeshëm ndaj karaktersitikave të

	nxënësve dhe një qëndrim të shëndoshë ndaj punës së vet dhe ndaj nxënësve të cilëve ju shërbejnë, pavarësisht se sa sfidues ose të zgjuar mund të jenë ata.
Përmbajtja:	Kosova ka zhvilluar një qasje të integruar ndaj edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, në të cilën kombinohen shumë natyrshëm procesi i edukimit, i kujdesit shëndetësor, i arsimimit dhe kujdesit profesional ndaj zhvillimit të tyre. Njëra ndër sfidat me rëndësi në mësimdhënien e sotme është aftësia për t'u përgjigjur në mënyrë pozitive dhe proaktive ndaj dallimeve ndërmjet nxënësve, pra ndaj diversitetit në klasë. Prandaj, përmes kësaj lënde do të adresohen çështjet e përmendura duke vënë theksin në mësimdhënien e diferencuar ose adaptive dhe në planin, përkatësisht programin e individualizuar për ata nxënës të cilët janë në rrezik për të dështuar në shkollimin e tyre. Mësimdhënia e diferencuar përcaktohet si një punë mësimore e cila përshtatet mbi bazën e karakteristikave dhe nevojave individuale të nxënësve. Të dhënat tregojnë se nëse zbatohet si duhet, mësimdhënia e diferencuar mund të ketë ndikim në përmirësimin e rezultateve të të nxënit. Qëllimi i këtij programi është t'i aftësojë pjesëmarrësit lidhur me atë që diferencimi mund të zbatohet përmes mënyrës së qasjes në mësimdhënie, përmbajtjes së kurrikulës, metodave të mësimdhënies, modifikimit të materialeve mësimore, organizimit të klasës, grupimit të nxënësve dhe ndërveprimit të mësimdhënësve me nxënësit individualë. Ato do të bëjnë një zhvillim të vazhdueshëm profesional. Mësimdhënësit tashmë në sistem, kanë nevojë për përmirësim të konsiderueshëm të cilesisë, njohurive dhe aftësive të tyre gjatë viteve të ardhshme, veçanërisht në lidhje me kërkesat e kurrikulit të ri dhe të didaktikës dhe metodikën aktuale. Kjo është një fushë në të cilën OJQ "EDUMEN" do të kontribuojë pa çështjen sfiduese të qëndrueshmërisë. Me program janë paraparë IV module. Fondi orientues i orëve sipas moduleve paraqitet në vazhdim: 1. Mësimdhënia e diferencuar: Kuptimi, diversiteti në klasë dhe nevoja për zbatimin e saj - (7 orë teori dhe 8 orë praktikë) 2. Mësimdhënia e diferencuar bazuar në profilet e

	nxënësve (7 orë teori dhe 8 orë praktikë) 3. Programi i individualizuar i edukimit/arsimit: Qëllimi dhe përmbajtja e dokumentit tëPIA-së (5 orë teori dhe 10 orë praktikë) 4. Zbatimi i Planit Individual të Arsimit në klasat me mësimdhënie të difrencuara (5 orë teori dhe 10 orë praktikë)
Metodat e realizimit të programit	Trajnimi realizohet përmes ligjeratave me pjesëmarrje fizike dhe online. Trajnimi realizohet përmes detyrave të ndryshme nga trajneret ku kandidatet janë të obliguar që në fund të trajnimit të i përcjellin për vlerësim. Për sigurimin e cilësisë së programit praktikohet kjo metodologji e punës: • Mësimdhënia kooperative dhe ndërvepruese • Skedat e daljes • Fletëvlerësimet e pjesëmarrësve • Testimet e vazhdueshme në fund të çdo moduli • Vlerësimi
Certifikimi	Për certifikim vlerësohen: Portofoli i përgatitur (5 pikë); Vijimi i rregullt i trajnimit (5 pikë); Vizita në institucione e parapara (5) pikë; Përgjigjet e sakta në test – (30 pikë); punë praktike nga një temë nga praktika e identifikimit të fëmijëve me vështirësi në të nxënë. Pjesëmarrësit u nënshtrohen tre testeve që lidhen: Test mbi njohuritë e nocioneve themelore për nxënës me vështirësi (5 pikë): format e identifikimit 10 pike rast studimor i identifikimit 20 pike . Për certifikim pjesëmarrësit janë të obliguar të krijojnë portofolin (25 pikë)
Trajner	• Prof. dr. Saranda Shatri – Doktore e Shkencave të Pedagogjisë, ligjëruese universitare. • Prof. Armen Mustafa – Profesor
Data	01.11.2021

Titulli i Programit	
Zhvillimi i të menduarit kritik dhe kreativ tek nxënësit në arsimin fillor	
Titulli i organizatës	EDUMEN-K Edukimi dhe Menaxhimi në Kosovë
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	EDUMEN-K
Adresa:	Çagllavicë Magjistratja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	048751752
Numrat dhe data e aprovimit:	Numër: 486 25.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	16 orë në total: 10 orë në auditor dhe 6 orë praktikë në institucione arsimore 9-vjeçare opsionale. Pra nëse kemi mësim fizik, do të kemi edhe mentorim, përndryshe na mbetet vetëm trajnim teorik
Përfituesit:	Mësimdhënësit mentor. Arsyeja e zgjedhjes së këtij grupi bëhet për arsyen se ky grupacion mësimdhënësish, me përvojën e tyre këshillojnë, mbështetin dhe inkurajojnë një ose më shumë mësimdhënës me më pak përvojë. Këta mësimdhënës pas trajnimit, kanë mundësi të ndajnë shkathtësitë dhe përvojat personale e profesionale të fituara, për të ndihmuar në avancimit më tej të zhvillimit të të menduarit kritik tek nxënësit në arsimin fillor
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i kandidateve është i limituar jo më shumë se 25 kandidatë
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Rezultatet e pritshme në këtë trajnim mund ti listojmë si më poshtë: 1. Mësimi i nxënësve si t'i qasen në mënyrë kritike secilës lëndë e bën atë më relevante për ta. 2. Përfitimi i aftësive nga mësuesit sesi tu ndihmojmë nxënësve të mendojnë në mënyrë kritike – të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë në mënyrë të singurtë, t'i dëgjojnë të tjerët dhe t'i analizojnë mendimet duke u bazuar në fakte. 3. Përdorimi i strategjive dhe metodave mësimdhënëse që e nxjerrin fëmijën “jashtë kutitsë” dhe nxisin mendimin e tij krijues për çështje nga më të ndryshmet.
Përmbajtja:	Programi i këtij trajnimi parashihet si një mundësi më

	shumë për nxitjen e mendimit kritik dhe krijues tek nxënësit në moshë të hershme të shkollimit të tyre, siç është arsimi fillor. Programi i trajnimit synon gjithashtu, të aftësojë mësimdhënësit, të ndërmarrin më shumë iniciativë me qëllim që të kuptojnë vetë dhe të përcjellin tek kolegët dhe nxënësit e tyre, definicionin se: Mendimi kritik është modalitet i të menduarit që është i qartë, racional, i hapur dhe i informuar në bazë të dëshmive. Përfshin shkathtësi të të menduarit të nivelit të lartë si analiza, vlerësimi dhe krijimi. i parë në këtë këndvështrim, mësimdhënësit mentor, shikohen si të duhurit, në pikëpamjen e përgatitjes profesionale, që mund të shërbejnë si transmetues të kësaj filozofie të re mësimdhënie.
Metodat e realizimit të programit	Ky trajnim do të mbështetet në metodologjinë demonstruese. Në këtë trajnim do ti jepet përparësi zbatimit të metodat ndërvepruese dhe aktivitetet që stimulojnë reflektimin, bashkëpunimin dhe kreativitet, mbi mundësitë që na jep programi PISA, për të përmirësuar punën tonë në procesin mësimdhënies dhe mësimnxënies.
Certifikimi	Kandidatet të cilët ndjekin me rregull gjithë programin e trajnimit vlerësohen në perfundim të trajnimit me testim
Trajner	Prof. Dr. Ndricim Mehmeti Prof. dr. Saranda Shatri – Doktore e Shkencave të Pedagogjisë, ligjëruese universitare. Prof. Dr. Anila Beshaj,
Data	01.11.2021

Titulli i Programit	GJITHËPËRFSHIRJA DHE INDIVIDUALIZIMI I MËSIMIT PËR NXËNËS ME NEVOJA TË VEÇANTA (PIA)
Titulli i organizatës	Eko - Protection
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Eko - Protection
Adresa:	Rr. Bislim Bajgora - Mitrovicë
E-mail:	arbenzabeli@gmail.com
Telefoni:	044-415-558 049-541-053
Numrat dhe data e aprovimit:	12/20 Akreditohet për dy vite 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	56 orë
Përfituesit:	Përfituesit e drejtpërdrejtë: Drejtorët e shkollave, zëvendës drejtorët, pedagogët, psikologët, mësimdhënësit klasorë, mësimdhënësit lëndorë, mësimdhënësit mbështetës, mësimdhënësit e klasave të bashkangjitura si dhe asistentë për nxënës me nevoja të veçanta.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 - 30
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Pjesëmarrësit do informohen për terminologjinë dhe konceptet e arsimit gjithëpërfshirës, për largimin e paragjytimeve për nxënës apo personat me nevoja të veçanta arsimore; - Të mos i paragjykojmë nxënësit në bazë të vështirësisë që kanë por përparësive të tyre, të fokusohemi në atë që mund të bëjnë e jo në atë që nuk mund të bëjnë; - Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuri të reja për organizimin dhe planifikimin e punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore respektimi i individualitetit të secilit nxënës; - Për përgatitjen e materialeve alternative mësimore duke u bazuar në nevojat individuale të nxënësve; - Si bëhet menaxhimi i klasës ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore, krijimi i klimës së përshtatshme brenda klase, respektimi i nevojës së veçantë dhe përfshirja në aktivitete të shkollës të secilit pavarësisht vështirësisë së tij/saj. - Njohja e vështirësive në të nxënë (vështirësi këto që janë pedagogjike e jo mjekësore). - Përdorimi i metodave dhe teknikave të përshtatshme varësisht

	nga vështirësia në të nxënë që ka nxënësi në klasë - Informata të nevojshme për Planin Individual të Arsimit (PIA), - Të mësojnë si hartohet PIA dhe si ta zbatojnë atë në punë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në klasë; - Pjesëmarrësit që kanë vijuar trajnimin mësojnë të vlerësojnë nxënësit sipas UA, dhe vlerësimit në ditarë shkollorë sipas PIA.
Përmbajtja:	• Programi i trajnimit është i ndarë në 2 module: • Moduli I - Gjithëpërfshirja, mësimdhënia dhe mësimnxënia (24 orë) • Moduli II - Plani Individual i Arsimit (PIA) - (24 orë) • Dhe 8 orë punë praktike (Detyrë shtëpie) • Programi përfshinë Informatat themelore për arsimin gjithëpërfshirës - Terminologjisë; • Legjislacioni i arsimit special në Kosove dhe Botë; • Stilet dhe strategjitë e mësimdhënies; • ADHD (Çrregullimet e Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit); • Bashkëpunimi prindër , nxënës dhe mësimdhënës; • Menaxhimi i klasës; • Vështirësitë në shkrim- lexim dhe matematikë; • Nxënësit hiperaktiv; • Bulizmi • Inteligjencat e shumëfishta; • Dallueshmëritë ndërmjet nxënësve; • Njohja me planin individual të arsimit (PIA) dhe udhëzuesin për përdorimin e PIA-së; • Hartimi i PIA-së; • Aktivitete relaksuese me përmbajtje gjithëpërfshirëse; • Ekipi identifikues dhe vlerësues në nivel komunal; • Prodhimi i materialeve alternative mësimore të përshtatura sipas nevojave individuale. • Kurrikula e re e Kosovës në gjithëpërfshirje;
Metodat e realizimit të programit	Të ndryshme Metodologjia e punës që realizohet përmes këtij programi trajnues është kryesisht përmes teknikave të mësimit aktiv, ligjëratave interaktive, shkëmbimit të përvojave të programit të suksesshëm dhe punës në grupe.
Certifikimi	Të gjithë mësimdhënësit do të certifikohen sipas vijueshmërisë dhe sipas përfundimit të suksesshëm të detyrave.
Trajner	12
Data	

Titulli i Programit	APLIKIMI I PROGRAMEVE ONLINE NË SIGURIMIN E CILËSISË NË MËSIMDHËNIE
Titulli i organizatës	Eko - Protection
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Eko - Protection
Adresa:	Rr. Bislim Bajgora - Mitrovicë
E-mail:	samiffazliu@gmail.com ; samifazliu@hotmail.com
Telefoni:	044-294-075 048-906-331
Numrat dhe data e aprovimit:	12/20 Akreditohet për një vit 07.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	72 orë
Përfituesit:	Përfituesit e drejtpërdrejtë: Drejtorët e shkollave, zëvendës drejtorët, pedagogët, psikologët, mësime dhënësit klasorë, mësime dhënësit lëndorë, mësime dhënësit mbështetës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15 - 25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Mësime dhënësit do të pajisen me njohuri të reja për aplikimin e programeve online në procesin e mësime dhënies; - Mësime dhënësit do të pajisen me njohuri të reja për përgatitjen e materialeve mësimore dhe shpërndarjen e tyre duke përdorur programet online; - Mësime dhënësit të jenë në gjendje të ndajnë (share) punën e tyre me kolegë dhe nxënës; - Mësime dhënësit të jenë në gjendje të bashkëpunojnë online në zgjidhjen e detyrave dhe problemeve mësimore me nxënës e kolegë; - Mësime dhënësit të jenë në gjendje të shfrytëzojnë mundësinë e qasjes në materiale nga kudo në çdo kohë dhe nga kudo qoftë. - Mësime dhënësit do të pajisen me njohuri të reja për aplikimin e programeve online për komunikim të drejtpërdrejtë me nxënës apo kolegë.
Përmbajtja:	• Informatat themelore për programet online; • Google account - Shërbime të njohura të Google, Krijimi i një llogarie Google; • Gmail - Ndërfaqja e Gmail-it; Krijimi i një llogarie Gmail, Dërgimi i email-ve dhe menaxhimi i emailit;

- **Google Drive** - Qasja në Google Drive; Krijimi, ngarkimi dhe menaxhimi i skedarëve ne Google Drive, Ndarja e dokumenteve dhe bashkëpunimi; Konvertimi dhe printimi i dokumenteve ne Google Drive;
- **Google Forms** - Krijimi i Formave, Përdorimi i shablloneve, Rregullimi i cilësimeve të formave, Përdorimi dhe dërgimi i formave, Analizimi i përgjigjeve, Krijimi i një Kuizi;
- **Google Classroom** - Qasja në Google Classroom; Navigimi; Krijimi i detyrave dhe materialeve; Vlerësimi dhe lënia e reagimeve; Komunikimi me nxënës dhe prindër.
- **Google Docs**- Ndërfaqja, Manipulimi me tekst. Header-ët Footer-ët dhe thyerjet e faqeve; Puna me tabela; Vendosja e imazheve. Tekst box-et; Përdorimi i Google Docs offline;
- **Google Sheets**- Ndërfaqja e Google Sheets, Bazat e qelizave; Puna me shumë fletë; Krijimi i formulave; Përdorimi i funksioneve; Sortimi dhe filtrimi i të dhënave
- **Google Slides**- Bazat e sllajdeve; Bazat e punës me Tekst; Vendosja e imazheve dhe formave; Shtimi i tranzicioneve dh animacioneve; Shfaqja e prezantimeve (Slide Show); Editimi i layout-eve dhe master sllajdeve.

Metodologjia e punës që realizohet përmes këtij programi trajnues është kryesisht përmes teknikave të mësimit aktiv, ligjëratave interaktive, demonstrimit praktik dhe punës në grupe.

Programi i trajnimit përfshin 8 ditë trajnimi nga 8 orë: që do të thotë se, çdo pjesëmarrës ka 64 orë trajnim direkt dhe 8 orë punë praktike - çdo pjesëmarrës deri në fund të programit të trajnimit merr 72 orë trajnim.

Metodat e realizimit të programit	Të ndryshme
Certifikimi	Të gjithë mësimdhënësit do të certifikohen sipas vijueshmërisë.
Trajner	10
Data	

Titulli i Programit	
Puna e kujdestarit të klasës – Kujdestari i mirë	
Titulli i organizatës	Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QKBN)/ Kosovo Center for International Cooperation (KCIC)
Tipi i programit:	Bazik (themelor)
Ofertuesi i programit:	Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QKBN)/ Kosovo Center for International Cooperation (KCIC)
Adresa:	Rr. “Rexhep Dajkovci”, nr. 48, 60000, Gjilan
E-mail:	ngo.kcic@gmail.com
Telefoni:	+38344177320 apo +38349880447
Numrat dhe data e aprovimit:	Numër: 17/2021 Data: 17 mars 2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	Dy (2) vite
Përfituesit:	Mësimdhënësit e nivelit 1-5, 6-9 dhe 10-12
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Maksimum 30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Përmes këtij programi trajnues, synohet të ofrohen informacione të përmbledhura për mësimdhënësit e nivelit 1-12 në Republikën e Kosovës, lidhur me rëndësinë e veçantë dhe efektet pozitive që ka kryerja e detyrave të kujdestarit të klasës në ngritjen e cilësisë në arsim. Mësimdhënësit do të njihen me rolin e kujdestarit të klasës respektivisht me detyrat dhe obligimet kundruall akterëve në arsim: nxënësve, prindërve, stafit të shkollës dhe dokumentacionit shkollor. Programi i trajnimit është i ndarë në tre module: Moduli 1. Udhëheqja e klasës – zgjatë dy ditë Moduli 2. Dhuna në shkolla – zgjatë dy ditë Moduli 3. Menaxhimi i stresit të mësimdhënësit – zgjatë dy ditë Pra në total, ky program trajnues do të përmbajë gjithsej 6 ditë të plota dhe rrjedhimisht 48 orë trajnimi. Kështu, kandidati që e përfundon me sukses këtë program trajnues do të pajiset me certifikatë e cila përmban specifikat e trajnimit dhe numrin total të orëve të trajnimit që në këtë rast janë 48 orë trajnimi. Duke pas parasysh se ky program përbehet nga tre module, më

poshtë janë paraqitur rezultatet e pritura sipas moduleve:

Moduli 1.

- Zgjerimi i njohurive lidhur me detyrat dhe obligimet e kujdestarit të klasës ndaj nxënësve;
- Rritja e bashkëpunimit të kujdestarit në komunikime me prindër dhe mënyra e udhëheqjes së takimeve;
- Hartimi i planit të veprimit të kujdestarit me stafin e shkollës për mbarëvajtjen e punës në paralele;
- Identifikimi i sfidave dhe gjetja e zgjidhjeve të përshtatshme për gjithpërfshirje të nxënësve;
- Përpilimi dhe zbatimi i planifikimeve në punët me nxënësit;
- Definimi i formave të përshtatshme dhe strategjive për rritjen e njohurive dhe ngritjen e cilësisë në punën me nxënës;
- Praktikimi i tolerancës, mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe harmonizimit të qëndrimeve të nxënësve për punë të përbashkët në interes të paraleles;
- Aplikimi i formave të plotësimit, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së dokumentacionit pedagogjik;

Moduli 2.

- Kujdestari i klasës do të jenë në gjendje të planifikojnë ditën dhe detyrat, në çdo mbarim të ditës së punës të raportohet nga ana e nxënësve, duke bashkëpunuar me nxënësit lidhur me problemet aktuale në klasë,
- Përmes kujdestarit të klasës dhe bashkëpunimit të mirë do të raportohen rastet e dukurive negative të nxënësve, të trajtohen nga ana e psikologut të shkollës,
- Kujdestari i klasës do të arrijë të formon grupin apo mekanizmin koordinues në klasë për luftimin e dukurive negative në klasë dhe shkollë.

Moduli 3.

- Stresi personal nuk do të shkaktojë mësimdhënësit ndjenjën e mungesës së kontrollit dhe aftësisë për të funksionuar në nivel të arsyeshëm. Ata do të jenë në gjendje të menaxhojnë jetën e tyre, nuk do të këtë më pagjumësi të vazhdueshme, kokë-dhembja dhe simptoma të tjera me prejardhje të panjohur, ndryshimet në mënyrat e të ushqyerit, do të zvogëlohet konsumimi i duhanit, etj.
- Mësimdhënësit kujdestar do të dinë të përmirësoj balancimin e brendshëm, do të jenë në gjendje të kontrollojnë ngjarjet ndaj ndodhive në punë në mënyrë të balancuar dhe adekuate, aftësi kyçe në luftimin e stresit,
- Mësimdhënësit kujdestar do të jenë në gjendje për të ndryshuar stilin e sjelljeve, i cili është i futur thellë në ndërgjegjen e tyre, dh që shpesh del në sipërfaqe stresi në punë. Përmes trajnimit stresi nuk do të afekton moralin e përgjithshëm të punës, duke rezultuar në problemet personale dhe financiare. Do të zvogëlohet lodhja në punë, do të zvogëlohet ankesa shëndetësore në lidhje me punën,
- Drejtoret e shkollave nuk do të gjenden në pozita vetizoluese. Situata stresuese në përpjekje për të kënaqur nevojat e stafit të vet, vendimet lidhur me të ardhmen e stafit të vet, etj. Do të jetë në gjendje të dinë të menaxhoj shumë kërkesa dhe shumë përgjegjësi. Stresin do ta menaxhojnë me relaksim. Menaxhimi i kohës do të jetë çështja kryesore për të menaxhuar stresin në vendin e punës do të jetë në gjendje të këtë kohë të mjaftueshme gjatë orarit për të bërë gjithë ato punë që duhet të bëhen përmes organizimit më të mirë të kohës dhe atë përmes implementimit të disa sistemeve të thjeshta.

Përmbajtja:

Programi: Puna e kujdestarit të klasës – kusht për disiplinë të lartë dhe rezultate më të mira në mësim – Kujdestari i mirë, synon të kontribuojë në menaxhimin dhe udhëheqjen efikase të klasës dhe përmirësimin e sjelljeve të nxënësve në procesin edukativ – arsimor. Në këtë kontekst, synohet vetëdijesimi i nxënësve për reflektim pozitiv, ngritje të cilësisë dhe promovimin e vlerave pozitive në dobi të eliminimit të të gjitha llojeve të

dukurive që shpien në sjellje të papranueshme.

Nëpërmjet tre moduleve të përfshira në këtë program, synohet të rritet përgjegjësia dhe afiniteti i nxënësve të të gjitha niveleve për përkushtim në kryerjen e aktiviteteve të përditshme shkollore, në dobi të promovimit të vlerave qytetëruese. Realizimi i këtij programi synon të orientoj kujdestarët e klasave, që nga nivelet fillestare deri te ato më të larta të arsimit parauniversitar, të ngrisin aftësitë, shkathtësitë dhe vlerat te nxënësit për sjellje korrekte dhe përvetësim të vlerave të mirëfillta qytetëruese. Edukimi nga kujdestarët për vlerat shoqërore: respektin, tolerancën, dinjitetin, sjelljet qytetëruese, bashkëpunimin, të menduarit, etj, janë garancë e arritjes së qëllimeve në arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Programi synon të përcakton detyrimet ndaj nxënësve e prindërve, të qartëson rolet dhe procedurat e institucioneve shkollore, të organizoj dhe krijoj një strukturë të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet grupeve të ndryshme të akterëve të shkollës për rritjen e efikasitetit në edukim dhe arsimim cilësor.

Metodat e realizimit të programit

Metodologjia që do të përdoret në ofrimin e këtij programi trajnues ndërlidhet me qasjen si vijon:

- **Ligjërata dhe komente të shkurta gjatë diskutimeve** – për të nxitur pjesëmarrësit.
- **Informata kthyesë ose reagimet e pjesëmarrësve** – duke u përgjigjur ose duke ofruar sugjerime apo komente sipas nevojës.
- **DVD-te, video sekuenca** – Pjesë të shkurta dhe të zgjedhura mirë nga DVD ose video mund ti ilustrojnë qeshjet për diskutim të mëtejme apo prezantime lidhur me studime të rastit për punën e mëtutjeshme të grupit.
- **Loja e roleve ne grupe** – iu mundëson pjesëmarrësve që ti praktikojnë aftësi dhe ti përjetojnë aktivitet, duke ofruar përvoja të mira të situatave jetësore reale dhe ti mësojnë konceptet.
- **Puna grupore, ne çifte, grupe te vogla ose te mëdha** – Ilustron

	çështjen duke iu mundësuar pjesëmarrësve që ti shërbejnë idetë përvojat dhe pikëpamjet si dhe ta thellojnë kuptimin e tyre të detyrës dhe temës së grupit punues • Seanca plenare – këtu shkëmbehen informatat dhe qëndrimet në një grup të tërë, pjesëmarrësit mund të inkurajohen që të kontribuojnë duke parashtruar komentet, reagime ose pyetje.
Certifikimi	Programi trajnues pra, përmban gjithsej 6 ditë të plota dhe rrjedhimisht 48 orë trajnimi. Kështu, kandidati që e përfundon me sukses këtë program trajnues do të pajiset me certifikatë e cila përmban specifikat e trajnimit dhe numrin total të orëve të trajnimit që në këtë rast janë 48 orë trajnimi. Vlerësimi i pjesëmarrësve bazohet në vijueshmërinë, angazhimin në trajnime si dhe porfolio (dosja) e bazuar në detyrat që iu jepen nga ana e trajnerit.
Trajner	Organizata, përmes Trajnimit të Trajnerëve, ka rekrutuar një numër të konsiderueshëm të trajnerëve të cilët janë sprovuar tanimë me angazhime konkrete në teren. Janë realizuar trajnime me mbi 30 grupe të pjesëmarrësve. Lista e trajnerëve numëron 40 trajnerë, të cilët për nga profesioni janë dy llojesh - punëtorë arsimorë (30) dhe psikologë klinik (10). Trajnerët që janë punëtorë arsimorë, realizojnë dy modulet e para të Programit Trajnues kurse trajnerët psikologë klinik, realizojnë Modulin 3 të Programit Trajnues (Menaxhimi i stresit te punëtorët arsimorë)
Data	6 gusht 2020

Titulli i Programit	Zbatimi i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës
Titulli i organizatës	Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti i Edukimi
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim në Arsim- IHZHA
Adresa:	rr. Agim Ramadani, nr 350, 10000 Prishtinë
E-mail:	ihzha@uni-pr.edu
Telefoni:	038 229201
Numrat dhe data e aprovimit:	rr. 42/2021 datë: 07.04.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Programi organizohet në formë të një moduli – 4 ditor, që do të zhvillohet gjatë një periudhe një mujore. Programi ka gjithsej 32 orë.
Përfituesit:	Ky program i dedikohet mësimitdhënësve të klasave 1-12 të të gjitha fushave, gjithashtu edhe studentëve, të cilët janë duke u përgatitur si mësimitdhënës të ardhshëm.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 15-25.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të këtij programi të trajnimit, mësimitdhënësit do të jenë në gjendje të: • Kuptojnë reformën kurrikulare • Identifikojnë sfidat e reformës kurrikulare • Identifikojnë veprimet që nevojiten për plotësimin e nevojave të kurrikulës së re • Zhvillojnë plan-programe për kurrikulën e reformuar dhe lëndët zgjedhore
Përmbajtja:	Moduli do t'u ofrojë mësimitdhënësve mundësi të familjarizimit me parimet kryesore të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (KKK) që është miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në gusht 2011 dhe rishikuar në vitin 2016. Moduli do të udhëzojë drejt një procesi të të menduarit dhe reflektimit mbi praktikën profesionale aktuale dhe se çfarë do të thotë KKK-ja për besimet dhe praktikën në kontekstin shkollor në Kosovë. Pjesëmarrësit prezantohen me kërkesat e kurrikulës së re dhe orientohen drejt të kuptuarit dhe metodave që kërkohen për të nxënë të bazuar në rezultate dhe kritere. Moduli shpjegon rolin e kornizës së kurrikulës dhe prezantimin e zbatimit të kurrikulave bërthamë përmes planifikimit koherent dhe të harmonizuar.
Metodat e realizimit të programit	Pas përfundimit të këtij programi të trajnimit, mësimitdhënësit do të jenë në gjendje të: • Mësimdhënie interaktive • Punë grupe • Punë praktike të bazuar në kontekst

	Qasja e punës do të jetë e bazuar në ngritjen e debateve.
Certifikimi	Pjesëmarrësit do të marrin certifikata të njohura dhe të nënshkruara nga FE/IHZHA dhe MASHTI për pjesëmarrje dhe përfundim të programit të trajnimit.
Trajner	1. Hatixhe Ismajli 2. Naser Zabeli 3. Eda Vula 4. Vjollca Ahmedi 5. Jehona Ferizi 6. Jehona Rrustemi 7. Arlinda Beka 8. Zeqir Veselaj 9. Fatlume Berisha 10. Arlinda Damoni
Data	Gusht, 2021

Titulli i Programit	Vlerësimi i leximit në klasat e hershme – A-EGRA
Titulli i organizatës	Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti i Edukimi
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim në Arsim- IHZHA
Adresa:	rr. Agim Ramadani, nr 350, 10000 Prishtinë
E-mail:	ihzha@uni-pr.edu
Telefoni:	038 229201
Numrat dhe data e aprovimit:	rr. 42/2021 datë: 07.04.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Trajnimi është e paraparë të zhvillohet në tre (3) ditë trajnimi dhe kohën e paraparë për plotësimin e portfolios dhe aktiviteteve testuese me nxënësit. Dy ditët e trajnimit mbahen të njëpasnjëshme ndërsa dita e tretë e trajnimit mbahet pasi një periudhe dy- tre javore në mënyrë që mësime të mund të zbatohen praktikisht njohurit e fituara gjatë trajnimit. Programi ka gjithsej 20 orë.
Përfutjesit:	Ky program i dedikohet mësimeve të nivelit fillor, me qëllim që të zgjerojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre për të vlerësuar progresin e fëmijëve gjatë përvetësimit të shkathtësive të lexim-shkrimit me qëllim të mbështetjes së tyre në këtë drejtim.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 15-25.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të këtij programi të trajnimit, mësimeve do të jenë në gjendje të: • Vlerësojnë nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të testit EGRA • Administrojnë testin EGRA • Identifikojnë nxënësit që kanë nevojë për përmirësimin e shkathtësive të leximit • Dallojnë nevojat specifike të leximit • Zbatojnë strategji për përmirësimin e leximit • Hartojnë plane mësimore duke integruar strategji për përmirësimin e leximit.
Përmbajtja:	Trajnimi është paraparë të zhvillohet përgjatë tre ditëve, dhe secila ditë e trajnimit ka të paraparë aktivitetet përkatëse. Në ditën e parë të trajnimit, pjesëmarrësit gjatë seancave të para do të diskutohet mbi rëndësinë e vlerësimit të leximit në klasat e ulta, do të familjarizohen me formularët e EGRA-së dhe do të aftësohen në përdorimin e teknologjisë gjatë testimeve të EGRA-së. Në ditën e dytë të trajnimit, pjesëmarrësit gjatë seancës së parë do të diskutojnë mbi administrimin e testit, dhe në seanca të veçanta do të diskutohen të gjitha nëntestet dhe administrimi i tyre duke përfunduar me reflektimin dhe planifikimin e hapave të mëtejshëm.

	Më pas pjesëmarrësit do të mund të zbatojnë praktikisht me nxënës testimet e EGRA-së dhe në varësi të rezultateve të planifikojnë strategji, plane dhe aktivitete mësimore për përmirësimin e rezultateve të testimit. Në ditën e tretë të trajnimit do të diskutohen dhe analizohen rezultatet mbi bazën e të cilave mësimdhënësit do të zhvillojnë edhe planifikimet për aktivitete mësimore me qëllim të përmirësimit gradual të rezultateve të arritura dhe ritestimit.
Metodat e realizimit të programit	Aktivitetet e planifikuara për përmbushjen e rezultateve të parapara me program, janë kombinim i punës individuale, në çifte dhe asaj në grupe. Fillimisht pjesëmarrësit udhëzohen për administrimin e testit EGRA, e praktikojnë atë dhe më pas udhëzohen për përdorimin e strategjive për përmirësim.
Certifikimi	Pjesëmarrësit do të marrin certifikata të njohura dhe të nënshkruara nga FE/IHZHA dhe MASHTI për pjesëmarrje dhe përfundim të programit të trajnimit.
Trajner	1. Arlinda Beka 2. Blerta Perolli Shehu 3. Edona Berisha 4. Majlinda Gjellaj 5. Rozafa Ferizi Shala 6. Teuta Danuza 7. Vjollca Ahmedi 8. Jehona Ferizi-Miftari 9. Jehona Rrustemi 10. Albulena Metaj 11. Valentina Nimonaj
Data	Gusht, 2021

Titulli i Programit	Integrimi i edukimit për qëndrueshmëri në klasa
Titulli i organizatës	Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti i Edukimi
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim në Arsim- IHZHA
Adresa:	rr. Agim Ramadani, nr 350, 10000 Prishtinë
E-mail:	ihzha@uni-pr.edu
Telefoni:	038 229201
Numrat dhe data e aprovimit:	rr. 42/2021 datë: 07.04.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Orët e trajnimit: 4 Mentorimi: 4 Detyrat e kursit: 8 Totali i orëve: 16
Përfituesit:	Ky kurs online synon integrimin e çështjeve të qëndrueshmërisë në fushat kurrikulare dhe lëndët mësimore duke filluar që nga fëmijëria e hershme e deri në përfundim të sistemit parauniversitar të arsimit (K-12). Pranda trajnim synon mësimdhënës nga këto fusha: - Edukatore të fëmijërisë së hershme (kopshteve dhe çerdheve) - Mësimdhënës të ciklit fillor (që mbajnë të gjitha lëndët), - Mësimdhënës lëndor të fushave: gjuhë e komunikmi, arte, matematikë, shkenca natyrore, shkenca shoqërore.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15-20 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të këtij programi të trajnimit, mësimdhënësit do të jenë në gjendje të: • definojnë dhe shpjegojnë konceptet kyqe të zhvillimit të qëndrueshëm dhe edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm në kurrikulën zyrtare; - aplikojnë qasjen e 4 Mënyrave të të Menduarit (Four Ways of Thinking): të menduarit për të ardhmen, të menduarit strategjik, të menduarit sistemik dhe të menduarit në vlera; - të përgatisin aktivitete mësimore bazuar në katër mënyrat e të menduarit dhe të menduarit me standarde; - integrojnë tema të caktuara nga lista e “100 temave të qëndrueshmërisë” në planprogramet e tyre mësimore; - të dizajnojnë aktivitete mësimore me qasje të integruar ku qëndrueshmëria integrohet në lëndët e tyre respektive gjatë mësimin
Përmbajtja:	Në fund të kompletimit të përmbajtjes online të kursit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të: - zbatojnë kurrikulë e re të bazuar në kompetenca- përfshirë atë me qasje të mësimdhënies së integruar me qëndrueshmërinë si fokus; - bëjnë zhvillimin e përmbajtjeve të reja (tema të integruara të

	qëndrueshmërisë) dhe metoda të reja pedagogjike; - zhvillojnë shkathtësi të mendimit kritik- përmes zhvillimit dhe aplikimit të kornizës së 4 mënyrave të të menduarit tek pjesmarrësit dhe nxënësit e tyre; - shfrytëzojnë teknologjinë përmes ndjekjes së trajnimit online dhe përgatitjes së përmbajtjeve mësimore online; - aplikojnë planifikimin e orës me qasjen e integruar të qëndrueshmërisë; - menaxhimin e klasës përmes aktiviteteve praktike që lidhin qëndrueshmërinë me mësimdhënien; - motivojnë nxënësit për të menduar se si vendimet dhe veprimet e tyre të sotme mund të ndikojnë në të ardhmen të shoqërisë që i takojnë. Përveq këtyre nga pjesmarrësit pritet që të: - Mësojnë dhe vendosin mbi Katër Mënyrat e të Menduarit të domosdoshëm për qëndrueshmërinë; - Përfundojnë dy aktivitete në lidhje me standardet e të nxënit dhe kurrikulën e integruar; - Lidhen me mësimdhënës të tjerë dhe qasen në kurrikulën e qëndrueshmërisë të hartuar nga të tjerë nga i gjithë vendi
Metodat e realizimit të programit	Trajnimi ofrohet në formën online dhe si i tillë do të kursej pjesmarrësit e nga udhëtimi nga qendrat tjera, humbja e orëve të punës, shpenzimet e udhëtimit dhe të tjera. Sesionet e trajnimit do të jenë të kombinuara: - Takime virtuale në Google meet për diskutimin e njohurive dhe e detyrave; - Disuktime e debate të pjesmarrësve me trajnerët dhe mes vete në platformën Padlet - Shkarkimi i videove online në gjuhën shqipe për përgatitjen e aktiviteteve mësimore nga edukatorët; - Shkarkimi i formave online (formularëve, planeve mësimore etj) përdetyrat e dhëna për pjesmarrësit ; - Prezantimi i aktiviteteve të integritit të temave të qëndrueshmërisë në klasat e tyre.
Certifikimi	Pjesëmarrësit do të marrin certifikata të njohura dhe të nënshkruara nga FE/IHZHA dhe MASHTI për pjesëmarrje dhe përfundim të programit të trajnimit.
Trajner	1. Zeqir Veselaj 2. Blerta Perolli-Shehu
Data	Gusht, 2021

Titulli i Programit	Vlerësimi përmblendhës i nxënësve: Hartimi i testit
Titulli i organizatës	Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti i Edukimi
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim në Arsim- IHZHA
Adresa:	rr. Agim Ramadani, nr 350, 10000 Prishtinë
E-mail:	ihzha@uni-pr.edu
Telefoni:	038 229201
Numrat dhe data e aprovimit:	rr. 42/2021 datë: 07.04.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Programi organizohet në formë të 1 moduli 4 ditor, i cili zhvillohet gjatë një periudhe 1 mujore. Koha në mes të mbajtjes së ditëve të trajnimit duhet të jetë së paku një javë. Një pjesë e trajnimit (2 ditë) do të fokusohet në shkëmbimin e praktikave të përgjithshme të vlerësimit përmblendhës dhe pjesa tjetër (2 ditë) në përpilimin e testeve përmblendhëse. Programi ka gjithsej 32 orë.
Përfutjesit:	Ky program i dedikohet mësuesve të klasave 1-12 të të gjitha fushave, gjithashtu edhe studentëve, të cilët janë duke u përgatitur si mësues të ardhshëm.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 15-25.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të këtij programi të trajnimit, mësuesit do të jenë në gjendje të: • Definojnë vlerësimin përmblendhës dhe rolin e tij; • Dallojnë elementet themelore, llojet dhe format e vlerësimit përmblendhës; • Krahajojnë vlerësimin përmblendhës me vlerësimin formues; • Përdorin procedurat standarde të hartimit të një testi për vlerësim përmblendhës; • Hartojnë teste vlerësuese duke dalluar nivelet sipas Taksonomisë së rishikuar të Blumit; • Ndërtojnë strukturën e testit – tabelën e specifikimeve të testit; • Shkruajnë lloje të ndryshme të pyetjeve sipas rregullave të përcaktuara; • Realizojnë, për të njëjtën kërkesë/pyetje, kalimin nga një nivel taksonomie në një tjetër; • Matin treguesit kryesorë të pyetjeve në përbërje të një testi përmblendhës; • Bëjnë lidhjen ndërmjet rezultateve mësimore me kompetencat e përcaktuara për shkallë të kurrikulës dhe përcaktojnë metodën e vlerësimit; • Planifikojnë vlerësimin përmblendhës bazuar në RNF dhe RNL të ndërlidhura me kompetencat sipas KK;

	• Realizojnë një vlerësim të drejtë, të saktë dhe të besueshëm, transparent dhe të paanshëm; • Zbatojnë vlerësimin përmbledhës si mjet për motivimin e nxënësve për të arritur kompetencat e synuara; • Përdorin rezultatet e vlerësimit për të marrë vendime për nxënësit, metodologjinë e mësimdhënies dhe kurrikulën; • Raportojnë vlerësimin përmbledhës para nxënësve, prindërve dhe të akterë ve të tjerë;
Përmbajtja:	Përmbajtja e trajnimit fokusohet në tematikat më poshtë: Llojet e vlerësimeve të nxënësve dhe roli i vlerësimit përmbledhës në procesin e mësimdhënies. – Format dhe parimet e vlerësimit. Aspektet e përgjithshme kulturore dhe gjuhësore të përmbajtjes. Zhvillimi i testit dhe lidhja e pyetjeve/kërkesave me rezultatet e të nxënësit për fushë dhe kompetenca për shkallë. - Tabela e testit, procedurat standarde të hartimit të një testi, pikëzimi dhe kthimi i pikëve në notë. Hartimi i pyetjeve sipas Taksonomisë së Blumit për nivelet e dijes, përmirësimi i pyetjeve, përmbajtja e testit. Llojet e pyetjeve, udhëzime të të shkruarit të pyetjeve, pyetjet me plotësim, pyetjet me alternativë, pyetjet me shoqërim, pyetjet me prezantim grafik, pyetjet me përgjigje të strukturuar, rregullat e shkrimit të tyre. Problemet, struktura e zgjidhjes së tyre. Hartimi i pyetjeve/kërkesave dhe lidhja e tyre me rezultatet e të nxënësit për fushë dhe kompetencën për shkallë. Analiza e testit/pyetjeve. - Analiza e pyetjeve, vështirësia e pyetjes, diskriminimi i pyetjes, shpeshësia e alternativës.
Metodat e realizimit të programit	• Mësimdhënie interaktive • Punë grupe • Punë praktike e bazuar në kontekst • Qasja e punës do të jetë e bazuar në ngritjen e debateve dhe argumentimeve.
Certifikimi	Pjesëmarrësit do të marrin certifikata të njohura dhe të nënshkruara nga FE/IHZHA dhe MASHTI për pjesëmarrje dhe përfundim të programit të trajnimit.
Trajner	1. Naser Zabeli 2. Arlinda Bytyqi - Damoni 3. Majlinda Zhitija – Gjellaj 4. Vjollca Ahmedi 5. Hatixhe Ismaili 6. Fatbardha Zogaj-Rekaj 7. Shpetim Kastrati 8. Dijana Qarkagjija 9. Fadil Latifi 10. Edi Puka
Data	Gusht, 2021

Titulli i Programit	Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore
Titulli i organizatës	Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti i Edukimi
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim në Arsim- IHZHA
Adresa:	rr. Agim Ramadani, nr 350, 10000 Prishtinë
E-mail:	ihzha@uni-pr.edu
Telefoni:	038 229201
Numrat dhe data e aprovimit:	rr. 42/2021 datë: 07.04.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	126 orë kontakti të drejtëpërdrejtë në trajnime, 7 orë mentoruese (nga një orë për secilin modul) dhe, 21 orë (nga tri orë për secilin modul) për kryerjen e detyrave dhe obligime praktike lidhur me programin e trajnimit. Pra, programi trajnues përmbanë gjithsej 154 orë për certifikim.
Përfituesit:	Mësimdhënësit në shërbim, drejtorët e shkollave (dhe ekipet e tyre të menaxhimit/Këshillin Drejtues të Shkollave, bashkëpunëtorët profesional të shkollës: pedagogun, psikologun apo/edhe koordinatorët e cilësisë dhe aktivat profesionale) dhe stafin e DKA-ve.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të këtij programi të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të: • Njihen me legjislacionin dhe mënyrat e zbatimit të tij për të avancuar dhe siguruar cilësinë në arsim. • Analizojnë dhe zbatojnë forma praktike të mbështetjes së procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. • Diskutojnë dhe planifikojnë përfshirjen e të gjithë fëmijëve/nxënësve në shkollë. • Planifikojnë dhe fillojnë së zbatuari pjesë të Planit Zhvillimor të Shkollës si dhe menaxhojnë projekte të ndryshme praktike. • Provojnë forma të efektshme të komunikimit dhe bashkëpunimit me akterët e shkollës. • Planifikojnë dhe zbatojnë udhëzimet për menaxhim të personelit të shkollës. • Zbatojnë forma efektive të menaxhimit të shkollës dhe udhëheqjes së takimeve.
Përmbajtja:	Moduli 1: E drejta për edukim – edukimi cilësor Ky modul prezanton konceptin e cilësisë së arsimit në kontekstin ndërkombëtar dhe kombëtarë, nënvizon marrëdhënien në mes të cilësisë së arsimit dhe rritjes ekonomike. Moduli gjithashtu trajton disa komponentë të Standardeve për praktikën profesionale të drejtorëve të shkollës. Moduli 2: Shkolla e mirë – mësimdhënia dhe të nxënies cilësorë Trajton fushat e cilësisë së shkollës dhe fushat për zhvillim të shkollës

	sipas PSAK (2017/2021), duke u fokusuar në kulturën e të mësuarit, kulturën e shkollës dhe nevojën për një strategji dhe vizion të zhvillimit të cilësisë në aspektin afatgjatë dhe afatmesëm bazuar në dokumente të hartuara për zbatim të Kurrikulës, zhvillimit profesional të mësimeve dhe vlerësimit të nxënësve. Moduli 3: Gjithëpërfshirja në arsim Ky modul trajton tematikën e gjithëpërfshirjes në shkollë në mënyrë që të mbështesë udhëheqësit në sigurimin e ambientit gjithëpërfshirës në shkollë për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë të nxënësve me nevojave të ndryshme mësimore në klasat/shkollat e sotme. Moduli gjithashtu synon t'i ekspozojë pjesëmarrësit me të dhëna dhe situata të ndryshme duke diskutuar aspektet e gjithëpërfshirjes në arsim në Kosovë. Moduli 4: Plani zhvillimor i shkollës dhe menaxhimi i projektit Ky modul ofron një qasje të strukturuar për të shtjelluar planin për zhvillim të shkollës. Formatit dhe udhëzuesi i Planit Zhvillimor të Shkollës (PZSH) mbështetë këtë proces duke ofruar një strukturë për hapat e njëpasnjëshëm që janë të nevojshëm për të identifikuar projektet primare për vitin e radhës. Fazat e inicimit, planifikimit, ekzekutimit dhe vlerësimit të projektit shpjegohen në bazë të ciklit për menaxhim të projektit. Moduli 5: Komunikimi dhe bashkëpunimi Komunikimi në një shkollë përshkruhet në detaje. Trajtohet komunikimi dhe bashkëpunimi me dhe në mes të arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve, si dhe komunikimi ndërmjet shkollave përmes rrjetëzimit (komunitete e të mësuarit së bashku). Prezantohet baza ligjore, përbërja dhe roli i strukturave të ndryshme të shkollës siç janë: Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli i nxënësve, Këshilli i prindërve. Moduli 6: Udhëheqja dhe menaxhimi i personelit Prezantohen disa lloje të udhëheqjesë tema e delegimit shpjegohet në detaje. Nevoja për zhvillim sistematik të stafit, bazuar në vlerësim individual, zhvillimi profesional i mësimeve dhe stafit jomësimor, prezantohen dhe diskutohen. Moduli 7: Administrimi efektiv i shkollës dhe udhëheqja e takimeve Moduli mbi administratën në shkollë fokusohet në menaxhimin e suksesshëm të kohës, dhe administrimin e dokumenteve, duke përfshirë arkivimin e dokumenteve elektronike dhe fizike, planifikimin, organizimin dhe kryesimin e takimeve në mënyrë produktive.
Metodat e realizimit të programit	Gjatë trajnimit do të përdoret metoda interaktive e punës, ku pjesëmarrësit do të jenë në qendër të veprimtarisë, do të punohet në grupe dhe në vazhdimësi do të përdoren forma të ndryshme të punës që të mbajnë aktiv gjatë tërë kohës. Pas secilës punëtori do të organizohen sesione monitoruese ku do të përcillet puna dhe progresi i pjesëmarrësve.
Certifikimi	Pjesëmarrësit do të marrin certifikata të njohura dhe të nënshkruara nga FE/IHZHA dhe MASHTI për pjesëmarrje dhe përfundim të programit të trajnimit.

Trajner	1. Naser Zabeli 2. Blerim Saqipi 3. Majlinda Gjelaç 4. Rozafa Ferizi Shala 5. Blerta Perolli Shehu 6. Albulena Metaj 7. Teuta Danuza 8. Ismet Potera 9. Osman Buleshkaj 10. Selim Mehmeti 11. Zana Zeqiri
Data	Gusht, 2021

Titulli i Programit	Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie
Titulli i organizatës	Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti i Edukimi
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim në Arsim- IHZHA
Adresa:	rr. Agim Ramadani, nr 350, 10000 Prishtinë
E-mail:	ihzha@uni-pr.edu
Telefoni:	038 229201
Numrat dhe data e aprovimit:	rr. 42/2021 datë: 07.04.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Orët e trajnimit: 24 Prezantimi i detyrave të kursit: 6 Totali i orëve: 30
Përfituesit:	Ky program trajnimi synon zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve në shërbim, të klasave 1-12 për integrimin e TIK-ut në mësimdhënie me fokus rritjen e interaktivitetit mësimdhënës-nxënës dhe përdorimit të burimeve online. Ky program i trajnimit i dedikohet mësimdhënësve në shërbim të klasave 1 deri 12
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të këtij programi të trajnimit, mësimdhënësit do të jenë në gjendje të: • përdorin teknologjitë e avancuara të informacionit dhe komunikimit për mbështetjen e mësimdhënies dhe të nxënësve elektronik dhe edukimit në distance; • përdorin TIK-un si mjet për motivimin e nxënësve për të arritur kompetencat e synuara; • bëjnë dallimin në mes të mësimdhënies interaktive dhe asaj jointeraktive; • krijojnë dhe shfrytëzojnë i-materialet; • krijojnë materiale multimediale për mësimdhënie interaktive; • përdorin PollEverywhere për krijimin e prezantimeve interaktive në Poëer Point; • përdorin Kahoot për gjithëpërfshirje dhe angazhim të nxënësve për të nxënë; • shfrytëzojnë simulimet për konkretizim dhe demonstrim të përmbajtjeve mësimore; • krijojnë dhe shfrytëzojnë klasa virtuale; • krijojnë instrumente për vlerësim online.
Përmbajtja:	Duke ju referuar profilin e kompetencave të mësimdhënësve të përgatitura nga MASHT-i dhe Kornizës së përgjithshme të standardeve të profesionit/kompetencave të përgjithshme, (MASHT, 2017) (MASHT, Prill 2017) ky program trajnimi është i ndërlidhur me standardin e katërt,

	përkatësisht me fushën shkathtësitë dhe praktikat profesionale. Përmbajtjet e këtij programi të trajnimit e të cilat ndërlidhen me treguesit e këtij standardi, janë: ☐ Përdorimi i teknologjive të avancuara të edukimit për mësimdhënie interaktive, si dhe për t'i motivuar nxënësit dhe për të nxitur të menduarit e nivelit të lartë; ☐ Përzgjedhja dhe shfrytëzimi i teknologjive të duhura për të realizuar mësimdhënien dhe të nxënit interaktiv; ☐ Krijimi i materialeve mësimore interaktive për temat e caktuara, si dhe krijimi i materialeve elektronike në rastet ku mungon literatura; ☐ Përdorimi i teknologjive adekuate të edukimit në mënyrë adekuate, të sigurt, me përgjegjësi dhe me etikë.
Metodat e realizimit të programit	Trajnimi do të realizohet duke shfrytëzuar metoda interaktive trajnuese, ku në fillim do të jetë pjesa e trajnimit përmes trajtimit konceptual e teorik i përmbajtjes dhe mandej do të kalohet në demonstrim dhe aplikim praktikë nga ana e pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit do të kryejnë detyra të parapara si aktivitet në kuadër të secilës platformë të përfshirë në trajnim si dhe do të kenë realizimin dhe prezantimin e një detyre përfundimtare që do të jetë edhe pjesë e vlerësimit përfundimtarë për arritjen e rezultateve të programit. Poashtu do të shfrytëzohen edhe platformat si: Poëll Evryëhere https://ëëë.polleveryëhere.com/ Zoho https://ëëë.zoho.com/shoë/ Kahoot! https://create.kahoot.it/ PHET https://phet.colorado.edu/en/simulations Google Classroom https://classroom.google.com/ Paisjet e nevojshme për realizimin e këtij trajnimit janë ☐ Laptop ose kompjuter desktop me sistem operativ të azhurnuar ☐ Lidhje interneti 4Mbps ose më të shpejtë (provë)
Certifikimi	Pjesëmarrësit do të marrin certifikata të njohura dhe të nënshkruara nga FE/IHZHA dhe MASHTI për pjesëmarrje dhe përfundim të programit të trajnimit.
Trajner	1. Kyvete Shatri 2. Kastriot Buza 3. Florent Bunjaku
Data	Gusht, 2021

Titulli i Programit	Mësimdhënia dhe të nxënit e shkencave natyrore në klasat 1-5
Titulli i organizatës	Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti i Edukii
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim në Arsim- IHZHA
Adresa:	rr. Agim Ramadani, nr 350, 10000 Prishtinë
E-mail:	ihzha@uni-pr.edu
Telefoni:	038 229201
Numrat dhe data e aprovimit:	rr. 42/2021 datë: 07.04.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Programi organizohet në formë të një moduli – 4 ditor, që do të zhvillohet gjatë një periudhe një mujore. Programi ka gjithsej <u>30 orë</u> .
Përfituesit:	Ky program i dedikohet zhvillimit dhe aftësimit profesional të mësimdhënësve në nivelin e shkollave fillore (ISCED 1), klasat 1-5 me fokus të veçantë në njohuritë e shkencave natyrore. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për mësimdhënësit e ardhshëm të këtij niveli.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim do të jetë 15-25.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të këtij programi të trajnimit, mësimdhënësit do të jenë në gjendje të: • Zbatojnë strategji, metoda dhe teknika ndërvepruese të mësimdhënies dhe të nxënit, që mundësojnë ndërtimin dhe krijimin e njohurive të nxënësit, formimin e shprehive, zhvillimin e kompetencave në përputhje me Kornizën e Kurrikulës dhe rezultatet e të nxënit në fushën kurrikulare Shkencat natyrore. • Përdorin veprimtari të shumëllojshme dhe të efektshme për shprehitë e procesit në shkencat e natyrës: vëzhgimin, krahasimin, klasifikimin dhe analizën, të cilat ndihmojnë nxënësit në ndërtimin e koncepteve për dukuritë natyrore dhe për zgjidhjen e detyrave të ndryshme me karakter vëzhgues dhe hulumtues. • Përshtasin mësimdhënien e tyre nevojave dhe mundësive të nxënësve, duke përdorur metoda ndërvepruese dhe të nxënit aktiv, të cilat nxisin të menduarin kritik dhe formojnë nxënës të pavarur, • Zhvillojnë imagjinatën dhe krijimtarinë e nxënësve përmes përdorimit të organizuesve grafikë dhe mjeteve të tjera pamore, • Përdorin mjete të ndryshme konkretizuese me qëllim të aftësimit të nxënësve për hulumtim të informacioneve të ndryshme në Internet, të nxënit e koncepteve shkencore përmes situatave simuluese ose reale dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësit në këtë lëndë.
Përmbajtja:	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka përgatitur profilin e kompetencave që një mësimdhënës duhet të ketë. Me anë të programit “Mësimdhënia dhe të nxënit e shkencave natyrore në klasat 1 - 5 të

	shkollës fillore” synohet të zhvillohen kompetencat e mësimdhënësve që kanë të bëjnë me metodologjinë dhe përmbajtjen akademike. Përmes këtij programi mësimdhënësit do të aftësohen në përdorimin e strategjive dhe metodave ndërvrepuese me qëllim të nxitjes së mendimit kritik tek nxënësit, formimin e shprehive si dhe zhvillimin e kompetencave në përputhje me Kornizën Kurrikulare.
Metodat e realizimit të programit	• Mësimdhënie interaktive • Punë grupe • Punë praktike e bazuar në kontekst • Qasja e punës do të jetë e bazuar në ngritjen e debateve.
Certifikimi	Pjesëmarrësit do të marrin certifikata të njohura dhe të nënshkruara nga FE/IHZHA dhe MASHTI për pjesëmarrje dhe përfundim të programit të trajnimit.
Trajner	1. Zeqir Veselaj 2. Arlinda Damoni 3. Ilir Mazreku 4. Jeton Halili 5. Fitore Malaj 6. Lulzim Thaqi 7. Fadil Latifi 8. Shpëtim Kastrati 9. Musaj Paçarizi 10. Selim Qevani 11. Alban Hyseni
Data	Gusht, 2021

Titulli i Programit	Metodologjia Montessori për edukimin në fëmijërinë e hershme (mosha 0-6 vjeç)
Titulli i organizatës	Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti i Edukimi
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim në Arsim- IHZHA
Adresa:	rr. Agim Ramadani, nr 350, 10000 Prishtinë
E-mail:	ihzha@uni-pr.edu
Telefoni:	038 229201
Numrat dhe data e aprovimit:	rr. 42/2021 datë: 07.04.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Programi organizohet në formë të 6 moduleve brenda dy viteve dhe secili modul përmbanë 40 orë trajnimi. Gjithsej 240 orë.
Përfituesit:	Edukatorët të cilët punojnë me fëmijët e moshave 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç në kopsht ose shkollat fillore me klasat parafilllore. Pjesëmarrësit në këtë trajnim duhet të kenë përvojë pune në profeson, së paku 3 vite për arsye se nevojitet një bazë e kompetencave për punë me fëmijët e moshave përkatëse.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim do të jetë 15-25.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të: • Stimulojnë fëmijët për zhvillim të shkathtësive për jetë (kujdesin ndaj vetes, ndaj ambientit, mirësjelljen, vetëkontrollit, etj; • Përkrahin fëmijët për të nxënë duke përdorur të gjitha shqisat; • Zhvillojnë aktivitete të cilat nxisin të menduarit matematikor përmes punës me materiale specifike montessori; • Stimulojnë zhvillimin e gjuhës dhe komunikimit tek fëmijët duke përdorur strategji dhe materiale specifike montessori; • Zhvillojnë aktivitete që nxisin njohjen e vetës, njohjen e të tjerëve dhe njohjen e Botës që na rrethon duke hulumtuar dhe eksperimentuar me materiale specifike; • Krijojnë materiale didaktike të cilat nxisin zhvillimin dhe të nxënësve të fëmijës. • Vëzhgojnë dhe dokumentojnë zhvillimin dhe përparimin e fëmijëve si dhe janë në gjendje të planifikojnë dhe nxisin fëmijët në drejtimin që kanë nevojë, interesim dhe dëshirë.
Përmbajtja:	Përmbajtja e programit të metodologjisë Montessori i shërben zhvillimit profesional të edukatorëve në shërbim nëndërlidhje me shumicën e kompetencave të edukatorëve duke përfshirë: zbatimin e strategjive dhe metodologjive të të mësuarit të cilat pasqyrojnë vlerat demokratike dhe zhvillimin e gjithmbarshëm të personalitetit; aftësitë komunikuese me partnerët kryesor, prindërit dhe komunitetin; vlerësimin dhe planifikimin e bazuar në nevojë, interesa dhe dëshira të fëmijëve; ndërveprimin me fëmijë, si dhe sigurimin e një ambienti stimulues për të nxënë. Trajnimi ofrohet në kuadër të 6 moduleve: Ushtrime të jetës praktike Materiali shqisor dhe muzika Matematika Zhvillimi gjuhësor

	6. <i>Blerina Komoni</i> 7. <i>Adrian Rudi</i> 8. <i>Albert Konushevci</i> 9. <i>Lirije Bytyqi Beqiri</i> 10. <i>Marjan Tahiri</i> 11. <i>Shahe Kameri</i> 12. <i>Shkëndia Jashari</i> 13. <i>Shpëtim Kastrati</i> 14. <i>Armen Mustafa</i> 15. <i>Eshref Gerbeshi</i> 16. <i>Fitore Maçani Halimi</i> 17. <i>Florije Kryeziu</i> 18. <i>Lumnie Tahiri</i> 19. <i>Remzije Osmani</i> 20. <i>Sala Ferati</i> 21. <i>Nexhmedin Sejdiu</i> 22. <i>Remzije Krasniqi</i> 23. <i>Shani Kryeziu</i> 24. <i>Valentina Nimonaj Hoti</i> 25. <i>Shyhrete Alaj</i> 26. <i>Donika Koliqi</i> 27. <i>Luljeta Shala</i> 28. <i>Taurika Istrefi</i> 29. <i>Hyra Sogojeva</i> 30. <i>Haki Shoshi</i> 31. <i>Violete Brahimi</i>
Data	16.11.2021

Titulli i Programit	Mësimdhënia në distancë
Titulli i organizatës	<i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)</i>
Tipi i programit:	<i>Program trajnues themelor</i>
Ofertuesi i programit:	<i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)</i>
Adresa:	<i>Gazmend Zajmi No. 80, 10000 Pristina, Republic of Kosovo</i>
E-mail:	rezearta.zhinipotoku-behluli@giz.de
Telefoni:	??????
Numrat dhe data e aprovimit:	28/2021 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Numri i orëve të trajnimit është 28 orë - Trajnim dhe prezantim i detyrave të shtëpisë (kontakt i drejtpërdrejtë) - 21 orë - Detyrat e shtëpisë (portfolio) - 7 orë
Përfituesit:	<i>Grupet e synuara të mësimdhënësve për këtë trajnim janë mësimdhënësit e shkollave fillore. Në kuadër të projektit CDBE (Capacity Building for Basic Education) kërkesa për këtë aktivitet ka ardhur si rezultat i identifikimi të nevojave të mësimdhënësve në arsimin fillor. Fillimisht janë zgjedhur 20 shkolla model si pjesëmarrëse të këtij trajnimi ndërkaq synohet që trajnimi me këtë përzgjedhje të ketë edhe efektin e multiplikimit. Duke pasur parasysh moshën e nxënësve me të cilët punohet në shkollat fillore, mësimdhënësit e këtij niveli duhet të pajisen me shkathtësitë e duhura didaktike dhe teknike për mësimdhënie kualitative në distancë. Përveç arsytimit se një trajnim i tillë inovativ dhe me shkathtësi të përditësuar të mësimdhënies në distancë ka rëndësi për të bërë karrierën e një mësimdhënësi sa më komplementare, një arsye tjetër shtesë e përzgjedhjes së këtyrë mësimdhënësve për këtë trajnim ka qenë situata me pandeminë Covid-19 ku aftësia për mësimdhënien adekuate në distancë ka qenë kritike për realizimin e mësimi.</i>
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	<i>Një grup i pjesëmarrësve në trajnim do të ketë 22- 25 pjesëmarrës</i>
Rezultatet e pritura ose	3.2 Rezultatet e programit

objektivat e programit:	<i>Në përfundim të programit të trajnimit për Mësimin në Distançë, pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:</i> ▪ <i>Komunikojnë me sukses dhe në mënyrë profesionale gjatë mësimdhënies në distancë;</i> ▪ <i>Organizojnë me sukses një orë mësimore në distancë dhe atë në mënyrë të pavarur;</i> ▪ <i>planifikojnë mësimdhënien dhe vlerësimin e mësimdhënies në distancë;</i> ▪ <i>përdorin platforma për qasjen praktike në mësimdhënien në distancë (tabela digjitale, virtuale, platforma për punë grupore online etj.)</i> ▪ <i>integrojnë në orët e tyre mësimore didaktikën digjitale si formë e mësimdhënies;</i> ▪ <i>bëjnë vlerësimin e nxënëve në mënyrë korrekte dhe profesionale nga distanca;</i> ▪ <i>përfshijnë në kurrikulat e tyre disa nga këto platforma inovative;</i> ▪ <i>reflektojnë mbi trendet e arsimit modern (mësimin hibrid për të ardhmen)</i> ▪ <i>organizojnë shkëmbimin e përvojave të mësimdhënësve, mentorim kolegjial, në kuadër të aktiviteteve për shkëmbimin e përvojave më të mira në nivel të shkollës;</i> ▪ <i>bëjnë përzgjedhjen dhe krijimin e materialit didaktik të nevojshëm për mësimdhënien e suksesshme në distancë;</i>
Përmbajtja:	<i>Përmbajtja e programit të trajnimit përfshinë tema në vijim:</i> 1. <i>Komunikimi, çelës i suksesit gjatë mësimdhënies në distancë</i> – si dhe përse organizohet komunikimi gjatë mësimdhënies në distancë; 2. <i>Përdorimi i platformave elektronike gjatë mësimdhënies në distancë</i> – platformat digjitale që duhet të inkuadrohen në mësimdhënien në distancë me qëllim të rritjes së qasjes praktike; 3. <i>Planifikimi, organizimi dhe aplikimi i vlerësimit (notimit) të nxënësve gjatë mësimin në distancë</i> – njohja me metodologjinë dhe prezentimi i platformave përmes të cilave organizohet vlerësimi online si dhe marrja e feedback-ut. <i>Didaktika elektronike</i> – këshillimi dhe aftësi për pasurimin e aftësive për

	<i>metodologjinë e mësimdhënies online / didaktikës elektronike.</i>
Metodat e realizimit të programit	3.5 Metodologjia që do të përdoret në ofrimin e programit trajnues <i>Programi organizohet në formë të 1 modul 2-ditorë dhe nje dite e trete shtese, e keto 3 dite ne teresi zhvillohen gjatë një periudhe 1 mujore. Koha në mes të mbajtjes së moduleve duhet të jetë së paku dy javë. Një pjesë shtesë e trajnimit (1 dite) do të fokusohet në shkëmbimin e praktikave në implementimin e njohurive të marra nga trajnimi në formë të mentorimit.</i> <i>Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë bashkëkohore dhe me qasje interaktive, parimet dhe kërkesat e mësimdhënies inovative dhe zhvillimit të saj online, duke pasur parasysh përfshirjen aktive të pjesëmarrësve, qasjen e integruar, bashkëpunimin, iniciativën dhe rezultatet e të nxënësve me fokus kompetencat dhe rritjen e shkathësive për mësimdhënie në distancë.</i> <i>Sesionet e trajnimit janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik në kohë reale, punë në grupe, ndërveprim, demonstrim, aktivitete dhe lojëra atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete nga pjesëmarrësit e trajnimit.</i> <i>Trajnerët e programit të trajnimit: Mësimdhënia në Distancë, janë trajnuar që të përzgjedhin dhe të përdorin forma dhe metoda interaktive të punës me kolegë mësimdhënës, që nxitin maksimalisht të nxënësve aktiv të pjesëmarrësve dhe të çojnë në zhvillimin e kompetencave të tyre në këtë fushë, dhe avancimin e shkathësive të didaktikës digjitale në arritjen e rezultateve të programit të trajnimit. Elementi kryesor i metodologjisë së punës së pjesëmarrësve në këtë program të trajnimit, është qasja sa më praktike gjatë mësimdhënies në distancë. Pra, trajnerët e programit janë aftësuar që të përdorin forma dhe metoda të trajnimit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike dhe shprehjet praktike të pjesëmarrësve, por edhe qëndrimet e tyre si mësimdhënës pjesë e aktivave profesionale.</i>
Certifikimi	<i>Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet duke respektuar kriterët në vijim: Pjesëmarrja në trajnim min. 80% dhe pranimi me sukses i detyrave (portfolios) nga trajneri/ja prej pjesëmarrësve pas 2 ditëve të njëpasnjëshme trajnimi.</i>
Trajner	<i>Argjenta Plakolli</i>
Data	<i>16.11.2021</i>

Titulli i Programit	Metodologjia me nxënësin në qendër
Titulli i organizatës	<i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)</i>

Tipi i programit:	<i>Program trajnues themelor</i>
Ofertuesi i programit:	<i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)</i>
Adresa:	<i>Gazmend Zajmi Nr. 80, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës</i>
E-mail:	<i>rrezearta.zhinipotoku-behluli@giz.de</i>
Telefoni:	<i>+383 38 233 002</i>
Numrat dhe data e aprovimit:	<i>28/2021 17.03.2021</i>
Kohëzgjatja e programit (orë)	Programi i trajnimit përbëhet nga dy (2) module gjithsej, dhe secili modul përfshinë dy (2) ditë trajnim. Programi organizohet në formë të 2 moduleve 2-ditore, të cilat zhvillohen gjatë një periudhe 2 mujore. Numri i orëve të trajnimit është 30 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit klasor për klasët 1-5 si dhe mësimdhënësit e të gjitha lëndëve të shkollave fillore dhe të mesme ulta sepse program ka në fokus metodologjitë mësimore
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	<i>Një grup i pjesëmarrësve në trajnim do të këtë 22- 25 pjesëmarrës</i>
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Qëllimi i trajnimit mbi " Metodologjia me nxënësin në qendër " është që pjesëmarrësit a) të jenë të familjarizuar me konceptet e Metodologjia në qendër të nxënësit dhe b) të jenë në gjendje të sigurojnë sigurimin e cilësisë së të mësuarit dhe mësimdhënies në shkollat e tyre dhe c) në rast të trajnerëve lokalë, janë në gjendje të replikojnë përmbajtjen e trajnimeve tek personeli tjetër mësimor. Rezultatet e pritura të programit Në fund të trajnimit, pjesëmarrësit janë në gjendje të: ▪ Të njohin rëndësinë e proceseve të reflektimit për profesionalizimin e dikujt dhe shpesh të reflektojnë në praktikën e tyre mësimore. ▪ Dizajnojnë dhe zbatojnë mësim / detyra / ushtrime për nxënës me aftësi të ndryshme dhe lloje të ndryshme të nxënësve. ▪ Dizajnimi dhe implementimi i stacioneve të të mësuarit si mënyrë e mësimdhënies së diferencuar veçanërisht e përshtatshme për arsimin fillor. ▪ Vlerësojë modelet / detyrat / ushtrimet e mësimit duke përdorur një sërë kriteresh. ▪ Arsyetojë në mënyrë didaktike të gjithë hapat dhe vendimet e marra gjatë hartimit të një mësimi / detyre / ushtrimi ▪ Hartojë një orë mësimore bazuar në konceptin e të nxënës të bazuar në probleme dhe përdorni një ditar mësimi si mënyrë të vetëvlerësimit për nxënësit.

Përmbajtja:	Moduli 1: Metodat për të Mësuarit me nxënësin në qendër Metodat për të mbështetur aktivizimin e nxënësve dhe promovimin e një përshkrimi më të hollësishëm të lëndës. Inkurajimi i autonomisë së nxënësve Moduli 2: Zhvillimi i kompetencave përmes detyrave kuptimplote Mësimi i bazuar në detyra (MBD), mësimi i orientuar nga problemi, mbështetja e të mësuarit krijues, qasja spirale, marrja në konsideratë e diverzitetit, aplikimi i të mësuarit sipas niveleve (skelave). Inkurajimi i autonomisë së nxënësve (II) Për secilin modul, të gjitha aktivitetet janë të dizajnuara për të arritur qëllimin kryesor të programit të trajnimit, d.m.th.. Përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollat në Kosovë. Prandaj, lista e temave dhe nën-temave përkatësisht zgjidhen me kujdes për të përmbushur objektivin se si metodat moderne të mësimdhënies dhe të të nxënësve mund të zbatohen në klasë.
Metodat e realizimit të programit	Programi trajnues për zbatimin e Qasjes për Zhvillim të Integruar të Shkollës (QZHISH), përbëhet prej tri moduleve, për një modul janë të planifikuara 2 ditë të trajnimit të drejtpërdrejtë me vijuesit e trajnimit, përkatësisht gjashtë ditë trajnimi i gjithë programi. Për të arritur këtë, zbatohet një qasje e dyfishtë. Së pari, pjesëmarrësit marrin një prezantim teorik për sa i përket temës kryesore të secilit modul. Prezantimi jepet me anë të ligjëratave të shkurtra, PPT shoqëruese dhe materiale të tjera që janë përpiluar në doracak. Së dyti, pasi trajnimi duhet të jetë praktik dhe ndërveprues, pjesëmarrësit do të jenë të angazhuar në ushtrime individuale të reflektimit, diskutime në grupe dhe marrin pjesë në seanca të veçanta të grupeve të punës. Gjithashtu, pjesëmarrësve u kërkohet të kryejnë detyrat për seancën tjetër për të rishikuar dhe (ri) aktivizuar njohuritë e tyre të marra më parë, duke vënë në praktikë ato që kanë mësuar deri më tani, dhe të përgatiten për sesionet e ardhshme të trajnimit.
Certifikimi	<i>Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet duke respektuar kriteret e pjesëmarrjes me certifikatë për kryerje të suksesshme.</i>
Trajner	32. Martin Eckeberg 33. Eva Eckeberg 34. Lulzim Thaçi

	35. Lirije Bytyqi-Beqiri 36. Luljeta Shala 37. Shkëndia Jashari 38. Armen Mustafa 39. Shyhrete Alaj 40. Ilir Mazreku 41. Shpëtim Kastrati 42. Florije Kryeziu 43. Remzije Osmani 44. Remzije Krasniqi 45. Valentina Nimonaj-Hoti 46. Donika Koliqi
Data	16.11.2021

Titulli i Programit	<i>Qasja për Zhvillim të Integruar të Shkollës</i>
Titulli i organizatës	<i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)</i>
Tipi i programit:	<i>Program trajnues plotësues</i>

Ofertuesi i programit:	<i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)</i>
Adresa:	<i>Gazmend Zajmi Nr. 80, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës</i>
E-mail:	<i>rrezearta.zhinipotoku-behluli@giz.de</i>
Telefoni:	<i>+383 38 233 002</i>
Numrat dhe data e aprovimit:	<i>28/2021 17.03.2021</i>
Kohëzgjatja e programit (orë)	Numri i orëve të trajnimit është 48 orë , të cilat janë të organizuara përmes 36 orëve të trajnimit të drejtpërdrejtë dhe 12 orë angazhim për detyra praktike . <i>Programi i trajnimit përbëhet nga tre (3) module gjithsej, dhe secili modul përfshinë dy (2) ditë trajnim.</i>
Përfituesit:	Drejtorët e Shkollave (DSh) dhe Koordinatorët e Sigurimit të Cilësisë (KSC)
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	<i>Një grup i pjesëmarrësve në trajnim do të këtë 22- 25 pjesëmarrës</i>
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në fund të trajnimit, pjesëmarrësit janë në gjendje të: ▪ përshkruajnë konceptin për Qasjen e Zhvillimit të Integruar të Shkollës (QZHISH) dhe e ndërlidhin atë me qasjet ndaj mësimdhënies, përmirësimit e menaxhimit të shkollës dhe rritjen e mekanizmave të pjesëmarrjes në nivel shkolle; ▪ përshkruajnë detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve të shkollave dhe të koordinatorëve për sigurim të cilësisë në shkollë dhe i ndërlidhin ato me zbatimin e QZHISH; ▪ thellojnë të kuptuarit për riorganizimin e strukturave të shkollës, procesin e ndërtimit të ekipit për zhvillimin e shkollës, udhëheqjen dhe fuqizimin e tij; ▪ konkretizojnë riorganizimin e strukturave të shkollës në funksion të zbatimit të QZHISH; ▪ zhvillojnë vizionin për shkollën e tyre në përputhje me pritshmeritë e reja për shkollën dhe frymën e QZHISH; ▪ zhvillojnë dhe zbatojnë plane të veprimit për zhvillimin e shkollës sipas vizionit të shkollës së tyre, parimeve dhe kërkesave të QZHISH; ▪ demonstrojnë shkathtësi relevante për të zbatuar planet e veprimit dhe për të përmbushur rolin e tyre në zbatimin e QZHISH; ▪ shfrytëzojnë udhëzimet e programit të trajnimit për tu siguruar informata kthyesë të lidhura me shkollën në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes
Përmbajtja:	Programi i trajnimit Qasja për Zhvillim të Integruar të Shkollës, është i organizuar sipas përmbajtjes së tri moduleve të këtij programi: Moduli i parë: Qasja për Zhvillimin e Integruar të Shkollës – Rolet dhe

	përgjegjësitë e DSh dhe KSC; Moduli i dytë: Plani i veprimit për zbatimin e Qasjes për Zhvillimin e Integruar të Shkollës Moduli i tretë: Zbatimi i Qasjes për Zhvillimin e Integruar të Shkollës Moduli 1: Qasja për Zhvillimin e Integruar të Shkollës – Rolet dhe përgjegjësitë e DSh dhe KSC; 1. Të kuptuarit dhe pajtimi me QZhISH Qasja për Zhvillim të Integruar të Shkollës është një përpjekje për të bashkuar sinergjitë e brendshme të shkollës për ndryshim të menduarit dhe praktikës ndaj proceseve që zhvillohen në shkollë, me qëllim që të sigurohet një arsim cilësor për të gjithë fëmijët pa dallim, duke ofruar udhëheqje cilësore dhe gjithëpërfshirëse, qasje metodologjike të mësimdhënies së bazuar në kompetenca, mentorim të përmirësuar për mësimdhënës dhe drejtues të shkollës, pjesëmarrje aktive të mekanizmave të shkollës që i kontribuojnë zhvillimit të plotë të shkollës. 2. Rolet dhe përgjegjësitë e DSh-së dhe KSC-së Qëllimi këtu është të mendojmë për mënyra të ndryshme të përcaktimit të rolit të DSh-së dhe caktimit të përgjegjësiave ndaj KSC-ve. Që nga themelimi i pozitave të KSC, duhet ditur se ata kanë një ndikim në strukturën e shkollës dhe perceptimi i DSh dhe KSC ka të bëjë me të gjithë në shkollë. Pra, qëllimi është që të kemi role dhe fusha të përgjegjësiave të përcaktuara qartë. 3. Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të Ekipeve për Zhvillimin e Shkollës (EZSHS) EZhSh do të jetë një mekanizëm i ri në shkollë dhe kriteret e përzgjedhjes duhet të zhvillohen për të qenë në gjendje të komunikojnë në shkollë. Pra, do të flasim për faktorët domethënës përgjatë këtyre aspekteve. 4. Zhvillimi i ideve për një rrjet domethënës – në mënyrë strukturale, përmbajtjesore Në një proces ndryshimi, ndodh atëherë kur rrjetet janë thelbësore. Prandaj, trajnimi është planifikuar në atë mënyrë që DSh dhe KSC të punojnë me kolegë të ndryshëm. Do të ketë gjithashtu pak kohë gjatë modulit dhe pauzave në të cilat pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë pikëpamje, emaila dhe numra telefoni dhe forma të tjera të komunikimit dhe bashkëpunimit.
--	--

	5. Një strukturë mund të sigurohet në mënyrë të qartë, nëse pjesëmarrësit dëshirojnë të kenë një të tillë Përveç krijimit të udhëheqjes horizontale për të rritur pjesëmarrjen, fokusi do të jetë në metodat që mund të përdoren për të rritur përfshirjen e anëtarëve të stafit. Gjatë këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen me metoda komplekse që janë të zbatueshme në takimet me kolegë, stafin e shkollës, prindër, etj. 6. Njoftimi dhe reflektimi individual mbi metodat e ndryshme Metodat me nxënësin në qendër janë fokus në modulet e MNQ-së. Si shef i personelit të shkollës, ju duhet të jeni të njoftuar me konceptin që qëndron pas këtyre metodave, veçanërisht nëse vëzhgoni klasat dhe performancën e mësimdhënësve. Pra, përvoja e këtyre metodave përgatit të gjithë pjesëmarrësit në atë aspekt. Moduli 2: Plani i veprimit për zbatimin e Qasjes për Zhvillimin e Integruar të Shkollës ✓ konsolidimi i të kuptuarit të QZhISH ✓ konkretizimi i riorganizimit të brendshëm “ndryshimit të mendësisë” (organograme, detyrat e EZhSh-ve, oraret) ✓ zhvillimi i një vizioni për secilën shkollë kampione ✓ përkrahja e strukturës në nivelin e shkollës; ✓ zhvillimi i planeve të veprimit; dhe ✓ përmirësimi i komunikimit (ndërtimi i rrjeteve) Moduli 3 Plani i veprimit për zbatimin e Qasjes për Zhvillimin e Integruar të Shkollës ✓ Përshkruajnë saktësisht detyrat dhe përgjegjësitë e KSC në shkollën e tyre që janë duke u përmbushur; ✓ Thellojnë të kuptuarit e tyre për strukturat e ekipit ose përshkruajnë fazat e ndryshme në një proces të ndërtimit të ekipit dhe të kenë disa ide se si të sillen gjatë këtyre fazave si udhëheqës të ekipit; ✓ Zbatojnë kriteret bazë për monitorimin e orëve mësimore; ✓ Japin informata kthyesë të përshtatshme bazuar në kriteret transparente; ✓ Inkurajojnë profesionalisht qasjet e lidhura me shkollën në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes;
Metodat e realizimit të programit	Programi trajnues për zbatimin e Qasjes për Zhvillim të Integruar të Shkollës (QZHISH), përbëhet prej tri moduleve, për një modul janë të planifikuar 2 ditë të trajnimit të drejtpërdrejtë me vijuesit e trajnimit,

	përkatësisht gjashtë ditë trajnimi i gjithë programi. Për të arritur këtë, zbatohet një qasje e dyfishtë. Së pari, pjesëmarrësit marrin një input teorik për sa i përket temës kryesore të secilit modul. Prezantimi jepet me anë të ligjëratave të shkurtra, PPT shoqëruese dhe materiale të tjera që janë përpiluar në doracak. Së dyti, pasi trajnimi duhet të jetë praktik dhe ndërveprues, pjesëmarrësit do të jenë të angazhuar në ushtrime individuale të reflektimit, diskutime në grupe dhe marrin pjesë në seanca të veçanta të grupeve të punës. Gjithashtu, pjesëmarrësve u kërkohet të kryejnë detyrat për seancën tjetër për të rishikuar dhe (ri) aktivizuar njohuritë e tyre të marra më parë, duke vënë në praktikë ato që kanë mësuar deri më tani, dhe të përgatiten për sesionet e ardhshme të trajnimit.
Certifikimi	<i>Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet duke respektuar kriteret e pjesëmarrjes me certifikatë për kryerje të suksesshme.</i>
Trajner	47. Martin Eckeberg 48. Selim Mehmeti 49. Hajrije Devetaku Gojani 50. Haxhere Zylfiu 51. Diana Qarkaxhija 52. Zana Zeqiri 53. Ismet Potera
Data	16.11.2021

Titulli i Programit	BASHKËPUNIMI CILËSOR EDUKATOR - PRIND NË INSTITUCIONE EDUKATIVE
Titulli i organizatës	INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS - IPK
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	
Adresa:	Rr. Musine Kokollari –Dardani Prishtinë
E-mail:	mevlude.aliu@rks-gov.net & zehrie.plakolli@rks-gov.net
Telefoni:	038212626 & 044413593 038213834 & 044162429
Numrat dhe data e akreditimit:	Nr 38/2021 Riakredituar për dy vite Data: 13.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	16 orë
Përfituesit:	Edukatorët e institucioneve edukative parashkollore/parafilllore, prindërit
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	• Zhvillimi profesional i edukatoreve lidhur me bashkëpunimin dhe prindër, në institucione edukative parashkollore/ parafilllore. • Pjesëmarrja më përmbajtjesore e prindërve në institucionet parashkollore dhe në çdo aspekt të punës së edukatores dhe të institucionit • Bashkëpunim në mes edukatores dhe prindit: - në përpilimin e planeve të aktiviteteve - në realizimin e aktiviteteve të planifikuara - në realizimin e projekteve të veçanta - në komunikim dhe informim (reciprok) më të sinqertë dhe më të detajuar, rreth fëmijës dhe zhvillimit të tij të gjithanshëm. - në edukimin më cilësor dhe në zhvillimin e fëmijës sipas nevojave të tij
Përmbajtja:	Ky program trajnimi, përmban materiale, të cilat u ofrohen prindërve dhe edukatoreve dhe programi ofron këtë përmbajtje: - Qëllimi dhe rëndësia e modulit - Rezultatet e pritura - Parimet e bashkëpunimit edukator-prind - Roli i edukatores në bashkëpunim me prindin - Roli i prindit në bashkëpunim me edukatoren,

	institucionin parashkollor - Disa alternativa/strategji të bashkëpunimit - Formular për plotësim nga ana e prindërve në fillim të vitit(lidhur me të dhëna për fëmijën) - Bashkëpunimi edukatore - prind sipas kornizës ligjore dhe dokumenteve zyrtare - Mënyrat e realizimit të bashkëpunimit edukatore-prind, në institucionet edukative parashkollore/parafillore (planifikimi i punës, mbledhjet me prindër, etj) - Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e bashkëpunimit efektiv edukatore-prind - Sfidat në bashkëpunimin edukatore-prind - Bashkëpunimi mes prindërve, edukatoreve dhe shërbimit profesional - Disa këshilla që vlejné për edukatorët dhe për prindërit në raport me fëmijët dhe për të mirën e fëmijëve.
Metodat e realizimit të programit	Programi i trajnimit zgjatë dy ditë trajnim dhe me qëllim që të përcillet puna në vazhdimësi për cilësinë e realizimit sa më të mirë të bashkëpunimit edukatore- prind, është paraparë të mentorohen edukatorët e trajnuara.
Certifikimi	Po
Trajner sa trajner	2
Data e aplikimi	03.01.2021

Titulli i Programit	Metodologjitë e reja në mësimdhënie
Titulli i organizatës:	Instituti për Kërkim, Edukim dhe Zhvillim Social (IREDS)
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	IREDS
Adresa:	Rexhep Krasniqi, p.n. 10000 Prishtine
E-mail:	ireds.ks@gmail.com / www.ireds-ks.org
Telefoni:	+383 (0) 44 661 517
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 18/2021 Datat: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	80 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	— Njohja e metodave të ndryshme të arsimit dhe ato didaktike; — Përshkrimi, adaptimi dhe zbatimi i metodave si dhe kompetencat për përpunimin dhe planifikimin e premisave të mësimdhënies; — Analizimi i temave mësimore, formulimi i objektivave mësimore në raport me taksonominë dhe shumëllojshmërinë e mjeteve konkretizuese; — Njohja e metodave të ndryshme për vlerësim të performances akademike të nxënësve; — Zhvillimi i mënyrave të vlerësimit dhe ekzaminimit të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave në raport me rezultatet e të nxënit; — Njohja bazës së kurrikulit, planifikimit të kurrikulës, zhvillimi i planeve mësimore, dhe aplikimi i parimeve bazë gjatë përpilimit të kurrikulave dhe syllabuseve të programeve dhe lëndëve mësimore.
Përmbajtja:	Modulet: 1. Kurrikula bazë dhe zhvillimi i plan-programeve mësimore; 2. Metodologjitë bashkohore të mësimdhënies: Mësimdhënia e bazuar në Projekte, Mësimdhënia e bazuar në Hulumtime, dhe Mësimdhënia e bazuar në Probleme; 3. Metodat e testimit dhe vlerësimit (vlerësimi formativ dhe sumativ dhe parametrat matëse të vlerësimit);
Metodat e realizimit	— Ligjerata interaktive / të mësuar reflektiv

të programit	— Punë individuale / grupe — Prezentime — Raste studimi — Analizë sistëmore — Shembuj ilustrativ nga praktikat në shkollë — Praktikim të instrumenteve vlerësuese
Certifikimi	Certifikatë
Trajner	http://ireds-ks.org/2020/05/27/trajnim-per-mesimdhenes-metodologji-te-reja-ne-mesimdhenie-dhe-vleresim/
Data	

Titulli i Programit	
Mësimdhënia me teknologji informative	
Titulli i organizatës	Si të bëhemi i sukseshëm
Tipi i programit:	Program themelor i trajnimit
Ofertuesi i programit:	Si të bëhemi i sukseshëm
Adresa:	Brigada 123 ,Suharekë
E-mail:	gezimsopa@yahoo.com
Telefoni:	+383 49 466766
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 31/2020, dt. 03.02.2020 , 20/21,dt.17.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	80 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e të gjitha lëndëve mësimore
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	21
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	3.2 Rezultatet e programit <i>(Te listohen rezultate e pritshme të programit dhe ndërlidhja e tyre me aktivitetet e programit të trajnimit. Rezultatet e programit duhet të jenë të matshme):</i> Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra: Të njohin pjesët ,paisjet kompjuterike,të dijnë ti kyqin (psh.videoprojektorin)dhe ti përdorin. ○ Të manipulojn me File ,Follder dhe sistem operativ. ○ Të përpilojnë teste dhe detyra tjera. ○ Të ndërtojnë tabela ,grafikone etj. ○ Të pregadisnin prezantime të ndryshme me foto animacione etj. ○ Të shfletojn internetin dhe të përdorin resurset e tij si dhe te dijnë të komunikojn. ○ Predatitja e testeve dhe kuizeve online në formë të lojërave mësimore
Përmbajtja:	Moduli I - Konceptet e TI-së ,përdorimi i kompjuterit dhe menaxhimi i skedarëve 16 orë Moduli Moduli II - Microsoft Word (Përpunim i Tekstit) 16 orë Moduli III - Microsoft Excel(Puna me Tabela) 16 orë Moduli IV - Microsoft PowerPoint (Prezantimet) 16 orë Moduli V - Shfletimi në Internetit, Platformat online ,Platformat online,

Përgatitja e Testeve Online dhe kuizeve online		16 orë
Metodat e realizimit:	Komplet trajnimi do të mbahet në laborator të teknologjisë informative kryesisht edhe me punë praktike duke përdorur kompjuter, internet dhe pajisje tjera që i duhen këti trajnimi.	
Certifikimi:	Kandidatet certifikohen për 10 ditë të trajnimit (80 orë trajnimi) dhe u jepet certifikata sipas formës së bashkëngjitur në aplikacion.	
Trajner:	Gëzim Sopa Ilir Morina Meriton Kabashi Sali Bytyqi	
Data:	31 korrik 2021	

Titulli i Programit	Edukimi Inkluziv/ Gjithëpërfshirës
Titulli i organizatës:	Instituti për Kërkim, Edukim dhe Zhvillim Social (IREDS)
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	IREDS
Adresa:	Rexhep Krasniqi, p.n. 10000 Prishtine
E-mail:	ireds.ks@gmail.com / www.ireds-ks.org
Telefoni:	+383 (0) 44 661 517
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 18/2021 Datat: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	80 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	— Shpjegimi i koncepteve themelore në fushën e edukimit inkluziv; — Dallimi dhe njohja e grupeve të marginalizuara në shoqëri (kosovare) dhe qasja ndaj tyre për edukim inkluziv; — Analizimi i problemeve të kategorive të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore; — Analizimi dhe vlerësimi i shkollës dhe përshtatjes së mjedisit shkollor për edukim inkluziv; — Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm edukativ për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, dhe grupeve tjera të marginalizuara; — Njohja dhe demonstrimi i strategjive mësimore për gjithëpërfshirje të nxënësve në mësim, posaçërisht njohja me kornizën e Planit Individual të Arsimit dhe realizimi i planifikimit dhe implementimit të tij sipas vlerësimit të rasteve individuale.
Përmbajtja:	Modulet: 4. Konceptet në Edukimin Inkluziv; 5. Shkolla inkluzive / vlerësimi dhe modelimi i shkollës inkluzive; 6. Fëmijët me nevoja të veçanta, vështirësi në të nxënë dhe edukimi i tyre; 7. Zhvillimi i kurrikulave dhe didaktika në edukimin inkluziv / Plani Individual i Arsimit (PIA);
Metodat e realizimit të programit	— Ligjerata interaktive / të mësuar reflektiv — Punë individuale / grupe

	— Prezentime — Raste studimi — Analizë sistemore — Shembuj ilustrativ nga praktikat në shkolla — Praktikum të instrumenteve vlerësuese
Certifikimi	Certifikatë
Trajner	www.ireds-ks.org http://ireds-ks.org/2020/05/27/trajnim-per-mesimdhenes-edukimi-inkluziv-gjitheperfshires/
Data	

Titulli i Programit	Bashkëpunimi me prinder dhe komunitet
Titulli i organizatës	Kosovo Association for Promotion of Inclusive Education-KAPIE
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	KAPIE
Adresa:	Rruga- Bedri Berisha, Objekti D hyrja- 2/20-1 10000 Prishtinë
E-mail:	kapie.inclusion@gmail.com
Telefoni:	+3834373491
Numrat dhe data e aprovimit:	NR : 25/2121 DATE: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Trajnimi zgjatë 3 ditë dhe ka 24 orë trajnim
Përfituesit:	Mësimdhënësit e rregullt të shkollave të rregullta, mësimdhënësit e qendrave burimore, edukatorët, psikologët, mësimdhënësit mbështetës, asistentët për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Në trajnim marrin pjesë 20 -30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit në trajnim do të pajisen me njohuri të reja rreth faktorëve që ndikojnë në rritjen e përfshirjes së familjes dhe komunitetit në proceset e shkollës duke filluar nga: - Pjesëmarrësit e trajnimit diskutojnë dhe analizojnë rëndësinë e përfshirjes së familjes në dinamikën e shkollës - Përcaktojnë dhe arsyetojnë parimet e partneritetit mes shkollës dhe familjes - Analizojnë dhe përcaktojnë pengesat apo vështirësitë në raport me bashkëpunimin dhe komunikimin me familjen - Diskutojnë për përfitimet që kanë fëmijët, prindërit, mësimdhënësit nga bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin - Reflektojnë dhe përcaktojnë metodat dhe format më efektive për të arritur partneritet të mirëfilltë me prindër dhe komunitet - Shqyrtojnë profesionet, profilet dhe interesat e familjes për të përfshirë në aktivitete të shkollës Zhvillojnë plan veprimi për partneritetin mes shkollës, familjes dhe

	komunitetit
Përmbajtja:	Qëllimi i kësaj teme është që pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë e përfshirjes së familjes dhe komunitetit në aktivitetet e klasës/shkollës, njohja me format e mundshme të komunikimit dhe informimit të familjes si dhe krijimi i strategjive për bashkëpunim me familjen dhe komunitetin në mënyrë që të ngritët partneriteti mes shkollës, familjes dhe komunitetit. Në të njëjtën mënyrë është e rëndësishme që mësimmshënësist të jenë të informuar për çfarëdo rrethanash të veçanta në jetën e fëmijës si mënyra e jetesës, karakteristikat e familjes, përbërja etj. Trajnimit zhvillohet në 3 ditë trajnimit dhe është ndërlidhje në mes punës teorike dhe praktike, që realizohet përmes një metodologjie të kombinuar. Trajnimi synon të ndikoj në zhvillimin e vlerave profesionale, qëndrimeve dhe sjelljeve të tyre në raport me prindërit, anëtarët e komunitetit si dhe stafit të shkollës, të promovojnë vlera pozitive dhe të përshtojnë paragjykimet mes vete. Trajnimi synon poashtu që pjesëmarrësit të kuptojnë faktorët e që ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes dhe angazhimit aktiv të prindërve në shkollë, si dhe formave që mund të motivojnë prindërit të jenë aktiv dhe kontribues në proceset e shkollës. Po ashtu përmes trajnimit synohet që pjesëmarrësit në punën e tyre në shkollë të krijojnë klimë pozitive dhe atraktive që nxisin partneritetin me familjen dhe komunitetin duke krijuar kushte dhe mjedise të përfshirëse në klasë dhe shkollë, duke përzgjedhur strategji efektive të komunikimit dhe bashkëpunimit si dhe zbatimin efikas të tyre.
Metodat e realizimit të programit	Trajnimit zhvillohet në 3 ditë trajnimit dhe është gërshtim në mes punës teorike dhe praktike, që realizohet përmes metodave dhe formave të punës si: diskutime, bashkëbisedim, punës individuale dhe punës në grupe, raste studimore, analizë dhe shqyrtim të situates, shkëmbim njohurish dhe përvojash. Gjithashtu, ka edhe aktivitete ku kërkohet reflektim personal në lidhje me faktorët dhe punën e vet mësimmshënësist si faktor në angazhimin e prindërve dhe komunitetit në dinamikën e shkollës. Pjesëmarrësit e trajnimit gjithashtu duhet të përgatisin prezantime në flipchart në punën grupore dhe të prezantojnë ato për tema të ndryshme. Fillimisht pjesëmarrësit listojnë disa nga faktorët që ndikojnë në mungesën e pjesëmarrjes së prindërve në aktivitete të shkollës, analizojnë situatat që mund të sjellin tek një mungesë e bashkëpunimit, reflektojnë për praktikatat e suksesshme që kanë pasur ndër vite dhe se si kanë ndikuar ato

	bashkëpunime në rezultate të nxënësve dhe shkollës. Pastaj përmes luajtjes së roleve, do të shfaqin edhe qëndrimet e mësimdhënësve karshi prindërve dhe nxënësve, qasja dhe komunikimi që përdoret gjatë bashkëveprimit me prindër dhe komunitet. Seancat e trajnimit vazhdojnë me shqyrtimin e interesave të prindërve dhe anëtarëve të komunitetit si mundësi që angazhimi i tyre të jetë kundrejt profileve, profesionave të tyre. Më tutje përmes punës së përbashkët në grupe hartojnë planin e veprimit për partneritet me familjen dhe komunitetin, i cili plan përmbanë aktivitete konkrete dhe specifike që do të ndërmerren përgjatë një viti në shkollë. Plani përcakton përgjegjësit, afatet kohore si dhe format se si do të angazhohen prindërit dhe komuniteti në proceset e shkollës në dimensione të ndryshme.
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të çertifikohen me çertifikatë sipas vijueshmërisë së tyre
Trajner	Armen Mustafa PhD Remzije Krasniqi Ms.Ed Lirije Bytyqy Ms.Ed Hatixhe Zogaj Ms.Ed
Data	24.09.2021

Titulli i Programit	Hartimi i Planit Individual te Arsimit -PIA
Titulli i organizatës	Kosovo Association for Promotion of Inclusive Education-KAPIE
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	KAPIE
Adresa:	Rruga- Bedri Berisha, Objekti D hyrja- 2/20-1 10000 Prishtinë
E-mail:	kapie.inclusion@gmail.com
Telefoni:	+3834373491
Numrat dhe data e aprovimit:	NR : 25/2121 DATE: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Trajnimi zgjatë 3 ditë dhe ka 24 orë trajnim
Përfituesit:	Mësimdhënësit e rregullt të shkollave të rregullta, mësimdhënësit e qendrave burimore, edukatorët, psikologët, mësimdhënësit mbështetës, asistentët për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Në trajnim marrin pjesë 20 -30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit në trajnim do të pajisen me njohuri të reja rreth përdorimit të PIA-së në procesin e rregulltë mësimor si dhe mënyrën e aplikimit të tij si mbështetje e domosdoshme për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore: Pjesëmarrësit përmes trajnimit kanë mundësi të marrin informata tbazë rreth tërë procesit të hartimit të PIA-së duke filluar nga rëndësia e përdorimit të PIA-së, ndërlidhjen e PIA-së me kurrikulën, kush e bënë vlerësimin dhe merr vendimin për përdorim të PIA-së, kush duhet të ketë një PIA, kush janë përgjegjësit për inicimin e hartimit të PIA-së, kush organizon takimet, kush merr pjesë në takime, sa shpesh duhet rishikuar PIA-në, etj. Po ashtu gjatë sesioneve të trajnimit shpjegohet çdo pjesë e kornizës së PIA-së se si plotësohet, si përcaktohen qëllimet vjetore, rezultatet e pritura, metodat dhe format e punës, format e vlerësimit, mbështetjet që duhet përcaktuar për fëmijën, personat që do të mbështesin fëmijën për të arritur performancë të mirë, etj. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit arrijnë të përdorin një shtojcë të vlerësimit pedagogjik të fëmijës e cila jep një pasqyrë të përgjithshme të funksionimit të fëmijës që shërben tutje në përcaktimin e qëllimit dhe rezultateve

	mësimore. Në fund të trajnimit secili mësimdhënës harton një PIA për një nxënës duke pasur rast të planifikojnë në ekip dhe me pjesëmarrje të prindërve.
Përmbajtja:	Moduli i trajnimit për hartimin e Planit individual të arsimit ka për qëllim t'ju jap informata dhe njohuri mësimdhënësve në shkolla të rregullta se si të hartojnë/ plotësojnë dhe zbatojnë një PIA për fëmijët që kanë vështirësi në të nxënë apo që nuk arrijnë mjaftueshëm të përfitojnë nga kurrikuli i përgjithshëm i klasës. Përmbajtja e këtij trajnimi ofron mundësi të veçantë për arsye se përveç që pjesëmarrësit kanë rastin të shkëmbejnë njohuri të ndryshme mes njëri-tjetrit, të reflektojnë për punën e tyre, të japin ide, mendime, këshilla në raport me të tjerët, ju krijohet një mundësi që për pak ditë ata mund të bëjnë ndryshime në punën e tyre, dhe përfitojnë njohuri për planifikimin e punës edukative duke ju përshtatur nevojave dhe kërkesave të nxënësve. Trajnimi për hartimin e PIA-së do të ju lehtësojë shumë punën e mësimdhënësve duke pasur parasysh se kanë nevojë shumë të madhe për të marr njohuri rreth përdorimit të PIA-së si një dokument përveç obligativ dhe i domosdoshëm në shkolla por edhe vë në pah përparimin e fëmijëve dhe punën edukative të mësimdhënësve, po ashtu përdorimi i PIA-së do të rrisë bashkëpunimin mes prindërve dhe institucioneve shkollore apo kopshteve dhe do të identifikon shumë burime që do të jenë përfituese për fëmijët dhe mësimdhënësit. Po ashtu zhvillimi i disa aktiviteteve kreative praktike me pjesëmarrës është shumë i nevojshëm për punën e tyre, pasi që i nxit që këto aktivitete dhe metoda praktike ti praktikojnë direkt gjatë punës me fëmijë me nevoja të veçanta.
Metodat e realizimit të programit	Trajnimi zhvillohet në 3 ditë trajnimi dhe metodologjia e trajnimit është teorike dhe praktike, pjesa e parë e trajnimit është teorike në mënyrë që të jepen informatat paraprake për temën e trajtuar më pastaj puna vazhdon me punë praktikë në grup pjesëmarrësit analizojnë dhe reflektojnë rreth formës së PIA-së dhe udhëzuesit për përdorim të PIA-së. Gjatë trajnimit janë përdorur teknikat e punës, si: analizë e rasteve studimore, vlerësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore si dhe shkëmbim përvojash. Pjesa kryesore e këtij moduli të trajnimit është e bazuar në punë praktike do të thotë punë direkte në dokumentin përkatësish formën e PIA-së ku plotësohet me të dhëna dhe gjendje momentale të fëmijës. Metodat dhe teknikat e punës që u përdoren në trajnim ishin: Prezantim-tyerje e akullit, stuhi mendimesh, prezentim teorik, punë në grupe, prezantime të detyrave, diskutim në grup, reflektim Gjithashtu, ka edhe aktivitete ku kërkohet reflektim personal në lidhje me vështirësitë që kanë fëmijët në të nxënë si dhe sfidat që kanë mësimdhënësit në mbështetjen arsimore të fëmijëve që kanë nevoja të

	veçanta arsimore. Pjesëmarrësit e trajnimit gjithashtu bëjnë vlerësimin e fëmijëve përmes shtojcës për vlerësim pedagogjik që merr secili pjesëmarrës dhe përmes saj mund të sjellin një pasqyrë të gjendjes aktuale të fëmijës. Vlen të theksohet se kjo formë e vlerësimit bëhet nga disa pjesëmarrës që mund të njohin fëmijën në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më objektiv. Fillimisht pjesëmarrësit zhvillojnë aktivitete që ju mundësojnë të njohin dhe shprehin qëndrimet e mësimdhënësve për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, cilat qasje dhe metoda përdorin gjatë punës pedagogjike me fëmijë, sa janë efektive, sa i njohin stilet e të nxënit të fëmijëve, sa arrijnë të përshtatsin përmbajtjet mësimore për secilin fëmijë. Këto aktivitete arrijnë t'i vetëdijësojnë por edhe mundësojnë mësimdhënësve që të fokusohen në anënt pozitive dhe funksionale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore si dhe të përcaktojnë objektiva mësimore që do të mund të nxisin dhe stimulojnë fëmijët për të rriur shkathtësi dhe aftësi për mësim. Më tutje përmes punës së përbashkët në grupe hartojnë planin individual të cilin mund të fillojnë ta përdorin menjëherë pas trajnimit. Vlerë e veçantë e këtioj trajnimi është që mësimdhënësit arrijnë të pajisen me njohuri dhe shkathtësi të shpejta që përmes 3 ditëve të hartojnë dhe të fillojnë të përdorin PIA-në për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të çertifikohen me çertifikatë sipas vijueshmërisë së tyre
Trajner	Armen Mustafa PhD Remzije Krasniqi Ms.Ed Lirije Bytyqy Ms.Ed Hatixhe Zogaj Ms.Ed Remzije Osmani Ms.Ed
Data	24.09.2021

Titulli i Programit	Parandalimi i dhunës ne shkollë
Titulli i organizatës	Kosovo Association for Promotion of Inclusive Education-KAPIE
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	KAPIE
Adresa:	Rruga- Bedri Berisha, Objekti D hyrja- 2/20-1 10000 Prishtinë
E-mail:	kapie.inclusion@gmail.com
Telefoni:	+3834373491
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr: 24/2021 DATE: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Trajnimi zgjatë 4 ditë dhe ka 32 orë trajnimi
Përfituesit:	Mësimdhënësit e rregullt të shkollave të rregullta, edukatorët, psikologët dhe stafi tjetër i shkollës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Në trajnim marrin pjesë 20-30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Pjesëmarrësit në trajnim do të pajisen me njohuri të reja rreth faktorëve që ndikojnë në shfaqjen e dhunës në shkollë, - Identifikimin e sjelljeve që çojnë në dhunë në shkollë; - Të zbatojnë disiplinën pozitive në shkollë dhe klasë; - Si menaxhohet klasa me qëllim të parandalimit të dhunës në klasë dhe shkollë - Njohja me konceptin e bullizmit, llojeve dhe pasojave të tij; - Njohja dhe përdorimi i masave për parandalimin e bullizmit në nivel klase dhe shkolle - Bashkëpunimi dhe mënyrat e pjesëmarrjes së prindërve e komunitetit të shkollës në parandalimin e dhunës - Mënyrat e vlerësimit të aktiviteteve për parandalimin e dhunës në shkollë
Përmbajtja:	Trajnimi zhvillohet në 4 ditë trajnimi dhe është gërshtetim në mes punës teorike dhe praktike, që realizohet përmes një metodologjie të kombinuar. Trajnimi synon të ndikoj në zhvillimin e vlerave profesionale, qëndrimeve dhe sjelljeve të tyre në raport me dhunën në shkollë, ashtu që mësimdhënësit të promovojnë vlera pozitive dhe të përshtojnë paragjykimet në raport me nxënësit. Trajnimi synon poashtu që pjesëmarrësit të kuptojnë faktorët e dhunës, të identifikojnë sjelljet që çojnë

	në dhunë dhe të struktojnë mësimdhënien e tyre, për të përmbushur zhvillimin fizik, social dhe intelektual të nxënësve të tyre. Trajnimi më tutje synon të ndikoj në atë që pjesëmarrësit në punën e tyre në shkollë të krijojnë mjedise të sigurta, përfshirëse dhe në klasë dhe shkollë, duke përzgjedhur strategji efektive të mësimdhënies dhe zbatimin efikas të tyre, me qëllim të parandalimit të dhunës në shkollë. Gjithashtu, trajnim synon që pjesëmarrësit jenë në gjendje të reflektojnë mbi punë e tyre profesionale, qasjen dhe rolin e tyre që kanë në drejtim të parandalimit të dhunës. Kjo nënkupton edhe respektin dhe ndërveprimin e tyre me nxënës, kolegë, profesionistë tjerë dhe komunitetin e prindërve, në mënyrë që bashkërisht, në bazë të rilit që kanë, të kontribuojnë në parandalimin e dhunës në shkollë.
Metodat e realizimit të programit	Trajnimi zhvillohet në 4 ditë trajnimi dhe është gërshetim në mes punës teorike dhe praktike, që realizohet përmes luajtjes së roleve, diskutime, punës individuale dhe punës në grupe. Gjithashtu, ka edhe aktivitete ku kërkohet reflektim personal në lidhje me faktorët dhe punën e vet mësimdhënësit si faktor në parandalimin e dhunës në shkollë. Pjesëmarrësit e trajnimit gjithashtu duhet të përgatisin prezantime në flipch chart në punën grupore dhe të prezantojnë ato për tema të ndryshme. Psh. fillimisht trajnimi merret me identifikimin e faktorëve të dhunës, ku pjesëmarrësit fillimisht listojnë disa nga faktorët e dhunës në shkollë në flipchart. Pastaj ata përmes luajtjes së roleve, do të shfaqin edhe qëndrimet e tyre në mësimdhënie karshi dhunës. Kjo vazhdon me menaxhimin e klasës dhe disiplinën pozitive, ku mësimdhënësit tregojnë se janë model i mirë i sjelljes për nxënës. Më tutje përmes punës së përbashkët në grupe hartojnë rregulla në klasë, e pastaj edhe hartimin e një plani për parandalim e dhunës në nivel shkolle, në bashkëpunim edhe me prindër dhe komunitetin. Kjo është tepër me rëndësi sepse pjesëmarrësit kuptojnë se në parandalimin e dhunës secili, pa marrë parasysh rolin që ka në shkollë, ka një rol aktiv dhe kontriboun në parandalimin e dhunës.
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të çertifikohen me çertifikatë sipas vijueshmërisë së tyre
Trajner	Armen Mustafa PhD Remzije Krasniqi Ms.Ed Lirije Bytyqy Ms.Ed Hatixhe Zogaj Ms.Ed
Data	24.09.2021

Titulli i Programit	Vizioni dhe konceptet e arsimit gjithëpërfshirës, puna e përbashkët dhe mjediset e ndihmojnë të nxënëit e individualiuar
Titulli i organizatës	Kosovo Association for Promotion of Inclusive Education-KAPIE
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	KAPIE
Adresa:	Rruga- Bedri Berisha, Objekti D hyrja- 2/20-1 10000 Prishtinë
E-mail:	kapie.inclusion@gmail.com
Telefoni:	+3834373491
Numrat dhe data e aprovimit:	NR : 24/2021 DATE: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	Trajnimi zgjatë 9 ditë Janë gjithsejtë tri (3) module të cilat zgjasin secili nga tri (3) ditë.
Përfituesit:	Drejtorët, mësimdhënësit e rregullt të shkollave të rregullta, edukatorët, psikologët dhe stafi tjetër i shkollës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Në trajnim marrin pjesë 25-30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Arsimtarët dhe edukatorët pas trajnimit marrin njohuritë themelore për konceptet bazë të arsimit gjithëpërfshirës, për rëndësinë që ka zhvillimi profesional në arsimin gjithëpërfshirës, me përcaktimin e kompetencave për mësimdhënësin gjithëpërfshirës, njohja me paragjykimet që ndikojnë në veprimet e tyre dhe pjesëmarrësit zhvillojnë vizionin për mësimdhënësin gjithëpërfshirës. Pjesëmarrësit poashtu marrin njohuri për rëndësinë e komunikimit në marrëdhënie midis njerëzve, marrëdhëniet profesionale, fokusimin në bashkëpunim, kufizimet në pjesëmarrje dhe strategjitë për identifikimin e kufizimeve të pjesëmarrjes. Pjesëmarrësi njihen edhe me KNF-në (Klasifikimi ndërkombëtar i funksionimit) dhe strategjive të ndryshme për zgjidhjen e problemeve duke vendosur pjesëmarrjen e individit në qendër dhe duke e analizuar atë sipas perspektivës zhvillimore, të shëndetit, të marrëdhënieve dhe të kurrikulit. KNF në këtë trajnim ofrohet në aspektin pedagogjik dhe nuk ka për qëllim të fokusohet në aspektin

	mjekësor të aftësisë së kufizuar të individit. Pjesëmarrësit do të njihen edhe me mjediset që ndihmojnë të nxënit e individualizuar, me mënyrat e hartimit të objektivave afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata, si të ndërthuren objektivat me situatat e të nxënit, mënyrat si të përmirësohet pjesëmarrja në klasë dhe si të hartohen plane individuale në të nxënë. Gjatë trajnimit i cili është mjaft ndërveprues jepen edhe instrumente të cilat më pas pjesëmarrësit e trajnimit mund t'i shfrytëzojnë në punën e tyre për ta bërë mësimdhënien e tyre më ndërveprues dhe më të individualizuar për të plotësuar nevojat individuale të ndryshme të nxënësve.
Përmbajtja:	Janë gjithsejtë tri module të trajnimit të cilat organizohen në një periudhë me pauzë në mes midis moduleve. pas secilit modul jepet nga një detyrë për pjesëmarrësit e trajnimit për të zgjedhur elemente të trajnimit të cilat pjesëmarrësit e trajnimit mund t'i zbatojnë në punën e tyre. Secili modul i ka pjesën teorike të gërshetuar me punën në grupe. Ka mjaft sesione reflektimi ku pjesëmarrësit e trajnimit vihen në pozita të reflektimit për tema të caktuara që kanë të bëjnë me punën e tyre dhe teoritë e reja që propozohen në trajnim. Pjesëmarrësit vihen në situatat të diskutimit me koleget e tyre dhe me trajnerin për tema të ndryshme. Pjesëmarrësit e trajnimit gjithashtu duhet të përgatisin prezantime në flipchart në punën grupore dhe të prezantojnë në grupe për tema të ndryshme. psh. Një nga temat në modulin e dytë mjaft me rëndësi është Kufizimi i pjesëmarrjes në të nxënë për nxënës që kanë vështirësi të marrin pjesë në aktivitetet të nxënit që zhvillohen në klasë. Aty jepet mundësie dhe ofrohen instrumente për të vlerësuar perspektivat e kufizimeve të pjesëmarrjes në të nxënë. Ajo shëndetësore, e marrëdhënies, e kurrikulit dhe ajo zhvillimore. Kjo është mjaft me rëndësi, pasi që shpesh mësimdhënësit dhe stafi tjetër arsimor e vlerësojnë nxënësin nga perspektiva shëndetësore dhe arrijnë në vendime të gabuara duke menduar se është aftësia e kufizuar ajo që i kufizon nxënësit në pjesëmarrje në mësim, e në fakt shpesh ndodhë që perspektiva e kurrikulit dhe ajo e marrëdhënies të jenë pengesa. Kjo, ju hap pjesëmarrësve horizonte tjera të menduarit për të analizuar në hollësi përparësitë dhe vështirësitë e nxënësit/fëmijës dhe në këtë mënyrë të mendoj për në alternative ndryshe të mësimdhënies nga e cila do të përfitojnë të gjithë mësimdhënësit, me theks të veçantë ata që kanë vështirësi.
Metodat e realizimit të programit	Janë gjithsejtë tri module të trajnimit të cilat organizohen në një periudhë me pauzë në mes midis moduleve. pas secilit modul jepet nga një detyrë për pjesëmarrësit e trajnimit për të zgjedhur elemente të trajnimit të cilat pjesëmarrësit e trajnimit mund t'i zbatojnë në punën e tyre. Secili modul i ka pjesën teorike të gërshetuar me punën në grupe. Ka mjaft

	sesione reflektimi ku pjesëmarrësit e trajnimit vihen në pozita të reflektimit për tema të caktuara që kanë të bëjnë me punën e tyre dhe teoritë e reja që propozohen në trajnim. Pjesëmarrësit vihen në situatat të diskutimit me koleget e tyre dhe me trajnerin për tema të ndryshme. Pjesëmarrësit e trajnimit gjithashtu duhet të përgatisin prezantime në flipchart në punën grupore dhe të prezantojnë në grupe për tema të ndryshme. psh. Një nga temat në modulën e dytë mjaft me rendësi është Kufizimi i pjesëmarrjes në të nxënë për nxënës që kanë vështirësi të marrin pjesë në aktivitetet e nxënës që zhvillohen në klasë. Aty jepet mundësi dhe ofrohen instrumente për të vlerësuar perspektivat e kufizimeve të pjesëmarrjes në të nxënë. Ajo shëndetësore, e marrëdhënies, e kurrikulit dhe ajo zhvillimore. Shpesh mësimdhënësit i analizojnë kufizimet e nxënësve në të nxënë nga perspektiva shëndetësore dhe harrojnë perspektivën e marrëdhënies dhe atë kurrikulare. Kjo qon në analizë të gabueshme dhe veprime të gabueshme nga ana e mësimdhënësit që nuk qon në rritjen e pjesëmarrjes në të nxënë. Ideja me këtë është që mësimdhënësit t'iu hapet mendja dhe të kenë idenë se ka edhe perspektiva të tjera nga të cilat mund të analizohen kufizimet e pjesëmarrjes në të nxënë, jo vetëm të nxënësve me aftësi të kufizuara, po të gjithë nxënësve që kanë vështirësi të marrin pjesë në aktivitetet e të nxënës.
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të çertifikohen me çertifikatë sipas vijueshmërisë së tyre
Trajner	Armen Mustafa PhD Remzije Krasniqi Ms.Ed Lirije Bytyqi Ms.Ed Hatixhe Zogaj Ms.Ed Remzije Osmani Ms. Ed
Data	24.09.2021

Titulli i Programit	Identifikimi i nxënësve me vështirësi në shkrim e lexim dhe ofrimi i mbështetjes për tejkalimin e vështirësive
Titulli i organizatës	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Adresa:	Rr. Musine Kokollari, Ulpianë, Prishtinë
E-mail:	nezir.c@gmail.com ; Nezir.Cocaj@rks-gov.net ;
Telefoni:	+383 38 213 830
Numrat dhe data e aprovimit:	22/2021 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	60 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Identifikon vështirësitë e nxënësve në shkrim dhe lexim; - Përdor instrumentet e vlerësimit individual dhe grupor të shkathtësive të leximit dhe shkrimit; - Analizon dhe interpreton rezultatet e dala nga instrumentet e vlerësimit; - Përdor metoda alternative të mësimdhënies për punë me nxënësit që kanë vështirësi në lexim dhe shkrim; - Krijon materiale alternative të nxënësve për të mbështetur nxënësit që kanë vështirësi në shkrim dhe lexim; - Harton dhe zbaton plane individuale për nxënësit me vështirësi në shkrim dhe lexim; - Ofron mbështetje për nxënësit me vështirësi në shkrim dhe lexim; - Udhëzon drejtë mësimdhënësit tjerë si tu ofrohet mbështetja nxënësve me vështirësi në shkrim dhe lexim.
Përmbajtja:	❖ <u>Vështirësitë në shkrim dhe lexim;</u> Në kuadër të kësaj teme do të shqyrtohen: - Aspektet konceptuale lidhur me vështirësitë në shkrim dhe lexim; - Dallimet mes nxënësve me vështirësi dhe nxënësve me nevojë të veçanta; - Llojet e vështirësive në shkrim dhe lexim; - Karakteristikat e nxënësve me vështirësi në shkrim dhe lexim. ❖ <u>Identifikimi i nxënësve me vështirësi në shkrim dhe lexim;</u>

	Mësimdhënësit do të informohen dhe përgatiten për: - Identifikimin e vështirësive në shkrim dhe lexim - Përdorimin e instrumenteve të vlerësimit individual dhe vlerësimit grupor të shkathtësive të leximit dhe shkrimit - Interpretimi i rezultateve të testimit ❖ <u>Planifikimi individual</u> Mësimdhënëset do të ofrohen informacione të nevojshme dhe do të aftësohen për: - Hartimin e planit individual për nxënësit me vështirësi në shkrim dhe lexim; - Zbatimin e planit individual ❖ <u>Organizimi i punës për nxënësit me vështirësi në shkrim dhe lexim;</u> Do të ofrohen informacione për organizimin e punës me nxënësit me vështirësi në lexim dhe shkrim: - Krijimi i grupeve të leximit dhe shkrimit; - Puna me grupet e leximit dhe shkrimit. ❖ <u>Materialet didaktike që ndihmojnë në tejkalimin e vështirësive në shkrim dhe lexim;</u> Fokusi është në: - Hartimin e materialeve didaktike - Përdorimi i materialeve didaktike
Metodat e realizimit të programit	Ligjërata, individuale, punë në grupe, punë praktike me nxënës
Certifikimi	Certifikatë
Trajner	Lirije Bytyqi Beqiri, Sahare Reçica Havolli
Data	03.08.2021

Titulli i Programit	“Mbrotjtja e shëndetit mendor të fëmijëve përmes programeve psiko-pedagogjike në vendet e prekura nga varfëria”
Titulli i organizatës	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU)
Tipi i programit:	Program trajnues themelore dhe program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU)
Adresa:	Rr. Janina 252, Veternik Prishtinë
E-mail:	fidan_hetemi@hotmail.com
Telefoni:	+383 (0) 44 984 207
Numrat dhe data e aprovimit:	Është paraparë të fillohet në Qershor 2020, për shkak të pandemisë është shtyhet në Tetor të vitit 2020. Pjesa tjetër e programit vazhdon në shtator 2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	Trajnimi i një grupi prej 8 profesionistëve – trajnerë pedagogëve special, psikologëve, profesionistëve nga lëmia e shëndetit mental, të cilët do të punojnë me mësuesit në trajnimin e tyre. Gjithsej 8 orë pune trajnuese Organizohet trajnimit i 40 mësuesve nga 10 shkolla. Trajnimi do të zgjatë tri ditë me nga 6 orë në ditë me gjithsej 18 orë pune.
Përfituesit:	Këshilltarët në shkolla (psikologët, pedagogët social, punëtorët social, mësuesit mbështetës) Përfituesit tjerë: • Nxënësit që marrin pjesë në aktivitetet psiko-pedagogjike • Nxënësit që përfshihen në aktivitete vullnetare • Nxënësit që ndihmohen nëpërmjet këshillimit të moshatarëve • Prindërit dhe komuniteti i shkollës
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	• 8 profesionistë që do të zhvillohen dhe marrin përvoja nga model i ri punës • 40 mësime dhënë nga 10 shkolla të përfshira dhe këshilltarët në shkolla (psikologët, pedagogët social, punëtorët social, mësuesit mbështetës nga këto dhe shkolla tjera) • 800 nxënës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	• Programi do të zvogëlojë ndikimin e varfërisë tek fëmijët nëpërmjet ndihmës nga shkolla dhe bashkëmoshatarët. • Mobilizimi i burimeve njerëzore në shkolla që mund të aktivizohen për këtë qëllim dhe janë burim i rëndësishëm i mbështetjes së fëmijëve • Ndikimi i zhvillimit të programeve me tema psikosociale • Zhvillimi i bashkëpunimit mes shkollës dhe prindërve dhe rritja e pjesëmarrjes së prindërve në aktivitetet psiko-pedagogjike që zhvillohen në shkolla. • Zhvillimi i këshillimit moshatar si një metodë e re e ndihmës për fëmijët me vështirësi. Nxënësit e interesuar nga klasat e larta do të trajnohen për t'i ndihmuar nxënësit më të vegjël. • Puna vullnetare me bazë në shkollë.
Përmbajtja:	1. Vizitat përgatitore nga koordinatori i projektit IPEDU përfshinin shkolla në rajonin e Kaçanikut, Hanit të Elezit, Shtërpçës dhe autoriteteve rajonale 2. Një trajnim njëditor për 8 trajnerët profesionalë nën mbikëqyrjen e një trajneri internacional.

	3. Një trajnim tre-ditor i një grupi multidisiplinar prej 40 palësh të interesuara (autoritetet lokale të shkollës, drejtorët e shkollave, koordinatorët e shkollave, psikologët dhe mësuesit e shkollës). Do të përgatitet dhe drejtohet në bashkëpunim me ekspertin ndërkombëtar nga Sllovenia. 4. Një takim vlerësimi do të organizohet me ekspertë, koordinatorë të shkollës, autoritete shkollorë dhe përfaqësues të shërbimeve rajonale shëndetësore. 5. Pjesë e aktiviteteve do të jenë edhe trajnimi i fëmijëve për këshillim të moshatarëve dhe zbatimi i metodave të tilla në disa shkolla, puna e mësimdhënësve dhe punëtorëve tjerë shkollor që do të përmbajnë punëtori për fëmijë, prindër dhe puna vullnetare. 6. Shpërndarja e ndihmës financiare për fëmijët nga familjet e varfëra që janë të interesuar për riedukim profesional ose për fillimin e disa aktiviteteve prodhuese. Do të aranzhojë mundësi të arsimit falas dhe pjesërisht të mbështesë kostot e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të dhe të kontribuojë në shpenzimet për sigurimin e mjeteve të nevojshme për aktivitetet e drejtimit në shtëpi.
Metodat e realizimit të programit	Fillimisht është bërë një trajnim me trajnerët që do të mbikëqyret nga një trajnues ndërkombëtar. Seminare me mësimdhënës do të organizohet përmes ligjëratave interactive. Do të ketë punë në grupe, diskutime dhe debat lidhur me temat që do të zhvillohen. Do të ekspozohen nga mësimdhënësit dhe profesionalistët disa nga praktikat e mira që zhvillohen në shkolla dhe do të debatohen ato.
Certifikimi	Në fund të çdo trajnimi do të certifikohen trajnerët dhe mësimdhënësit
Trajner	Trajnerët e trajnimit të këshilltarëve shkollorë dhe mësimdhënësve janë ekspertë ndërkombëtar dhe vendorë të profilit profesional psikosocial dhe pedagogjik.
Data	06.08.2021

Titulli i Programit	
“Ndihmë fëmijëve me vështirësi specifike në mësim dhe fëmijëve me nevoja të veçanta”	
Titulli i organizatës	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU)
Tipi i programit:	Program trajnues themelore dhe program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU)
Adresa:	Rr. Janina 252, Veternik Prishtinë

E-mail:	fidan hetemi@hotmail.com
Telefoni:	+383 (0) 44 984 207
Numrat dhe data e aprovimit:	Është paraparë të mbahet në Prill 2020, për shkak të pandemisë shtyhet në Tetor të vitit 2021.
Kohëzgjatja e programit(orë)	18 orë Trajnimi i profesionistëve - trajnerëve + 24 orë (3 grupe mësimdhënës x 8 orë)
Përfituesit:	Këshilltarët në shkolla (psikologët, pedagogët social, punëtorët social, mësuesit mbështetës) Pedagogët special, mësuesit asistentë, fëmijët me nevoja të veçanta (me aftësi të kufizuara) si dhe fëmijët me vështirësi në mësim. Mësuesit të cilët punojnë me fëmijë me vështirësi në mësim dhe fëmijë me nevoja të veçanta.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 trajnerë profesionist të programit me pedagogët special, mësuesit asistentë dhe me psikologë. 100 mësues, të cilët punojnë me fëmijë me vështirësi në mësim dhe fëmijë me nevoja të veçanta
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	• Ndhimë fëmijëve me nevoja të veçanta (10% - 15% e të gjithë fëmijëve të shkollave fillore) në shkollimin fillor. • Janë aftësuar përmes trajnimit një grup prej 20 ekspertësh (pedagogë specialë, psikologë, mësimdhënës asistentë dhe këshilltarë shkollore) • Mësuesit e trajnuar janë aftësuar për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta brenda sistemit shkollos dhe për të përhapur njohuritë themelore për fëmijët me nevoja të veçanta në mesin. • Zbatimi i njohurive të fituara në ndihmën e specialistëve me fëmijë me nevoja të veçanta dhe në edukimin e mësuesve të shkollave fillore për nevojat dhe qasjet e fëmijëve me nevoja të veçanta. • Monitorimi i punës së mësuesve në shkolla për punën me fëmijët me nevoja të veçanta. • Është bërë edhe vlerësimi i efekteve të projektit.
Përmbajtja:	Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në mësim janë një nga grupet më të marginalizuara në shoqërinë kosovare. Një nga pengesat kryesore për adresimin e nevojave të tyre është mungesa e njohurive se sa fëmijë me nevoja të veçanta janë në Kosovë, ku ata jetojnë dhe cilat janë nevojat e tyre. Në fakt, nuk ka ndonjë përcaktim zyrtar të aftësisë së kufizuar që mund të përdoret për të llogaritur këtë numër. Aktivitetet kryesore të projektit janë: • Trajnimi i ekspertëve lokalë (edukatorëve dhe psikologëve) për edukimin e mësimdhënësve • Trajnimi i mësimdhënësve që punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe fëmijët me vështirësi në mësim në klasat e tyre • Zbatimi i shkathtësive të fituara në shkolla

	• Përgatitje e manualeve dhe materialeve të tjera në fushën e vështirësive specifike në mësim Komponentët substanciale të projektit janë: identifikimi i fëmijëve më vështirësi specifike në mësim, mbështetja psikosociale, motivimi i fëmijëve dhe përmirësimi i vetëbesimit të tyre, dhe puna me prindërit (informimi, këshillimi). Prandaj është vendosur që ky program të ketë qasje informimi të mësuesve për problemet me këta fëmijë dhe si duhet të punohet me këta fëmijë. Natyrisht më e rëndësishmja është që mësuesit do të marrin njohuri dhe përvoja të mira nga vendet tjera e sidomos nga Sllovenia.
Metodat e realizimit të programit	Programi zhvillohet me metodën e ligjërimit në formë të ndërveprimit, përcillet me komente dhe këmbim të përvojave të mira të mësuesve. Punohet në grupe të mësuesve me metodën e rasteve të fëmijëve të tillë dhe si janë ndihmuar. Debatohet për rastet specifike me fëmijët e tillë në seanca plenare ku edhe tregohen përvoja të mira për zgjidhjen se si duhet ndihmuar këta fëmijë.
Certifikimi	Në fund të çdo trajnimit do të certifikohen trajnerët dhe mësime dhënësit.
Trajner	Trajnerët e trajnimit të këshilltarëve shkollorë dhe mësime dhënësit janë ekspertë ndërkombëtar dhe vendorë të profilit profesional të profilit psikosocial dhe pedagogjik.
Data	06.08.2021

Titulli i Programit	
Edukimi për të drejtat e fëmijëve “Të drejtat tona”	
Titulli i organizatës	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU)
Tipi i programit:	Program trajnues themelor dhe program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Instituti për Promovimin e Edukimit
Adresa:	Rr. Janina 252, Veternik Prishtinë
E-mail:	fidan_hetemi@hotmail.com
Telefoni:	+383 (0) 44 984 207
Numrat dhe data e aprovimit:	Mars, 2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	Trajnimi i trajnerëve është dy ditor me 18 orë, të cilët do t'i trajnojnë mësuesit. Në Trajnimin e trajnerëve duhet të jetë së paku një ekspert internacional. Trajnimi i mësimeve është dy ditor me 12 orë punë efektive trajnuese. Monitorimi bëhet përmes kontakteve me mësuesit dhe në orë mësimore. Për një mësues nga 1 - 2 orë mësimore.
Përfituesit:	Këshilltarët shkollorë (pedagogë, psikologë dhe drejtorë) Mësimeve Nxënës
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	• 20 trajnerë që do t'i trajnojnë mësuesit (tri vjet kohëzgjatje e trajnimit) • 90 mësues që do të marrin pjesë në trajnime për të drejtat e fëmijëve • 8000 fëmijë që do të përfitojnë nga zbatimi i projektit dhe materialet e shpërndara
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Njohja e mësimeve për të drejtat universale të njeriut dhe të drejtat e fëmijëve dhe informimi i nxënësve në shkollë. - Njohja me konventat e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës - Të mësuarit për të drejtat e njeriut si një qasje në përgatitjen e të rinjve për t'u bërë qytetarë të informuar, aktivë dhe përgjegjës. - Edukimin e të rinjve për qytetari aktive dhe pjesëmarrje aktive në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve - Njohja dhe zbatimi me sukses i metodës së albumeve “Të drejtat tona” me nxënës.
Përmbajtja:	Qasja përmbajtësore e këtij programi është edukimi i fëmijëve për të drejtat e tyre dhe përgatitje e fëmijëve për qytetari aktive, përgjegjës për tolerancë dhe bashkëjetesë.

	Rol të rëndësishëm këtu është edhe zbatimi me sukses i kurrikulës shkollore, duke pasur parasysh përmbajtjen e plan programit të Edukatës qytetare, por duke u bazuar edhe në zhvillimet tjera për arritjen e rezultateve të nxënësve përmes të shkathtësive dhe arritjen e kompetencave. Shpërndarja e literaturës (8000 broshura për të drejtat e fëmijëve, karta dhe albume për fëmijë që përmbajnë të drejtat e tyre) Metoda me albumet “Të drejtat tona” plotëson synimin e arsimit kosovar në edukimin e fëmijëve për të drejtat e tyre.
Metodat e realizimit të programit	Përgatitja e mësimitdhënësve, këshilltarëve shkollorë dhe profesionistëve për të drejtat e fëmijëve si trajnerë të ardhshëm për të drejtat e fëmijëve. Trajnimi i mësimitdhënësve për edukimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe për zbatimin e metodës së albumeve “Të drejtat tona”. Monitorimi i zbatimit me nxënës të metodës me albumet “Të drejtat tona”. Vlerësimi i rezultateve të punës me nxënës përmes pyetësorëve.
Certifikimi	Në fund të çdo trajnimit do të certifikohen trajnerët dhe mësimitdhënësit
Trajner	Trajnerët e trajnimit të këshilltarëve shkollorë dhe mësimitdhënësve janë ekspertë ndërkombëtar dhe vendorë të profilit profesional për të drejtat universale të njeriut.
Data	06.08.2021

Titulli i Programit;**Qasja metodologjike në mësimdhënien e gjuhës angleze përmes hulumtimit në veprim**

Titulli i organizatës	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	IPK
Adresa:	Musine Kokollari nr. 83, Prishtinë
E-mail:	luljetashala1@hotmail.com
Telefoni:	
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr.23/2021 datë: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	48 orë trajnimi në 6 ditë i shtrirë (3 ditë - follow up - zbatim) =24 orë punë praktike Një ditë prezantim i punës praktike 8 orë Gjithsej 80 orë të bartura në certifikatë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e gjuhës angleze, dhe mësimdhënësit e gjuhëve të tjera të nivelit 1-9.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	• Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për qasjen metodologjike në mësimdhënie përmes hulumtimit në veprim • Ndërlidhja e pjesës teorike me praktiken – eksperimentimi në klasë
Përmbajtja:	Programi i trajnimit ka një strukturë të ndërlidhur të përmbajtjeve që fillon me hyrje të programit ku jepet informacionet për qëllimin, objektivat dhe modulën e programit. Secila temë është në funksion të realizimit të objektivave të programit të trajnimit, dhe ka për qëllim përmirësimin e praktikave profesionale të mësimdhënies, po ashtu ka të specifikuar edhe aktivitetet, kohën e realizimit, procedurat, metodat, mjetet e punës dhe materialet mbështetëse përkatëse. Realizimi i temave të programit përfshin aspektet teorike mbi bazën e informacionit profesional të integruar në përmbajtje të programit, si dhe aspekte të praktikës dhe punës së pavarur të pjesëmarrësve në funksion të zbatimit praktik të njohurive dhe shkathtësive të fituara. Programi përmban tri module: 1. Qasja metodologjike e mësimdhënies së gjuhës angleze përmes hulumtimit në veprim

	2. Metoda interaktive në të mësuar të gjuhës angleze në shkollë fillore- Teknika mësimore bazuar në lojë 3. Inteligjencat e shumefishta & gjuha e huaj në shkollë fillore
Metodat e realizimit të programit	Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie Mësuesi përmes teknikave që do përdoren do të jetë i aftë të... • njohë tipet e nxënësve; • aktivizojë të gjithë nxënësit në procesin mësimor; • përshtatë programin dhe të ndërtojë punën në bazë të kapaciteteve që ka në klasë në përputhje me objektivat e arritjes së nxënësve; • bëjë vlerësim të drejtë në përputhje me standardet e arritjes së nxënësve; • njohë psikologjinë e nxënësve; • organizojë punë me grupe; • përdorë metoda, mënyra dhe teknika të larmishme të mësimdhënies; • motivojë nxënësit në klasë e jashtë saj; • zhvillojë aftësitë gjuhësore (të lexuarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të shkruarit); • zhvillojë aftësitë edukative në klasë e jashtë saj; • zhvillojë ndërveprimin gjatë orës së mësimi; • jetë organizator, ndihmës, orientues dhe shpjegues gjatë gjithë procesit të mësimi të gjuhës angleze; • në qendër të mësimdhënies të jetë nxënësi dhe detyra e tij në ndërveprim me të tjerët.
Certifikimi	(modeli bashkangjitur i aplikimit)
Trajner	1. Luljeta Shala 2. Ismet Potera 3. Mimoza Kryeziu 4. Rexhep Veliu 5. Gjejlane Morina 6. Agneta Syla
Data	03.08.2021

Titulli i Programit	Komuniteti i të nxënit demokratik dhe gjithëpërfshirës
----------------------------	--

Titulli i organizatës	Këshilli i Evropës
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Këshilli i Evropës
Adresa:	Bedri Pejani 17/18 Prishtinë
E-mail:	Education.pristina@coe.int ; vjosa.rogoval-damoni@coe.int
Telefoni:	+383 38 40 77 50
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr 53/2021 Data: 23.09.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	32 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e nivelit para-universitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	500 mësimdhënës gjatë dy viteve
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të: • Njihen me metodologjitë e bazuara në përvojën e Këshillit të Evropës në fushën e kompetencave të kulturës demokratike, të cilat kanë përdorim praktik në aktivitetet që mund të organizohen në nivel shkolle, bazuar në një qasje që përfshinë gjithë shkollën; • aftësohen për të mbështetur shkollat në krijimin e një kulture demokratike, përmes zbatimit të qasjeve gjithëpërfshirëse, bazuar në standardet dhe praktikën e Këshillit të Evropës; • jenë të aftë të mbështetësin shkollën në angazhimin aktiv ndaj proceseve të zhvillimit, me idenë e ndërtimit të një kulture demokratike dhe gjithëpërfshirëse në shkollë dhe realizimit të një procesi zhvillimor me pjesëmarrje; • ndërgjegjësohen për rolin dhe përgjegjësitë që kanë rreth dukurisë së bullizmit në shkollë dhe shoqëri ; • jenë të aftë për të marrur rol aktiv për të reaguar në mënyrë konstruktive ndaj bullizmit; • ndërgjegjësohen për ndikimin e ambientit në mirëqenien e fëmijëve.

Përmbajtja:	<i>Dita 1</i> Ndërtimi i ekipit, profil shkollor gjithëpërfshirës, njohuri themelore rreth fakteve kryesore të përfshirjes. <i>Dita 2</i> Reflektimi dhe raportimi për sukseset e para. Njohja me elementet kryesore në lidhje me bullizmin, dhe të kuptuar dhe përdorimi i Kornizës referencë për Kompetencat e Kulturës Demokratike të Këshillit të Evropës– (RFCDC – Reference Framework for Competences for Democratic Culture – Council of Europe) <i>Dita 3</i> Prezantimi i posterit kundër bullizmit dhe planifikimi i një jave të veprimi kundër bullizmit. Njohja me faktorët kryesorë për një planifikim të mirë gjithëpërfshirës <i>Dita 4</i> Prezantimi i projektit mjedisor me potencial gjithëpërfshirës dhe demokratik. Seanca mësimore praktike si provë e zhvillimit personal.
Metodat e realizimit të programit	Përmes zhvillimit profesional me bazë në shkollë, pjesëmarrësit e këtij trajnimit, do të marrin pjesë në gjashtëmbëdhjetë sesione me kohëzgjatje 90 minutave (6 orë të plota), të moderuara me trajnerët. Trajnerët e përzgjedhur me kritere të caktuara, janë përgatitur paraprakisht për të ofruar këtë trajnim. Pastaj, një kohë e caktuar dedikohet për zbatim të njohurive të trajnimit, me nxënës, kolegët tjerë në shkollë dhe reflektim me trajner, e që në nkuptim kohor është ekuivalente me 16 sesione tjera 90 minutshe (24 orë tjera). Trajnimi është i dizajnuar ashtu që të mund të ofrohet në sallë trajnimit ose në mënyrë virtuale nga distanca përmes platformave elektronike, duke përfshirë ndërveprim, plane dhe projekte mësimore, aktivitete me nxënës, prezantime, diskutime, punë individuale, dhe punë në ekip me kolegët tjerë mësimdhënës. Gjatë kësaj periudhe pjesëmarrësit mbështeten nga trajnerët për këtë program, përmes këshillave dhe po ashtu observohen gjatë procesit mësimor, që të përkrahen deri në përmbushjen e kërkesave për certifikim. Materiali mbështetës për mësimdhënës e që është njohje me çështjen

	dhe terminologjinë dërgohet te pjesëmarrësit paraprakisht në formë elektronike. Vijimi i të gjitha sesioneve të trajnimit është obligativ dhe përcjellët përmes listave të nënshkruara.
Certifikimi	Pjesëmarrësit e këtij trajnimi do të certifikohen me 20 pikë për licencim, nëse përmbushin të gjitha kërkesat të cilat respektohen në mënyrë rigoroze: • Së paku 90% pjesëmarrje në sesionet kontaktuese dhe në takimet reflektuese me fasilitues; • Realizimi i aktiviteteve me nxënës dhe kolegë sipas udhëzimeve të programit; • Pjesëmarrje në sesione reflektuese me kolegë.
Trajner	Grup trajnerësh vendorë dhe ndërkombëtarë
Data	15.11.2021

Titulli i Programit	Ngritja e Kapaciteteve për Arsim Gjithëpërfshirës
----------------------------	--

	Moduli I : Aftësia e kufizuar dhe arsimi gjithëpërfshirës
Titulli i organizatës	Këshilli i Evropës
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Këshilli i Evropës
Adresa:	Bedri Pejani 17/18 – 10000 Prishtinë
E-mail:	Education.pristina@coe.int ; vjosa.rogova-damoni@coe.int
Telefoni:	+383 31 40 77 50
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr 56/2021 - Data 23.09.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	36 orë
Përfituesit:	Trajnimi synon grupet e mësimdhënësve si në vijim: Mësimdhënësit e Qendrave Burimore, Mësimdhënësit e rregullt të shkollave të rregullta që punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, edukatorët, psikologët dhe stafi tjetër i shkollës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Gjithsej 135 mësimdhënës nga Qendrat Burimore
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit në këtë modul pritet që: - të zhvillojnë një kuptim të përbashkët se çka janë aftësitë e kufizuara dhe si mund t'u shpjegohen ato të tjerëve (përfshirë prindërit dhe mësuesit në shkolla të rregullta) dhe të adresojnë praktikën në lidhje me vlerësimin, planifikimin dhe realizimin e ndërhyrjeve në qendra burimore dhe shkolla të rregullta. - të zhvillojnë të gjitha çështjet e rëndësishme në lidhje me të kuptuarit, vlerësimin dhe adresimin e çështjeve që lidhen me kufizimet funksionale, me një fokus në problemet e pjesëmarrjes. Fokusi është në problemet e pjesëmarrjes, sepse ato kanë një rol kryesor në mundësimin e të mësuarit (si qasja, ashtu edhe pjesëmarrja në të mësuarit dhe aktivitetet shkollë). Aktivitetet në të tre njësitë çojnë në aktivitete që mund të realizohen në qendra burimore për të përmirësuar praktikën aktuale. - të njihen me një "peizazh njohurie" që është i nevojshëm për të kuptuar dhe adresuar situatën e aftësisë së kufizuar dhe situatën e pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Situata e arsimit do të jetë në qendër të modulit të dytë hyrës.

	- Të mësojë se si mund të arrihet arsimi gjithëpërfshirës. Filozofia, fushat e kompetencës (shih p.sh. Profili për Mësuesit Përfshirës) të përshkruara në Programin e Ndërtimit të Kapaciteteve janë të përfshira në përmbajtje dhe aktivitete, por jo të mësuara në mënyrë të qartë, duke ndjekur premisën që pjesëmarrësit i dinë këto koncepte "në teori", por kanë nevojë të mësojnë se si t'i zbatojnë këto koncepte në praktikën e tyre të përditshme dhe kërkojnë mjete adekuate për ta bërë këtë. Si përmbledhje, moduli do të ndërtojë njohuri, aftësi dhe kompetenca përkatëse për të filluar zbatimin e praktikave të mira në fushat e njohurive të adresuara.
Përmbajtja:	Dita e parë: Njësia 1: Zhvillimi i një gjuhe të përbashkët për aftësinë e kufizuar - Aktiviteti 1.1 Flasim për aftësinë e kufizuar - Aktiviteti 1.2 Dekonstruktimi i kategorive të aftësisë së kufizuar - Aktiviteti 1.3 Qasja e bazuar në situata (rrethana) për të kuptuar aftësinë e kufizuar - Aktiviteti 1.4 Informacione të ndryshme për qëllime të ndryshme Dita e dytë: - Njësia 2: Praktikën e vlerësimit në kontekstin e aftësisë së kufizuar - Aktiviteti 2.1 Zgjidhja e Problemeve Profesionale - Aktiviteti 2.2 Vlerësimi i aktiviteteve dhe pjesëmarrjes - Aktiviteti 2.3 Vlerësimi i mjedisit - Aktiviteti 2.4 Vlerësimi i situatës Dita e tretë: Njësia 3: Sigurimi i angazhimit aktiv të fëmijëve me aftësi të kufizuara - Aktiviteti 3.1 Dinamika e pjesëmarrjes - Aktiviteti 3.2 Zhvillimi i qëllimeve të pjesëmarrjes - për çfarë dhe për çfarë? - Aktiviteti 3.3 Përmirësimi i pjesëmarrjes përmes ndryshimeve mjedisore - ku? - Aktiviteti 3.4 World Café: Eksplorimi i blloqeve ndërtimore për përmirësim
Metodat e realizimit të programit	Çdo njësi përbëhet nga katër aktivitete që adresojnë një fushë të kompetencës dhe praktikën kryesore në lidhje me të kuptuarit, vlerësimin dhe adresimin e çështjeve/sfidave të pjesëmarrjes që hasen nga fëmijët me aftësi të kufizuara. Çdo aktivitet ka një format

	të ngjashëm: Ngrohja (përqendrimi i vëmendjes në çështje specifike, përmes stuhive të mendimit (brainstorming) për të aktivizuar njohuri, shikimi i një videoje për të theksuar një problem ose diskutim të përvojave të pjesëmarrësve. Ngrohja zakonisht pasohet nga një prezantim i cili mund të regjistrohet dhe t'u vihet në dispozicion kolegëve që nuk mund të marrin pjesë (përfshirë kolegët që punojnë në shkolla të rregullta). Prezantimi ose kontributi vijohet nga një sekuencë ku pjesëmarrësit janë të angazhuar në mënyrë aktive në zgjidhjen e bashkëpunuese të problemeve, ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira. Aktivitetet përfshijnë reflektim mbi mënyrat e mundshme përpara drejt implementimit, zhvillimit të mjeteve apo zhvillimit të materialeve. Pjesëmarrësit do të inkurajohen të sjellin materialet, mjetet e tyre ose të regjistrojnë video të situatave që ata dëshirojnë të trajtojnë. Të drejtat e privatësisë (p.sh. marrja e pëlqimit të prindërve për të ndarë video) do të merren në konsideratë. Pjesëmarrësve do t'u prezantohen modele (p.sh., Modeli i Teorisë së Aktivitetit, Cikli për Zgjidhjen e Problemeve, Harta e Ekosistemit) që përdoren gjithashtu në modulet e UNICEF-it për Arsimin Përfshirës. Ato shërbejnë si modele konceptuale për të ndihmuar në organizimin e informacionit dhe për të biseduar me të tjerët për çështje specifike. Modelet janë gjithashtu pika fillestare për të zhvilluar protokolle që përshtaten me nevojat e secilës shkollë. Për më tepër, ato mund të përdoren për të lidhur punëtorinë tematike me njohuritë e marra në modulet hyrëse dhe për të zhvilluar materialet e të nxënit. Metodat e aplikuara dhe organizimi i sesioneve të trajnimit do të varet nga zhvillimi i pandemisë aktuale, në grupe me të vogla apo më të mëdha. Formatet e mëposhtme janë të mundshme: Nëse moduli jepet ekskluzivisht në internet, mund të jetë adekuate të planifikohen për 12 seminare gjysmë dite, secili duke mbuluar dy aktivitete me 90 minuta kohëzgjatje. Punëtoritë gjysmë-ditore mund të kombinohen me punëtoritë një (1) ditore të plota nëse ato mund të planifikohen në vend në vend të online. Teorikisht, çdo kombinim i gjysmës së ditës dhe ditëve të plota është i mundur, por rekomandimi është që të lihet kohë për implementim ndërmjet punëtorive. Plani i detajuar për kryerjen e aktiviteteve, veçanërisht angazhimin aktiv të parashikuesit gjithashtu do të varen nga madhësia e grupit.
Certifikimi	Certifikatë pas përfundimit të 36 orëve të trajnimit
Trajner	Judith Hollenweger-Haskell
Data	15.11.2021

Titulli i Programit	MENAXHIMI I KLASËS DHE DISPLINA
Titulli i organizatës	Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime "KONICA"
Tipi i programit:	Program plotësues i trajnimit
Ofertuesi i programit:	Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime "KONICA"
Adresa:	rr. Muharrem Fejza, p.n. Mati 1, Prishtinë
E-mail:	qeht.konica@gmail.com
Telefoni:	049 328 528
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 33/2021, datë 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	16 orë
Përfituesit:	Të gjithë mësimdhënësit e nivelit para universitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	22
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Çdo mësimdhënësi i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra: ○ Të jetë në gjendje të ndërtojë besimin, ndjenjat e respektit të ndërsjellë dhe marrëdhënieve midis nxënësve; ○ Të aplikojë me sukses fazat e formimit të grupit; ○ Të drejtojë alternativet midisi të gjitha veprimtarive, duke e çuar mësimin drejt një përfundimi të suksesshëm; ○ Të motivojë nxënësit në qëndrimin e tyre aktiv ndaj të nxënit; ○ Të zhvillojë rregullat në përputhjes me kushtet e klasës dhe arsyetimin e nxënësve; ○ Të njohë kushtet thelbësore në zhvillimin e mësimi për mendimin kritik; ○ T'i motivojë nxënësit në krijimin pozitiv të klasës; ○ Të sigurojë disiplinën në klasë që çon drejt të nxënit të efektshëm; ○ Të trajtojë dhe të kontrolloj sjelljet e padëshirueshme të nxënësve; ○ Të fitojë autoritetin e mësimdhënësit;

Përmbajtja:	<i>Përmbajtja e programit:</i> ○ Menaxhimi i klasës dhe disiplina; ○ Grupi dhe fazat e formimit të tij; ○ Ekologjia e klasave; - Karakteristikat e klasave ○ Fillimi dhe përfundimi i mësimi. Alternimi i veprimtarive në të - Fillimi me përpikëri; - Mobilizimi mendor; - Kalimet e qeta; - Përfundimi i mësimi; - Klima e klasës. ○ Disiplina dhe rregulli në klasë ○ Shqyrtimi i shkaqeve dhe këshillimi - Këshillimi i suksesshëm ; - Përdorimi me sukses i qortimit; - Natyra dhe qëllimi i ndëshkimit; - Të metat e ndëshkimit; - Llojet e ndëshkimit.
Metodat e realizimit të programit	Programi realizohet përmes trajnimit që zhvillohet në klasë. Metodologjia e përdorur është e bazuar në ligjërime dhe punë praktike gjatë gjithë trajnimit. Trajnimi zgjatë 2 ditë + 1 ditë monitorim. Në këtë trajnim do të përfshihen edhe shembuj praktikë për të gjitha pjesët e programit. Trajnimi bazohet në: ○ Ligjërime ○ Prezantim me Powerpoint ○ Shembuj praktikë përmes detyrave gjatë trajnimit; ○ Ushtrime ○ Aktivitete atraktive ○ Kombinim i materialeve tekst dhe video.
Certifikimi	Kandidatët që ndjekim të gjitha ditët e plota të trajnimit, certifikohen me 16 orë trajnimi të programit plotësues.
Trajner	Diana Qarkaxhija Edi Gaxha Puka
Data	04.08.2021

Titulli i Programit	IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE SHËNDETËSORE TË FËMIJËVE NË KOPSHT DHE NË SHKOLLË
Titulli i organizatës	Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime “KONICA”
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime “KONICA”
Adresa:	rr. Muharrem Fejza, p.n. Mati 1, Prishtinë
E-mail:	qeht.konica@gmail.com
Telefoni:	049 328 528
Numrat dhe data e aprovimit:	2/1K Nr. 458, Dt. 07.05.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	32 orë
Përfituesit:	1. Edukatorët e institucioneve parashkollore; 2. Mësimdhënësit e Niveleve të arsimit 1, 2 dhe 3;
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në fund të këtij programi mësimdhënësit do të jeni në gjendje të: 1. Të familjarizohen me sëmundjet më të shpeshta të fëmijëve / nxënësve; 2. Të identifikojnë problemet shëndetësore të fëmijëve / nxënësve; 3. Ta japin ndihmën e parë në klasë për fëmijët / nxënësit që manifestojnë probleme shëndetësore; 4. Ta referojnë sëmundjen e fëmijës / nxënësit te prindërit në fazë të hershme të saj, në mënyrë që të parandalohet / shërohet sëmundja me kohë.
Përmbajtja:	Programi i trajnimit të mësimdhënësve <i>Identifikimi i problemeve shëndetësore të fëmijëve në kopsht dhe klasë</i> , përbëhet nga 3 module

	të cilat realizohen në 3 ditë trajnimi. Secili modul, përfshinë edhe detyra dhe këshilla praktike. Moduli i katërt përfshin pjesën e monitorimit. Dita e parë e trajnimit: Moduli 1: Problemet shëndetësore akute të fëmijëve Dita e dytë e trajnimit: Moduli 2: Problemet shëndetësore kronike Dita e tretë e trajnimit: Moduli 3: Problemet shëndetësore mentale Moduli 4: Monitorimi i edukatoreve / mësimeve për identifikimin e problemeve shëndetësore.
Metodat e realizimit të programit	Modulet e programit trajnues sigurojnë informacione bazike lidhur me tri modulet e trajnimit dhe temat e përfshira në këto module, ndërlidhjen e tyre me kërkesat dhe nevojat e edukatoreve e mësimeve si dhe mundësitë për zbatim të efektshëm në nivel klase. Programi trajnues ofrohet gjatë vikendeve, meqë secili modul ka një ditë të trajnimit dhe pas përfundimit të çdo dite të trajnimit do të ketë detyra praktike për pjesëmarrësit, të cilat realizohen gjatë punës në shkollë. Sesionet e trajnimit për secilin modul, janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, punë në grupe, ndërveprim, demonstrim dhe aktivitete atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete në kuadër të programit të trajnimit. Pjesë e metodologjisë për ofrimin e programit të trajnimit, janë: prezantimet në PowerPoint për secilin modul, ligjërata, punë grupore, prezantime, diskutime, këshillim/trajnim kolegjial, reflektim të nxënies, lehtësim/fasilitim, detyra praktike për përgatitje dhe realizim në vendin e punës. Qasja e përzgjedhur për këtë program të trajnimit ofron mundësi që mësimeve të jenë të përfshirë në aktivitete të përbashkëta, nën udhëheqjen e një trajneri, i cili është mjek gjithashtu, për të diskutuar

	e provuar ide e forma të ndryshme të zbatimit të praktikave.
Certifikimi	Certifikimi, 32 orë
Trajner	Dr. Rita Qarkaxhija Dr. Nita Ymeraga
Data	11.10.2021

Titulli i Programit	TË MËSUARIT PËRMES TEKNOLOGJISË – PËRDORIMI I PROGRAMEVE APLIKATIVE
Titulli i organizatës	Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime “KONICA”
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime “KONICA”
Adresa:	rr. Muharrem Fejza, p.n. Mati 1, Prishtinë
E-mail:	qeht.konica@gmail.com
Telefoni:	049 328 528
Numrat dhe data e aprovimit:	2/1K Nr. 458, Dt. 07.05.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	24 orë
Përfituesit:	3. Mësimdhënësit e Niveleve të arsimit 1, 2 dhe 3;
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Në fund të këtij programi mësimdhënësit do të jeni në gjendje të: 1. Ta praktikojnë mësimdhënien përmes përdorimit të teknologjisë; 2. Të krijojnë projekte për lëndët mësimore përmes programeve aplikative; 3. Të familjarizohen me metodologjinë dhe zbatimin e TIK në mësimdhënie; 4. Të krijojnë teste dhe mësim në formë elektronike; 5. T'i zotërojnë shkakthtësitë e komunikimi online.
Përmbajtja:	Programi i trajnimit të mësimdhënësve <i>Të mësuarit përmes teknologjisë – përdorimi i programeve aplikative</i> përbëhet nga 6 module të cilat realizohen në 2 ditë trajnimi. Secili modul, përfshinë edhe detyra dhe këshilla praktike të zbatimit të teknologjisë në

	mësimdhënie. Moduli i shtatë përfshin pjesën e monitorimit. Dita e parë e trajnimit: Moduli 1: Teknologjia në mësimdhënie; Moduli 2: Mësimi i bazuar në projekte përmes teknologjisë Moduli 3: Mësimi me zgjedhje – përgatitja e projekteve shkollore Dita e dytë e trajnimit: Moduli 4: Puna me aplikacioni dhe krijimi i projekteve; Moduli 5: Të mësuarit përmes teknologjisë dhe mësimi online Moduli 6: Komunikimi online Dita e tretë e trajnimit: Moduli 7: Në këtë modul përfshihet pjesa e monitorimit.
Metodat e realizimit të programit	Modulet e programit trajnues sigurojnë informacione bazike lidhur me gjashtë modulet e trajnimit dhe temat e përfshira në këto module, ndërlidhjen e tyre me kërkesat dhe nevojat e mësimdhënësve si dhe mundësitë për zbatim të efektshëm të TIK në nivel klase. Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë, parimet dhe kërkesat që lidhen me përdorimin e TIK në klasë. Sesionet e trajnimit për secilin modul, janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, punë në grupe, ndërveprim, demonstrim dhe aktivitete atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete në kuadër të programit të trajnimit. Pjesë e metodologjisë për ofrimin e programit të trajnimit, janë: prezantimet në PowerPoint për secilin modul, ligjërata, punë grupore, prezantime, diskutime, këshillim/trajnim kolegjial, reflektim të nxënies, lehtësim/fasilitim, detyra praktike për përgatitje dhe realizim në vendin e punës. Qasja e përzgjedhur për këtë program të trajnimit ofron mundësi që mësimdhënësit të jenë të përfshirë në aktivitete të përbashkëta, nën

	udhëheqjen e një trajneri, për të diskutuar e provuar ide e forma të ndryshme të zbatimit të praktikave për vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca
Certifikimi	Certifikimi, 24 orë
Trajner	Msc. Ersan Hamdiu Msc. Matej Bushaj
Data	11.10.2021

Titulli i Programit	Lions Quest -Shprehitë për adoloshencën
Titulli i organizatës	Lions Iternational -Lions Club Peja
Tipi i programit:	
Ofertuesi i programit:	OJQ Lions Club Peja
Adresa:	Rr.Mbretëresha Teutë p.n. Pejë
E-mail:	bekim_shoshi@hotmail.com
Telefoni:	044281858
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr.478 ,datë :24.03.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	42 orë trajnim drejtëpërdrejtë ,12 orë detyra dhe projekte,63 orë për certifikim
Përfituesit:	Përfitues primar :mësuesit fillor dhe të mesëm të ulët Përfitues sekondar :drejtorët e shkollave,pedagog dhe psikolog Përfitues janë të gjithë nxënësit e shkollave dhe mësime dhënëseve pjesëmarrës në trajnim..
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	24 pjesëmarrës në çdo trajnim
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Rezultatet e programit janë të ndërlidhura me katër fazat e mësime dhënëse të cilat promovohen dhe zbatohen gjatë tërë programit. Rezultatet janë të strukturuar dhe planifikuara si më poshtë: FAZA E PARË: TË ZBULUARIT Rezultati: Zbulohet se çfarë dinë që më parë për temën nxënësit. Mësuesi tregon entuziazëm për temën, nxit interesin e nxënësve, dëgjon aktivisht, tregon respekt për këndvështrimet e ndryshme dhe fillon vlerësimin e dijeve të nxënësve mbi temën. FAZA E DYTË: VENDOSJA E LIDHJEVE

	Rezultati: Ndërlidhja e dijeve ekzistuese me informacionet dhe shprehitë e reja. Përdoren shpjegime të shkurtra, shembuj dhe/ose demonstrime, për të prezantuar dijet dhe shprehitë e reja dhe për të modeluar përdorimin e duhur të tyre. Për t'i ndihmuar nxënësit të kuptojnë konceptet përfshihen fletë transparente/diapozitiva, fleta burimore, fleta informative, artikuj dhe tregime. FAZA E TRETË: TË USHTRUARIT Rezultati: Ushtrohen shprehitë e reja nën orientimin e mësuesit dhe reflektim mbi ato çfarë kanë mësuar nxënësit. Nxënësit e ushtrojnë informacionin ose shprehinë e re në një kontekst të kuptimtë dhe që ka lidhje me ta. Mësuesi e ndjek me vëmendje veprimtarinë për t'u kujdesur që nxënësit ta kuptojnë informacionin ose shprehinë dhe të mund ta përdorin në mënyrë të saktë. Përmes pyetjeve që kërkojnë përpunim në një nivel më të lartë, mësuesi drejton përdorimin e shprehive, integrimin e dijeve dhe përmbledhjen e ideve më kryesore. FAZA E KATËRT: ZBATIMI Rezultati: Zbatimi i informacionit dhe/ose shprehisë së re në situata të reja. Përmes shkrimit në ditar, nxënësit mendojnë se si do të përdorëshin konceptet e reja në jetën e tyre. Veprimtari të tjera ofrojnë mundësi të tjera zbatimi dhe diskutime me persona të rritur në familje dhe shkollë.
	. Plani i mësimi për “Shprehitë për adoleshencën” është një model eklektik i mbështetur në punën e një morie studiuesish dhe mësuesish. Ai mbështetet në këto parime mësimore: • Mësimi orientohet nga objektivi. Ngaqë nxënësit e presin më mirë mësimin kur e dinë se cili është objektivi i tij, mësuesi u shpjegon objektivin e mësimi dhe arsyet përse po u mëson shprehitë dhe dijet konkrete.

Përmbajtja:	• Mësimi e lidh informacionin e ri me dije të mëparshme. Diskutimet dhe veprimtaritë i ndihmojnë nxënësit të vendosin ura lidhëse midis dijeve ekzistuese dhe informacioneve të reja. • Mësimi zhvillohet me faza, por gjithsesi është rekursiv. Organizimi në trajtë spirale e programit mësimor mundëson përsëritjen dhe përf forcimin e shprehive dhe dijeve të reja. • Të mësuarit ndikohet nga zhvillimi. Përmbajtja, qasja dhe ritmi i çdo mësimi ndërtohet në atë mënyrë që të plotësojë nevojat e të rinjve adoleshentë. Në thelb të planit të mësimit qëndron pikëpamja se nxënësit duhen parë si pjesëmarrës aktivë, të cilët e nisin vetë të mësuarit e tyre në mënyrë të natyrshme, duke u mbështetur në kureshtjen e brendshme të tyre. Theksi vihet te ndërveprimi—një element thelbësor i lidhjes të riut me shkollën (<i>Hawkins, 1999</i>). Të rinjtë punojnë së bashku për të mësuar koncepte, për të ushtuar të menduarit dhe shprehitë sociale dhe për të zbuluar përfitimet që u sjell bashkëpunimi në kuadër të arritjes së qëllimit të përbashkët. Katër fazat e mësimit u japin mundësi nxënësve të mbështeten te dijet dhe përvojat e tyre, të inkorporojnë informacionet e reja, të ushtrojnë ato që mësojnë, të reflektojnë dhe t'i përdorin informacionet dhe dijet e reja në një larmi situatash të reja. Gjatë trajnimit zhvillohen këto module : MODULI 1(Një komunitet i të mësuarit pozitiv) MODULI 2(Zhvillimi personal) MODULI 3(Zhvillimi social) MODULI 4(Shëndeti dhe parandalimi) MODULI 5(Mësim –shërbimi) MODULI 6(Zbatimi i programit) Dita e shtatë :Çërtifikimi i pjesëmarrësve
--------------------	---

Metodat e realizimit të programit	Modulet e programit sigurojnë informacione bazike lidhur me shtatë temat, ndërlidhjen e tyre me kërkesat e programeve aktuale mësimore (kërkesat kurrikulare) si dhe mundësitë për zbatim të efektshëm në nivel shkolle e klase. Programi trajnues ofrohet gjatë ditëve të fundjavës (kryesisht do të jetë ditën e shtunë) për të mos penguar procesin e rregullt mësimor. Qasja e përzgjedhur ofron mundësi që të gjithë mësimdhënësit e shkollës të jenë të përfshirë, dhe të gjithë së bashku, nën udhëheqjen e një trajneri/fasilituesi, të diskutojnë dhe provojnë ide e forma të ndryshme të zbatimit të temave në mësimdhënien e tyre. Kjo mënyrë e punës dhe e bashkëpunimit ndërmjet kolegëve të shkollës, mundëson shtjellimin e temave të ndryshme profesionale me interes të përbashkët, konsultim formal dhe kolegial të mësimdhënësve si dhe mundësi të avancimit profesional të mësimdhënësve përmes aktiviteteve me bazë në shkollë. Gjithashtu, modulet mund të përdoren për të monitoruar dhe për të mbështetur mësimdhënësit gjatë zbatimit të temave të ndryshme në klasë.
Certifikimi	Certifikimi bëhet duke u bazuar në kriteret e programit Lions Quest dhe kriteret e trajnimit. Cdo pjesëmarrës duhet të ndjekë me rregull trajnimin shtatë ditore ,të jetë aktiv dhe bashkëpunues me pjesëmarrësit e tjerë gjatë trajnimit,të shkëmbejnë idetë dhe përvojat e tyre rreth metodologjive mësimore dhe të përvetësojnë njohuritë e reja nga programi Lions Quest dhe ato njohuri të jenë në gjendje të i zbatojnë në praktikë gjatë procesit të mësimdhënies në shkollat e tyre.
Trajner	Ulla Sirvio Hyttinen ,Have Haxhiaj,Gjejlan Begolli, Fitore Ahmeti
Data	12.11.2021

Titulli i Programit	MENAXHIMI I CILËSISË NË SHKOLLË
Titulli i organizatës	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Adresa:	Rruga "Musine Kokollari", 10000, Prishtinë
E-mail:	nezir.c@gmail.com ; Nezir.Cocaj@rks-gov.net ;
Telefoni:	+383 38 213 830
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 22/2021 Datë 17.03.2021 - deri me 17.03.2023
Kohëzgjatja e programit (orë)	Programi zhvillohet gjatë 30 orëve të cilat janë të organizuara përmes 18 orëve të trajnimit të drejtpërdrejtë dhe 12 orë mentorim, angazhim për detyra, reflektim dhe punë praktike.
Përfituesit:	Pjesëmarrës dhe përfitues nga ky program trajnimi: 1. Udhëheqësit e shkollave (drejtorët/zv.drejtorët) nga të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë; 2. Koordinatorët e sigurimit të cilësisë (KSC) nga shkollat dhe DKA; 3. Zyrtarë të DKA-ve dhe anëtarë të ekipeve profesionale të DKA-ve. 4. Mësimdhënësit e Niveleve të arsimit 1, 2 dhe 3, pozitat e të cilëve lidhen me menaxhimin e cilësisë në shkollë;
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25-30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Me përvetësimin e këtij programi të trajnimit, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të: ▪ Fitojnë shkathtësi relevante për të përmbushur rolin e tyre në menaxhimin e cilësisë së shkollës; ▪ Prezantojnë para organeve të shkollës sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë; ▪ Planifikojnë, zbatojnë dhe monitorojnë proceset e menaxhimit të cilësisë së shkollës, në koordinim me koordinatorin për menaxhimin e cilësisë me bazë në shkollë,

	▪ Analizojnë dhe interpretojnë rezultatet e pasqyruara nga procesi i vet-vlerësimit të shkollës, ▪ Udhëheqin planifikimin Zhvillimor të Shkollës dhe Planin e Veprimit në ndërlidhje me kërkesat për sigurimin e cilësisë në shkollë, ▪ Udhëheqin dhe motivojnë personelin e shkollës që të punojë sipas ciklit të menaxhimit të cilësisë Planifiko-Bëj-Kontrolli-Vepro, ▪ Raportojnë për menaxhimin e cilësisë dhe rezultatet e këtij procesi tek mekanizmat e shkollës, DKA dhe MASHTI, brenda kornizës ligjore për raportim lidhur me proceset që zhvillohen në shkollë;
Përmbajtja:	Programi i trajnimit për menaxhimin e cilësisë në shkollë realizohet në tri ditë të trajnimit. Dy ditë të trajnimit kanë përmbajtje tematike të programit të trajnimit, të cilat janë të organizuara në tema sipas sesioneve të një dite të trajnimit. Secili sesion i një dite të trajnimit, krahas temës së përcaktuar në kuadër të programit të trajnimit, përfshinë edhe punë praktike me pjesëmarrësit e trajnimit, aktivitete, detyra dhe këshilla praktike lidhur me menaxhimin e cilësisë në shkollë. Programi i trajnimit sipas ditëve ka përmbajtjen në vijim: Përmbajtja e programit të trajnimit për <u>DITËN E PARË</u> Sesioni 1. Sigurimi i cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë ▪ Strategjia për Sigurimin e cilësisë në Arsimin Parauniversitar në Kosovë ▪ Ndryshimet në legjislacionin arsimor ▪ Trendët ndërkombëtare në sigurimin e cilësisë ▪ Ndryshimi i fokusit në rezultate të nxënës – kurrikula e bazuar në kompetenca ▪ Ndërlidhja në mes të vlerësimit të brendshëm (vetëvlerësimit) dhe vlerësimit të jashtëm, ▪ Elementi thelbësor për sigurim të cilësisë: cikli “Planifiko-Bej-Kontrollo-Vepro” Sesioni 2. Të kuptuarit e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë ▪ Definimi i koncepteve : Cilësi dhe Sigurim i cilësisë, ▪ Sigurimi i cilësisë – përgjegjësi e ndarë në niveleve të ndryshme arsimore ▪ Parimet e udhëheqjes për sigurimin e cilësisë në shkollë Sesioni 3. Sigurimi i cilësisë në shkollë ▪ Korniza për sigurimin e cilësisë –fushat e cilësisë dhe kriteret ▪ Fazat dhe llojet e proceseve të sigurimit të cilësisë ▪ Vlerësimi i performancës së shkollës – Vlerësimi i brendshëm

	(vetëvlerësimi) Sesioni 4. Procesi i menaxhimit të sigurimit të cilësisë në shkolla ▪ Cikli i procesit të menaxhimit të cilësisë PBKV dhe ndërlidhja e PZSHSH dhe PV të shkollave Përmbajtja e programit të trajnimit për <u>DITËN E DYTË</u> Sesion 1. Cikli i procesit të menaxhimit të cilësisë ▪ Hap i parë: PLANIFIKO ▪ Hapi i dytë: BËJ ▪ Hap i tretë : KONTROLLO ▪ Hapi i katërt: VEPRO Sesioni 2. Menaxhimi i përmirësimit të vazhdueshëm ▪ Procesi përgatitor ▪ Procesi i Vetëvlerësimit ▪ Procesi i planifikimit të përmirësimit të vazhdueshëm Sesioni 3. Rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e cilësisë në shkollë ▪ Detyrat me rëndësi për menaxhimin e cilësisë në shkollë ▪ Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi për akterët e përfshirë në menaxhimin e cilësisë në shkollë Sesioni 4. Zhvillimi i kulturës së reflektimit ▪ Format e reflektimit ▪ Pse duhet ta bëjmë? Kush duhet të përfshihet? Si duhet ta bëjmë/fillojmë atë? ▪ Ndikimi në menaxhimin e ndryshimit. ▪ Detyrat praktike , të cilat duhet të realizohen nga pjesëmarrësit deri në ditën e tretë të trajnimit, Orari i mentorimit Përmbajtja e programit të trajnimit për <u>DITËN E TRETË</u> SESSIONET 1 - 3. Prezantimi i detyrave praktike ▪ Shembuj të praktikave të mira ▪ Reflektim dhe diskutim për punën praktike (detyrat) dhe rezultatet e tyre ▪ Informacione teorike shtesë për çështjet e diskutuara (gjatë trajnimit) SESSIONI 4. Zhvillimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve për menaxhim të cilësisë në shkollë ▪ Informimi për mundësitë për zhvillim të mëtutjeshëm profesional për menaxhimin e cilësisë në shkollë; ▪ Reflektime rreth programit të trajnimit, mësimet e marra;
Metodat e realizimit të programit	Metodologjia e trajnimit mbështetet në parimet dhe kërkesat që lidhen me menaxhimin e cilësisë së shkollës. Pjesë e metodologjisë për ofrimin e programit të trajnimit, janë: prezantimet në PowerPoint, ligjërata, punë grupore, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, prezantime, diskutime, reflektim të nxënies, lehtësim/fasilitim, detyra praktike për

	aspektet e menaxhimit të cilësisë së shkollës.
Certifikimi	Certifikatë për pjesëmarrje dhe përfundim të suksesshëm Certifikimi i vijuesve bëhet në bazë të programit të trajnimit, pjesëmarrjes në trajnim dhe plotësimit të kriterëve themelore për portofolion e punës. Përgatitja dhe prezantimi i portfolios së programit të trajnimit përmban: detyra gjatë trajnimit, reflektive dhe punë praktike të realizuar gjatë programit të trajnimit.
Trajner	Lista e trajnerëve të certifikuar: Selim Mehmeti, Luljeta Shala, Haxhere Zylfiu, Ismet Potera, Zana Zeqiri, Diana Qarkaxhia, Afrere Lila, Arberie Nagavci, Nehat Duraku, Drita Curri & Ajet Brajshori
Data	03.08.2021

Titulli i programit	
Identifikimi, parandalimi dhe trajtimi i llojeve të dhunës në shkollë	
Titulli i organizatës	Organizatë joqeveritare
Tipi i programit:	Zhvillimi profesional i mësimeve në licencim në fushën e parandalimit dhe trajtimit të dhunës në shkollë
Ofertuesi i programit:	Syri i Vizionit
Adresa:	Rruga Isa Demaj Nr. 14, 30000 Pejë, Kosovë
E-mail:	info@syriivizionit.org
Telefoni:	039 423 240/ 044 111 408
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 54/2021 dhe 55/2021 Datë: 23.09.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	Një vit: Trajnimi për mësimeve do të jenë njëditorë, respektivisht numri i orëve të programit trajnues do të jetë shtatë (7) orë (09:00 - 16:00).
Përfituesit:	Mësimeve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 – 25 pjesëmarrës (tani në situatën aktuale të pandemisë COVID-19 dhe duke u mbështetur në rregullat e reja nga IKSHJ-ja)
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të përfshira në trajnime ka rënë numri i dhunës ndaj nxënësve; - Mësimeve të shkollave të përfshira në trajnime kanë njohuri për identifikim, parandalim, trajtim apo referim të dhunës ndaj nxënësve; - Rritet siguria në shkollë dhe është krijuar një mjedis miqësor për nxënësit; - Mësimeve të shkollave janë në gjendje të: • Ofrojnë një përkufizim për dhunën; • Tregojnë së paku katër shembuj të llojeve të dhunës në shkollë • Radhisin shkaktarët potencialë të dhunës në shkollë • Shpjegojnë pasojat e llojeve të dhunës tek nxënësit • Ofrojnë të paktën nga dy strategji për parandalim, identifikim, trajtim apo referim të rasteve të dhunës
Përmbajtja:	Ky modul/program do t'u shërbejë mësimeve për të përparuar të kuptuarin e tyre në identifikimin dhe intervenimin e hershëm mbi dhunën në shkollë dhe synon t'i ngritë njohuritë dhe aftësitë e mësimeve për krijimin, mirëmbajtjen dhe sigurimin e një mjedisi shkollor pa dhunë, të sigurt dhe miqësor për nxënësit. Në këtë program trajnues përfshihen çështjet kyçe: ○ Çfarë është dhuna? ○ Disa përkufizime të saj. ○ Dhuna në shkollë – specifikat. ○ Cilat janë llojet e dhunës?

	○ Çfarë e shkakton dhunën në shkollë – faktorët. ○ Kë prek dhuna në shkollë? ○ Cilat janë pasojat e dhunës në shkollë? ○ Si mund ta parandalojmë dhunën në klasë/shkollë? ○ Sa ka rëndësi marrja parasysh e pikëpamjeve të fëmijëve për të identifikuar format e parandalimit të dhunës mbështetur në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve .
Metodat e realizimit të programit	Metodologjia e përdorur është e përzier: - Përmban ofrimin e informacioneve të qarta dhe të sakta rreth përmbajtjes së koncepteve kyçe të temës qendrore të udhëzuesit në formë të fletushkave informative [one-page handouts]; - Ofron video prezantuese të rasteve specifike të dhunës në shkolla; - Ofron lojë në role për t'i vendosur mësimdhënësit në 'lëkurën' e individit që ushtron ose përjeton dhunë; - Ofron strategji të cilat mësimdhënësit do t'i 'lidhin' me rastet e veçanta në trajnim; - Përmban diskutime të lehtësuara me qëllimin kryesor të kuptuarit e përbashkët, ndarjen e rasteve por njëkohësisht edhe të ideve për identifikim apo trajnim të rasteve të veçanta të ofruara; - Përmban dy forma të vlerësimit të punëtorisë, me qëllim të sigurimit të informacionit për planifikimin dhe organizimin dhe njëkohësisht për efektivitetin e përmbajtjes së trajnimit.
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të certifikohen. Certifikata është e aprovuar së bashku me modulën e programit.
Trajnues	PhD Mimoza Shahini Dr. Ph Adelina Pronaj dhe MsC Ema Skeja
Data	23 tetor deri më 30 dhjetor 2021

Titulli i Programit	
Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie	
Titulli i organizatës	QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Tipi i programit:	Plotesues
Ofertuesi i programit:	QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Adresa:	Çagllavicë Magjistratja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	info@qapa-ks.org
Telefoni:	048-750-751
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr 35/2020 Data aprovimit: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi përmban 24 orë / 4 ditë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e karrierës, Mësimdhënësit mentor, mësimdhënësit e merituar, Drejtorët e institucioneve arsimore
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i grupeve të trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 – 25 pjesëmarrës. Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosovës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përdorimit të trajnimit, vijuesit do të jenë në gjendje: -Të kuptojnë dhe të njohin rëndësinë e përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie. -Të hulumtojnë dhe të gjejnë informatën e duhur në internet. -Të përvetësojnë njohuritë e nevojshme për programet kompjuterike si: Word, Excel, PowerPoint, Windows Media Player etj. Të përvetësojnë njohuri të nevojshme për pajisjet teknologjike si: kompjuterët, printerët, usb-të, projektor-ët, DVD-të etj. -Të zbatojnë këto informata në praktikë -Të aplikojnë informatat e gjetura në internet si: videot, fotot, animacionet, lojëra etj, përmes programeve kompjuterike, gjatë orëve mësimore - Vijuesit aftësohen që inovacionet e fituara t'i jetësojnë në procesin e mësimdhënies me qëllim të nxënies së suksesshëm nga nxënësit.
Përmbajtja:	Zhvillimi i jashtëzakonshëm i teknologjisë në vitet e fundit

padryshim që ka ndikuar në ndryshimin e mënyrës së funksionimit të çdo institucioni, përfshirë këtu edhe atyre edukative.

Aplikimi i teknologjisë tani më nuk është thjeshtë një inovacion por një domosdoshmëri.

TIK-u paraqet të gjitha llojet e pajisjeve teknologjike dhe programeve kompjuterike të cilat përdoren për gjetjen e informacioneve të nevojshme, manipulimin me këto informacione dhe aplikimin e tyre në procesin mësimor, duke ndryshuar kështu mënyrën tradicionale të mësimdhënies në atë moderne.

Shfrytëzimi i këtyre zhvillimeve teknologjike në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies imponon edhe ndryshimin e metodologjisë së përdorur gjatë mësimdhënies duke krijuar kështu metoda bashkëkohore, atraktive dhe kreative, me fokus nxënësin, të cilat po ndikojnë dukshëm në mësimdhënie/mësimnxëni. Pajisjet teknologjike si: kompjuterët, projektorët, tabelat dixhitale, programet kompjuterike, internet, tabletët etj, janë përfshirë në sistemin e arsimit me ç'rast janë duke e ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme këtë proces.

Ky revolucion teknologjikë ka sjell me vete shumë avantazhe tjera si:

- Mësimdhënie/nxënie më të lehtë, më të shpejtë, më efikas
- Zhvillimin e kreativitetit tek nxënësit
- Përforcimin e njësive të shpjeguara
- Rritjen e aktivitetit në orën mësimore
- Mbajtjen e vëmendjes në mësim
- Ofrimin e shumë alternativave përgjetja e mënyrës së duhur që nxënësit të dëgjojnë dhe të përgjigjen.
- Bashkëveprim më të madhë nxënës me nxënës sikur edhe arsimtar me nxënës
- Forma të shumta të kombinimit të materialit teorik dhe praktik
- Transpofrmimin e klasës në një ambient pune dhe nxënieje etj

Ky program studimor ka për qëllim që të përgatisë mësimdhënësit në aspektin profesional për shfrytëzimin e TIK nga mësimdhënësit dhe nxënësit për qëllime arsimore.

Dominimi i metodave tradicionale të cilat e fuqizojnë njohurinë enciklopedike dhe jo ato praktike, mungesa e metodave interaktive dhe inovacioneve bëjnë që Teknologjia Informatike e Komunikimit të shfrytëzohet si reformator në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies.

Nevoja dhe arsyeja e aplikimit të TIK-ut në arsim fillon qysh nga fakti i përgatitjes së të rinjve për këtë fushë meqë zhvillimi i shoqërisë informatike paraqet një nga detyrat prioritare të gjithë ne. Ky program do të trajtojë ndryshimet dhe efektet e TIK-ut në arsimin duke vëndosur theksin në nevojën dhe aplikimin sa më efikas të TIK-ut, në ndryshimin e metodave mësimore nga ato tradicionale në interactive.

Modulet I

Ky modul ju jep mundësi vijuesëve të fitojnë njohuri bazike mbi format e shumta të cilat mund të përdoren gjatë procesit mësimor. Vijuesit do të jenë në gjendje të shohin dhe praktikojnë shembuj konkret të gjetjes, përpunimit dhe aplikimit të metodave dhe shembujve të ndryshëm të cilët mund të përdoren në njesitë mësimore të çdo lënde. Gjetja e informatës së nevojshme dhe të duhur në internet dhe përpunimi i tyre për të arritur zhvillimin më efikas të planprogrami është me rëndësi të veçantë për planifikimin e orës mësimore. Do të testohen njohuritë në mënyrë që të dihen saktë nevojat e pjesëmarrësve.

Modulet II

Gjatë këtij moduli vijuesit të fitojnë njohuri bazike mbi përdorimin e paketës së Microsoft Office si: Word, Excel, PowerPoint, Windows Media Player etj. Informatat e gjetura nga Modul I, do të përpunohen dhe do të integrohen në këto programe kompjuterike. Vijuesit do të planifikojnë një njësi dhe do të zhvillojnë planin se si të përdorin shembuj konkret për njësinë mësimore duke përodur kështu njërin nga programet kompjuterike në të cilat do të integrohen shembuj si: video, foto, dokumentar, animacion, zë etj. Një shembull i përdorimit të teknologjisë është simulimet nëpërmjet lojërave kompjuterike.

Modulet III

Aplikimi i pajisjeve teknologjike gjatë punës në klasë si: kompjuterët, projektoret, USB-të, DVD-të me shembuj konkret. Vijuesit do të marrin njohuritë mbi përdorimin e postës elektronike për të komunikuar me nxënësit.

Modulet IV

Për t'u siguruar se programet dhe mjetet e teknologjisë janë kuptuar në mënyrë efektive, vijuesit do t'i përdorë ato

	nëpërmjet zbatimit me shembuj konkret. Detyra e mësimdhënësit është të ndajë informacionin e duhur duke përdorur një metodë të përshtatshme për të ndihmuar nxënësin ta kuptojë atë. Aktivitetet vizuale me programet kompjuterike mund të jenë komponentë shumë e rëndësishme për të ndihmuar nxënësin të shohë se si konceptet zbatohen në situata reale. Axhenda Dita I-rë Si mund të përdoret TIK në mësimdhënie dhe mësimnxënie • Si të përdorim internetin për të arritur deri tek informata e nevojshme • Shembuj praktik i aplikimit të TIK në secilen lëndë Dita II-të Përvetësimi i njohurive bazë për paketën Microsoft Office: - Word - Excel - Power Point - Windows Media Player Dita III-të Përdorimi i postës elektronike (email) • Përdorimi i pajisjeve teknologjike - Kompjuterëve - Printerëve - Projektorit - USB-ve Dita IV-të Aplikimi dhe praktikimi i gjitha moduleve duke përdorur programet kompjuterike dhe pajisjet teknologjike
Metodat e realizimit të programit	• Mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve • Mësimdhënia algoritmike • Mësimdhënie përmes përdorimit të TIK-t • Mësimdhënia kooperative dhe ndërvepruese
Certifikimi	Përfshirja aktive në debat dhe pjese praktike gjatë trajnimit llogaritet deri në 5% te pikeve gjate procesit të vleresimit. Gjithashtu stafi i organizatës monitoron procesin e trajnimit duke u siguruar që trajneret zbatojnë me përpikmëri agjendën e paraparë dhe përdorimin e metodologjisë se aplikuar gjatë trajnimit. <i>Perfshirja aktive 5%</i> <i>Pjesa praktike 25%</i> <i>Testi vlerësues 70%</i>
Trajner	Valdete Daku Trajnere Inxhinieri Kompjuterike Rinor Bytyçi Trajner Trajner „Internet Technology and

Architecture" - Germany/Italy	
Florinda Gashi Trajnere "Sistemeve të informacioneve" - UBT	
Data	01.11.2021

Titulli i Programit	Të mësuarit e kombinuar (BLENDED LEARNING)
Titulli i organizatës	QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Adresa:	Çagllavicë Magjistratja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	info@qapa-ks.org
Telefoni:	048-750-751
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr 35/2020 Data aprovimit: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi përmban 8 orë / 1 ditë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e karrierës, Mësimdhënës i avancuar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Në program synohet të përfshihen të gjithë mësimdhënësit që I plotësojnë kushtet dhe në grup trajnimi të ketë jo më shumë se 25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Mësimdhënës do të jenë te aftë të: Përdorin platforma të ndryshme online të mësimdhënies Kombinimine mësimdhënies online me atë fizik (face to face) Aplikimin e metodologjive të ndryshme të mësimdhënies përmes platformave online Avancimin e mësimdhënies online (si atraktive për nxënësit dhe studentet) Të përdorin nëpër shkolla platforma të ndryshme online të mësimdhënies Të gjejnë dobesitë e metodologjise adekuate përmes platformave online Të evidentojnë metodologjitë e caktuara që kanë pike të forta online aplikimin Të ngriten një hap më lartë drejt digjitalizimit të shkollave dhe procesit mësimor Të gjejnë vështirësi dhe përparësi në arritjen e objektivave të procesit mësimor përmes platformave online.
Përmbajtja:	Platformat online të mësimdhënies do të analizohen dhe kuptohen nën prirjen e mësimdhënësve. Duke nxjerrë në pah mangësitë, përparësitë dhe të gjitha specifikat e platformave të tilla në procesin e mësimi. Trajnimi siguron që të ruhen cilësitë e procesit të mësimi, dhe arritja e objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mësimdhënës do të jenë në gjendje që të gjejnë modalitetin e vetë të punës për të ofruar veten maksimalisht përmes platformave online. Metodologjia e tyre do të jetë primare

edhe ne platformat online te mesimdhenies, dhe se ata do te jene ne gjendje qe te gjejne modalitete te punes me metodologjine qe ata e shohin te rruges dhe te rendesise ne arritjen e objektivave te procesit te mesimit.
Te gjithë mesimdhenesit, profilet e tyre, dhe se te gjitha metodologjite e tyre gjejne zbatim permes platoformave online.

Metodat e realizimit të programit

Zhvillimi i trajnimit do të udhëhiqet me thënien e më sipërme të psikologut të shquar *KurtLevinit*. Gjatë trajnimit 50% e kohës do të jetë punë teorike dhe 50 % e kohës praktike

Ligjërime
Pune individuale dhe Pune ne grupe
Studime rasti
Demonstrim praktik
Diskutim

Certifikimi

Cdo trajnim do te kete mentorim nga nje perfaqesues I Edumen,
Cdo trajnim do te incizohet
Pjesmarresit ne trajnime do te reflektojne per trajnimin permes pyetesorit qe do te kete pyetje konkrete per:
Saktesin e trajnimit
Mesimdhenesin
Metodologjine e perdorur
Cilesine
Diskutimin
Pjesemarrja ne diskutim
Atraktiviteti I ligjerates dhe trajnimit
Gjate trajnimit, trajneret monitorojne dhe vleresojne perfshirjen e pjesemarrësve ne diskutime gjate pjeses se debatimit per rastet konkrete te paraqitura si pjese e zbatimit praktik. Trajneri vlereson analizen dhe qendrimin kritik te pjesemarrësve per rastet e paraqitura si pjese e ushtrimeve duke vleresuar qendrimin kritik per rastet ne fjale. Perfshirja aktive ne debat dhe pjese praktike gjate trajnimit llogaritet deri ne 10% te pikeve gjate procesit te vleresimit.
Gjithashtu stafi i organizates monitoron procesin e trajnimit

	duke u siguruar qe trajneret zbatojne me perpikmeri agjenden e parapare dhe perdorimin e metodologjise se aplikuar gjate trajnimit. <i>Perfshirja aKtive ne debat 5%</i> <i>Pjesa praktike 15%</i> <i>Testi vlerësues 80%</i>
Trajner	Besarta Taganoviq PH D cand Kujdes shendetesor Arben Hysenaj PH D cand Psikologji Blerte Hyseni PH D cand Menaxhim shendetsor Aferdita Mustafa MSc. Edukim Shendetesor
Data	01.11.2021

suksesshëm	
Titulli i organizatës	QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Adresa:	Çagllavicë Magjistratja Prishtinë Ferizaj KM 5 Pristinë, 10000
E-mail:	info@qapa-ks.org
Telefoni:	048-750-751
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr 36/2021 Data aprovimit: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi ka 80 orë
Përfituesit:	Edukatorët, Mesimdhënësit e karrierës, Mësimdhënësit mentor, mësimdhënësit e merituar, Drejtorët e institucioneve arsimore
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i grupeve të trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 25 pjesëmarrës. Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosovës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas trajnimit të përfunduar pjesëmarrësit e përfshirë në trajnim do të jenë në gjendje: • Të njohin rregullativën ligjore për përkujdesjen dhe mirëqenien e fëmijëve. • Të njohin teoritë dhe praktikën e zhvillimit të hershëm fëmijëve. • Të aplikojnë njohuritë mbi ndikimet kulturore dhe mjedisore në edukimin e fëmijëve. • Të zbatojnë teoritë e mësimdhënies dhe nxënies në institucione të veçanta të edukimit. • Të aplikojnë praktika edukative gjatë ndihmës së edukatores në komunikimet me prinderit. • Të demonstrojnë njohuritë mbi ndryshimet psiko-sociale të fëmijëve. • Të zhvillojnë këndet private të përkujdesjes për fëmijë. • Të zbatojnë njohuritë dhe praktikën pozitive në menaxhimin e institucioneve parashkollore. • Të inkurajojnë zhvillimin e një qëndrimi profesional ndaj cilësive të edukatores/mësuesit • Vijesit aftësohen që inovacionet e fituara t'i

jetësojnë në procesin e mësimdhënies me qëllim të nxënit të suksesshëm nga fëmijët.	
Përmbajtja:	Programi i trajnimit (moduli) është projektuar për të pajisur edukatorët parashkollorë me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që ato kanë nevojë në mënyrë që të zbatojnë programin mësimor parashkollor (në këtë rast në Kosovë). Ai përbëhet nga kurset e njohurive profesionale në mësimdhënie, njohuri në terren, zhvillimin e hershëm të fëmijëve dhe të kulturës së përgjithshme. Ky program synon që edukatorët e ardhshme të zotërojnë pjesë teorike të fushës profesionale, të zbatojnë teoritë në praktika të përditshme, të mendojnë në mënyrë kritike dhe kreative si dhe të zhvillojnë shkathtësi praktike për të ndihmuar fëmijët në zhvillimin e tyre fizik, social, emocional dhe njohës. Trajnimi është përqendruar në zhvillimin profesional të edukatoreve parashkollorë, dhe njohurit do të ofrohen gjatë një periudhe një javore të trajnimit intensiv. Edukatorët tashmë në sistem, kanë nevojë për përmirësim të konsiderueshëm të cilësisë, njohurive dhe aftësive të tyre gjatë viteve të ardhshme, veçanërisht në lidhje me kërkesat e Kornizës Kurrikulare dhe të didaktikës dhe metodikën aktuale Organizimi i trajnimit sipas moduleve perkatese: 1. Koncepti themelor, Përmbajtja, Metodatat dhe Funksionet e Edukimit 2. Rëndësia e edukimit praktik 3. Roli dhe zhvillimi i edukimit praktik 4. Planifikimi dhe menaxhimi i edukimit praktik 5. Organizimi i i punës /Koncepti i organizimit 6. Dimensionet dhe analiza e rezultateve të fëmijëve të suksesshëm
Metodat e realizimit të programit	Në trajnim do të përdoren metodologjitë e më poshtme: • Mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve • Mësimdhënia algoritmike • Mësimdhënie përmes përdorimit të TIK-t Zhvillimi i Mendimit Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit,

dhe

- Mësimdhënia autentike
- Mësimdhënia kooperative dhe ndërvepruese

Angazhimi i trajnerit:

Programi do të zhvillohet përmes ligjëratave, diskutimeve, aktiviteteve në grupe të vogla dhe punës individuale. Ky do të jetë një mjedis i pasur akademik i dedikuar më tepër ndaj të nxënit përmes të bërit, sesa dhënies ekskluzive të leksioneve. Pjesëmarrësit do të jenë të angazhuar në diskutime interaktive të cilat planifikohen për reflektim dhe zbatim të pjesëve të caktuara të leximit e studimit si dhe reflektim për përvojat e tyre personale të fituara gjatë praktikës shkollore.

Puna është e fokusuar rreth mësimdhënësit dhe zgjedhjes së problemeve përmes debateve, hulumtimit, punës individuale dhe grupe.

Konteksti dhe problemi do të prezantohen në prezantime në përputhje me kohën e përshtatshme për çdo temë të paraparë në program. Realizimi dhe artikulimi i moduleve do të përcjellët me shumëllojshmëri të metodave.

Debatet paraqesin dimension të rëndësishëm gjatë trajnimeve, për tema të cilat nxisin diskutime. Por, debati gjithmonë do të përcillet me elemente të strukturuar, pjesëmarrje masive të mësimdhënësve- me role të ndryshme dhe me përgjegjësi individuale dhe grupe. Mësimdhënësit do të kenë angazhim (ngarkesë), përmes detyrave konkrete të cilat mundësojnë zgjerimin e horizontit të dijes me një përshtatshmëri më të madhe, vizitat në Qendra burimore, Klasë të bashkangjitura, Klasat inkluzive me qëllim të njohjes nga afër të fëmijëve me vështirësi të ndryshme.

Angazhimi i pjesëmarrësve:

Pjesëmarrësit do të angazhohen në aktivitete të ndryshme si lexim, hulumtim, të shkruar, prezentime dhe debate. Do të ketë aktivitete grupe dhe individuale. Aktivitetet grupe do të marrin vlerësim grupor (që do të llogaritet drejtë përqindjes së vlerësimit individual nga pjesa e aktiviteteve).

Kërkesat për punë nga pjesëmarrësit: secili kandidat duhet të lexojë materiale të obligueshme (së paku 300 faqe), dhe së paku 10 artikuj të tjerë (rreth 150 faqe) relevantë për temat e zhvilluara dhe detyrat e dhëna.

Certifikimi	Për certifikim vlerësohen: Portofoli i përgatitur (5 pikë); Vijimi i rregullt i trajnimit (5 pikë); Vizita në institucione e parapara (5) pikë; Përgjigjet e sakta në test – (30 pikë); punë praktike nga një temë nga praktika Pjesëmarrësit u nënshtrohen tre testeve që lidhen: Test mbi njohuritë e nocioneve themelore (10 pikë): Rast studimor i identifikimit 25 pike Për certifikim pjesëmarrësit janë të obliguar të krijojnë portofolin (25 pikë)
Trajner	• Prof.Dr. Armen Mustafa • Prof. dr. Saranda Shatri – Dokrore e Shkencave të Pedagogjisë, ligjëruese universitare. Ma. Trendelina Krasniqi,– Psikologe shumëvjeçare, trajnere e certifikuar. • Shukrije Lecaj, Eksperte në fushën e edukimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme
Data	01.11.2021

Titulli i organizatës	QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Adresa:	Çagllavicë Magjistrallja Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	info@qapa-ks.org
Telefoni:	048-750-751
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr 35/2020 Data aprovimit: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi përmban 16 orë / 2 ditë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e karrierës, Mësimdhënësi i avancuar Mësuesit e karrierës dhe/ose të avancuar, janë ata mësues të cilët synojnë drejtimin e institucionit arsimor dhe të cilëve u kushtohet ky trajnim. Trajnimi synon të rrisë performancën e tyre në rrafshin teorike, me qëllim njohjen me vizionin, strategjitë dhe menaxhimin e ndryshimeve në arsim. Kjo kategori mësimdhënësish, që përpigën të rriten në karrierën e tyre, kanë mundësinë që të njohin, përvetësojnë dhe të qëmtojnë në fushën e drejtimit të shkollës, aftësi të panjohura ose pak të dëgjura prej tyre.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Në program synohet të përfshihen të gjithë mësimdhënësit që i plotësojnë kushtet dhe në grup trajnimi të ketë jo më shumë se 25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Mësimdhënësit do të jenë të aftë të: -Njohja me modelet bashkëkohore të vizionit të drejtimit të shkollës, duke mësuar modelet e shkrimit të një vizioni; -Hartimi i strategjive tip, për drejtimin e shkollës; -Rregullat ku bazohet një menaxhim efektiv i institucionit arsimor;
Përmbajtja:	Programi i trajnimit do të tentoj të përmbushë me njohuri bazike mësimdhënësit që synojnë karrierë por edhe detyrimet që rrjedhin nga Korniza për zhvillimin Profesional të mësimdhënësve në Kosovë, 2017-2021, kur ndër të thëra, vërehet se: “Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë dhe në dokumentin Korniza për vlerësimin e performancës së shkollës, ku sipas tyre çdo shkollë kërkohet që të ketë planin vjetor të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, të realizojë zhvillimin

profesional me bazë në shkollë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe procedurat e brendshme të zhvillimit profesional me bazë në shkollë, të cilat përfshijnë: mbledhjen e të dhënave - vlerësimin e nevojave, planifikimin, zbatimin dhe raportimin lidhur me zhvillimin profesional me bazë në shkollë". Në këtë kuadër veç mësimdhënësve të avancuar apo në karrierë, mund të jenë vetë institucionet shkollore, DKA apo Inspektorati i Arsimit, që mund të kërkoj trajnime të tilla, për të njohur e përvetësuar arritjet më të fundit në: Zhvillimin e shkollës me vizion dhe strategji dhe menaxhimi i ndryshimit

Metodat e realizimit të programit

Në këtë trajnim do të përdoret si metodologji kryesore, ndërveprimi mes trajnuesit dhe nxënësit, puna konkrete përmes detyrave të shkurtra (10 minuta) për të dëgjuar mendimin e mësimdhënësve, qasjen e tyre mbi trajnimin por edhe për të parë në kohë reale rezultatet: Sa dhe si ka ndryshuar koncepti mbi zhvillimin e shkollës dhe menaxhimin e ndryshimeve, duke u nisur nga informata e fituar gjatë trajnimit.

Certifikimi

Cdo trajnim do të ketë mentorim nga një përfaqësues i Edumen,
 Pjesëmarrësit në trajnime do të reflektojnë për trajnimin përmes pyetësorit që do të ketë pyetje konkrete për:
 Saktësinë e trajnimit
 Mësimdhënësin
 Metodologjinë e përdorur
 Cilesinë
 Diskutimin
 Pjesëmarrja në diskutim
 Atraktivitetin e ligjeratës dhe trajnimit
 Gjatë trajnimit, trajnerët monitorojnë dhe vlerësojnë përfshirjen e pjesëmarrësve në diskutime gjatë pjesës së debatimit për rastet konkrete të paraqitura si pjesë e zbatimit praktik. Trajneri vlerëson analizen dhe qëndrimin kritik të pjesëmarrësve për rastet e paraqitura si pjesë e ushtrimeve duke vlerësuar qëndrimin kritik për rastet në fjalë. Përfshirja aktive në debat dhe pjesë praktike gjatë trajnimit llogaritet deri në 10% të pikeve gjatë procesit të vlerësimit.
 Gjithashtu stafi i organizatës monitoron procesin e trajnimit

duke u siguruar qe trajneret zbatojne me perpikmeri agjenden e parapare dhe perdorimin e metodologjise se aplikuar gjate trajnimit.

Perfshirja aKtive ne debat 10%

Pjesa praktike 15%

Testi vlerësues 75%

Trajner	Ndricim Mehmeti PH D Anila Beshaj Master Shkencor ne Shkenca Politike Administrim dhe Politika Publike Saranda Shatri Dr. Shkenca Sociale
Data	01.11.2021

Titulli i Programit	
Administrim, Menaxhim dhe Udhëheqje në Arsim	
Titulli i organizatës	QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit
Adresa:	Çagllavicë Magjistralka Prishtinë Ferizaj KM 5 Prishtinë, 10000
E-mail:	info@qapa-ks.org
Telefoni:	048-750-751
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr 36/2021 Data aprovimit: 17.03.2021
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi zgjat 150 orë-25 ditë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e karrierës, Mësimdhënësit mentor, mësimdhënësit e merituar, Drejtorët e institucioneve arsimore
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i grupeve të trajnuara do të bazohet në bazë të shprehjes së interesimit, ku grupet do të kenë prej 15 - 25 pjesëmarrës. Trajnimi do të zhvillohet në nivel qendror dhe nivele komunale në Republikën e Kosovës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas trajnimit të përfunduar pjesëmarrësit e përfshirë në trajnim do të jenë në gjendje : Të demonstrojnë aftësi në shpjegimin e koncepteve themelore që lidhen me menaxhimin, udhëheqjen administrimin, planifikimin strategjik, taktik dhe operacional Të demonstrojnë me vetëdije të lartë për rolin e menaxhimit, udhëheqjes dhe të administrimit në avancimin e vazhdueshëm të efektivitetit dhe të efikasitetit të institucionit parauniversitar Të demonstrojnë shkathhtësi dhe shprehi në krijimin e “ Rrjetit të Merimanges” së partneritetit me partnere të shumte vendor dhe ndërkombetare
Përmbajtja:	Konceptet themelore, çfarë duhet të jetë një udhëheqës dhe si të bëheni udhëheqës I suksesshem, pse udhëheqësi duhet të ketë ndikim, si krijohet ndikimi, etapat e menaxhimit, udhëheqjes dhe të administrimit: puna me prioritetë – çelës I suksesit, pse menaxheri, udhëheqësi dhe administrator duhet të jenë të ndërsheëm, ndryshimet positive attribute të domosdoshme të menaxhimit, udhëheqjes dhe të

administrimit: stilet e udhëheqjes: cili është roli I “ GRUSHTIT DREJTUES”: cilat janë fazat e zhvillimit të institucioneve para – universitare, cilat janë tiparet e udhëhëqësve sipas fazave të zhvillimit të institucionit.

1. Planifikimi në arsim: Konceptet, llojet, metodat; Metodatat e planifikimit rrjetor, Metodatat e Kornizes Logjike, Metodologjia e planifikimit me skenar
2. Efikasiteti dhe efektiviteti I institucioneve arsimore; Koncepti I efikasitetit, resurset njerezore, koncepti I efektivitetit- cilesise në arsim, kapitali njerëzor, kapitali I dijeve, karakteristikat e shkollës efektive, vlerësimi në arsim, kultura dhe klima shkollore
3. Menaxhimi I ndryshimeve në arsim : Koncepti I ndryshimit, ç’ mund të jetë object ndryshimi, cili mund të jenë agentët e ndryshimit, cilat janë karakteristikat e njerëzve që sjellin ndryshim, si mund të realizohet ndryshimi, fazat dhe stadet e ndryshimit.
4. Shkolla dhe komuniteti: Shkolla dhe komuniteti dy sistemi të ndërlikuara: shkolla dhe komuniteti nga këndi I Teorisë së Përgjithshme të sistemeve, ç’ ndihmë ka shkolla nga idetë dhe energjia e jashtme, krijimi I Rrjetit të Merimanges së partneritetit, nevoja për partneritet dhe partnerët e mundshëm, planifikimi I partneritetit.
5. Cilat janë detyrat e drejtorit të shkollës së shekullit XXI: Planifikimi, puna analitike studiuëse – PAS, Puna instructive- pedagogjike – PIP (me mësimdhënës, nxënë dhe prindër) : Puna këshilldhënëse e drejtorit – PKD (me mësimdhënës, nxënë, prindër dhe bashkëpunëtorë profesional) Puna në inovimin dhe avancimin e performancës së shkollës – PIAP, Bashkëpunimi e komunitetin arsimor- BKA: Avancimi profesional dhe fuqizimi I stafit shkollor- APSSh: Monitorimi, mbikqyrja, vlerësimi dhe vlerësim I performancës së shkollës dhe të arritjeve të nxënësve – MMVVPSH, Mbajtja, klasifikimi, kategorizimi dhe arkivimi I dokumentacionit pedagogjik dhe shkollor – INDOK – SISTEMI
6. Tiparet dhe veçoritë e drejtorit të suksesshëm; Veçoritë fizike dhe shëndetësore; veçoritë dhe tiparet mentale; veçoritë dhe tiparet emocionale: Veçoritë dhe tiparet konative: Veçoritë dhe tiparet sociale punues.

Metodat e realizimit të programit	Trajnim me ndërprerje gjatë ditëve të vikendit. Metoda akromatike, erotematike, demonstruese, metodologjia e zhvillimit të mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit, Metodologjia e mesimdhënieve kooperative dhe ndervepruese. Me qëllim të vlerësimit të arritjeve do të perdoren teste të standardizuara.
Certifikimi	Për certifikim vlerësohen: Portofolio e përgatitur (5 pikë) Vijimi i rregullt i trajnimit (5 pikë) Vizita në dy institucione të suksesshme 5 pikë. Përgjigjet e sakta në testin prej 200 pyetjeve- ajtemeve 40 pikë, punë praktike nga një temë nga praktike. Pjesëmarrsit u nënshtrohen tri testeve që lidhen me personalitetin 10 pikë: Vlerësimi i personalitetit, vlerësimi i sjelljeve me lokus të brendshëm dhe testit për tipat e personalitetit bazuar në sjellje 5 pikë. Për certifikim pjesëmarrësit janë të obliguar në portofol të vendosin edhe Fjalorthin- Glosarin.
Trajner	• Prof. Halim Hyseni – Pedagog, eksperti më i njohur kosovar, autor i shumë librave, trajner i certifikuar. • Prof. dr. Saranda Shatri – Doktore e Shkencave të Pedagogjisë, ligjëruese universitare. • Fahrije Latifi Retkoceri – Pedagoge shumëvjeçare, trajnere e certifikuar • Jonuz Salihaj – Profesor
Data	01.11.2021

Titulli i Programit	
Titulli i organizatës	Revolucioni
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	OJQ Revolucion
Adresa:	Suhareke, "Hajdin BERISHA"
E-mail:	Revolucioni@outlook.com
Telefoni:	049 319 833.
Numrat dhe data e aprovimit:	29-2021. 17.03.2021. Aprovohet për dy vite.
Kohëzgjatja e programit(orë)	32 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e tri niveleve të arsimit parauniversitar (klasat 1-12), për secilën lëndë. Duke marrë parasysh se të gjithë mësimdhënësit e klasave 1-12 punojnë me programe lëndore dhe KB dhe nga ta kërkohet vlerësim i vlefshëm dhe i besueshëm, ky program trajnues do ti ndihmojë ata të zhvillojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për vlerësimin e arritjeve të nxënësve sipas dokumenteve që kërkohen nga politikat dhe dokumentet arsimore të Republikës së Kosovës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	<i>Përmes këtij programi trajnues mësimdhënësit:</i> - zhvillojnë njohuritë rreth kërkesave të KKK për vlerësimin e nxënësve; - zhvillojnë shkathtësitë rreth zbërthimit të rezultateve lëndore dhe hartimit të rezultateve të nevojshme gjatë një ore mësimore; - identifikojnë instrumentet më të përshtatshme për vlerësimin e rezultateve të caktuara të arritjes së nxënësve; - përcaktojnë saktë kriteret e suksesit për rezultatet e të nxënësve; - bëjnë lidhjen ndërmjet rezultateve nga programet lëndore me kompetencat e përcaktuara për shkallë të kurrikulës; - përgatisin instrumente dhe kritere për vlerësimin e rezultateve të kompetencave për shkallën e caktuar; - realizojnë një vlerësim të drejtë, të saktë dhe të

	besueshëm.
Përmbajtja:	Programi trajnues parashihet të realizohet me mësimdhënës si vijon: Dita 1: - Ligjëratë nga trajneri rreth vlerësimit të nxënësve sipas KKK-së; - diskutim i orientuar përmes pyetje rreth sfidave të pjesëmarrësve gjatë vlerësimit të nxënësve; - prezantim nga trajnerët rreth përzgjedhjes dhe formulimit të rezultateve gjatë përgatitjes së planeve për orë mësimore; - punë në grupe e mësimdhënësve në realizimin e këtyre aktiviteteve; - prezantime nga mësimdhënësit dhe diskutim plenar. Dita 2: Ligjëratë nga trajnerët rreth përcaktimit të kriterëve për matjen e arritjes së rezultateve dhe përgatitja e instrumenteve për vlerësim. – përcjellja e ligjeratave edhe me mini debate rreth instrumenteve të përdorura më heret nga mësimdhënësit; -punë në grupe rreth hartimit të instrumenteve për vlerësim dhe kriterëve të suksesit gjatë orës mësimore dhe - prezantimi i punës grupore dhe diskutim e debate rreth punës së secilit grup. Dita 3: Prezantim nga trajnerët rreth ndërlidhjes së rezultateve nga programet lëndore me rezultatet e përzgjedhura për kompetenca, si dhe diskutim i hapur me pjesëmarrësit rreth mënyrës së realizimit më pare nga ta. Punë në grupe dhe prezantim i tyre pas çdo seance. Dita 4: Prezantime të secilit mësimdhënës rreth detyrave të dhëna. Këto detyra përfshinë: njësi mësimore me rezultatete përzgjedhura, të zbërthyera, kriteret e suksesit, si dhe mënyrën e vlerësimit për atë njësi mësimore, si dhe përzgjedhja e rezultateve të kompetencave për njësi mësimore dhe mënyra e vlerësimit të tyre (grumbullimi i dëshmimeve). Instrumentet e vlerësimit për periudha mësimore, si dhe diskutime me grupin pas çdo prezantimi.
Metodat e realizimit të programit	Ligjërime nga trajnerët. Punë në grupe e fokusuar në bashkëpunim dhe krijimtari. Punë hulumtuese (dokumente ligjore dhe strategji). Punë individuale.

Certifikimi	Kandidatet certifikohen per katër dite te trajnimit -32 ore trajnimi.
Trajner	5
Data	Shkurt 2021

Titulli i Programit	Kujdesi dhe zhvillimi gjatë fëmijërisë së hershme
Titulli i organizatës	Save the Children International, Organizate joqeveritare ndërkombëtare
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Save the Children International
Adresa:	Rr. Gazmend Zajmi Nr.1, 10000 Prishtinë, Kosovë
E-mail:	scik@savethechildren.org
Telefoni:	+383 38 232 691
Numrat dhe data e aprovimit:	50/2021 30.08.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	42 orë trajnimi (7 module trajnimi një-ditor me nga 6 orë)
Përfituesit:	Edukatorët e arsimit parashkollor dhe klasave parafillore që punojnë me fëmijët e moshës 0-3, 3-5 dhe 5-6 vjeç.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas përfundimit të programit, edukatorët do të: • Shpjegojnë specifikat e zhvillimit dhe të mësuarit e fëmijës të moshës 0-3 vjeç; • Menaxhojnë klasën duke krijuar një mjedis të organizuar, gjithpërfshirës dhe mbështetës për fëmijët; • Përdorin vëzhgimin si teknikë pune për të dokumentuar dhe pasqyruar ndryshimet e fëmijës dhe për të njohur individualitetin e gjithsecilit; • Zbatojnë instrumente të vëzhgimit për fëmijët; • Shfrytëzojnë të dhënat e mbledhura nga vëzhgimi për planifikim të aktiviteteve në interes të fëmijëve; • Zbatojnë metoda dhe aktivitete të përshtatshme dhe kreative që stimulojnë zhvillimin e fëmijës të moshës 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç; • Krijojnë dhe ofrojnë një mjedis të sigurt e nxitës që mundëson zhvillimin e fëmijës në moshës 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç; • Zgjedhin dhe krijojnë lojëra për fëmijë me materiale të riciklueshme për qëllime mësimore; • Zgjedhin, krijojnë dhe zhvillojnë aktivitete mësimore dhe lojëra të përshtatshme për hapësira të brendshme dhe të jashtme të çerdhës / kopshtit; • Shpjegojnë prindërve praktikën më të mirë të ushqyerjes me qumësht të gjirit, formulimit të ushqimit për foshnjat, si dhe ndjeshmërinë e fëmijës ndaj disa ushqimeve të caktuara; • Ofrojnë informacione sqaruese për prindërit për mënyrat e duhura të përdorimit të ushqimeve të ngurta dhe atyre të lëngëta, si dhe rreth

	përgatitjes së vakteve / shujtave për fëmijët parashkollorë; Argumentojnë sigurinë ushqimore dhe kërkesat higjienike gjatë përgatitjes së ushqimeve për foshnjat dhe fëmijët e vegjël.
Përmbajtja:	1. Moduli: Menaxhimi i klasës 0-3 Ky modul trajnimi është përgatitur për edukatorët që punojnë me fëmijët e arsimit parashkollor të moshës 0-3 vjeç. Ky material synon tu japë edukatorëve një këndvështrim të përmbledhur në lidhje me elementët kyç të menaxhimit të klasës, të tilla si: Krijimi i një mjedisi të sigurt e stimulues; Menaxhimi i disa sjelljeve tipike sfiduese tek fëmijët 0-3 vjeç; si dhe Marrëdhënia efektive dhe trajnimi i prindërve. 2. Moduli: Menaxhimi i klasës 3-6 Ky module është për edukatorët që punojnë me fëmijët e arsimit parashkollor të moshës 3-6 vjeç. Ky material synon t'u japë edukatorëve një këndvështrim të përmbledhur në lidhje me elementët kyç të menaxhimit të klasës, të tilla si: Krijimi i një mjedisi të favorshëm të nxëni; Menaxhimi i sjelljeve të fëmijëve dhe Diversiteti në klasë. 3. Moduli: Vëzhgimi dhe përdorimi i tij në vlerësimin e fëmijëve në arsimin parashkollor 0-3 Ky modul është përgatitur për edukatorët që punojnë me fëmijët e kësaj grupmoshe në çerdhe. Ky material synon tu japë edukatorëve një këndvështrim të thelluar mbi teknikën e vëzhgimit të fëmijëve, duke e futur atë në kontekstin e vlerësimit të arritjeve dhe progresit të fëmijës, apo të planifikimit. 4. Moduli: Vëzhgimi dhe përdorimi i tij në vlerësimin e fëmijëve në arsimin parashkollor 3-6 Ky modul është përgatitur për edukatorët që punojnë me fëmijët e arsimit parashkollor të moshës 3-6 vjeç. Ky material synon t'u japë edukatorëve një këndvështrim të thelluar mbi teknikën e vëzhgimit të fëmijëve, duke e futur atë në kontekstin e vlerësimit të arritjeve dhe progresit të fëmijës, apo të planifikimit. 5. Moduli: Përdorimi dhe përshtatja e hapësirave të çerdes dhe kopshtit për qëllime edukative dhe zhvillimore Ky modul trajnimi synon t'u japë edukatorëve një këndvështrim të thelluar mbi ndikimin e hapësirës në zhvillimin e fëmijëve, duke e futur edukatoren në kontekstin e "arkitektit" të një mjedisi të sigurtë e stimulues për zhvillimin e fëmijëve, që siguron marrëdhënie pozitive mes vet fëmijëve, edukatoreve dhe fëmijëve, si dhe familjeve.

	Moduli trajton nevojat e ambienteve stimuluese për fëmijët 0-3 dhe 3-6 vjeç, dhe përmes teknikave interaktive, dhe ofrimit të një sërë instrumentesh, nxit edukatorët të eksplorojnë sigurinë e mjedisit, mesazhet që duhet marrë fëmija nga mjedisi, planifikimin e një mjedisi nxitës, ndërtimin e mjedisit të sigurtë dhe të shëndetshëm, përzgjedhjen dhe organizimin e materialeve që reflektojnë interesat dhe aftësitë e fëmijëve, rregullimin e këndit të lojërave dhe aktivitetet në mjediset e brendshme dhe të jashtme, dhe përdorimin e materialeve të riciklueshme. 6. Moduli: Të ushqyerit e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç Përmbajtja e këtij moduli trajnimi përbëhet nga një varg çështjesh të cilat trajtojnë aspektet më të rëndësishme të ushqyerit të foshnjave dhe fëmijëve si dhe rëndësisë së sigurisë ushqimore dhe higjienës gjatë përgatitjes dhe shërbimit të ushqimit në institucionet e kujdesit ndaj foshnjave dhe fëmijëve të vegjël. Në mënyrë specifike dhe të detajuar trajtohet aspekti i të ushqyerit të foshnjave me qumësht të gjirit, për të vazhduar me të ushqyerit e foshnjave me ushqim të formuluar. Në mënyrë të veçantë do të trajtohet edhe futja në përdorim e ushqimeve të lëngëta dhe të ngurta si dhe përgatitja e vakteve dhe mes-vakteve për fëmijët e vegjël. Në materialin mësimor të këtij moduli, me shumë kujdes është trajtuar edhe çështja e sigurisë ushqimore dhe higjienës në parandalimin e sëmundjeve me origjinë nga ushqimi. Materiali mësimor mbyllet me informacionet që kanë të bëjnë me ushqimin e shëndetshëm, rreziqet nga ngulfatja si dhe me ndjeshmërinë (reaksionet alergjike) e fëmijëve ndaj disa ushqimeve të caktuara. 7. Moduli: Aktivitetet stimuluese për fëmijët 0-3 vjeç Ky modul trajnimi përbëhet nga pjesa teorike e cila ka për qëllim të ofrojë informata në lidhje me zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç, si dhe pjesa praktike, e cila përfshinë përshkrimin e një sërë aktiviteteve stimuluese për këtë grup moshë. Materiali ka për qëllim të njoftoj edukatorët me rëndësinë dhe format e stimulimit të fëmijëve nga lindja deri në moshën 3 vjeçare. Aktivitetet e prezantuara në modul janë organizuar sipas fushave të zhvillimit në fëmijërinë e hershme, bazuar në dokumentin Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet, hartuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës. Nëpërmjet ushtrimeve praktike të planifikuara në modul synohet që tu ndihmohet edukatorëve që gradualisht të arrijnë të kuptojnë dhe zhvillojnë aktivitete stimuluese bazuar në idetë e tyre kreative dhe t'i praktikojnë ato përgjatë punës së
--	--

	përditshme me fëmijët.
Metodat e realizimit të programit	Metodologjia që përdoret në ofrimin e programit plotësues përfshinë: • Prezantim në power-point • Stuhi mendimesh dhe diskutime • Punë në grupe • Video ilustruese me aktivitete dhe prezantime lidhur me temat e moduleve të trajnimit • Punë praktike me materiale të riciklueshme Janë përzgjedhur këto metodologji për të prezantuar njohuri të reja të cilat do të mbështesin njohuritë dhe përvojën e deritanishme të edukatorëve dhe për të krijuar një atmosferë interaktive për shkëmbimin profesional të praktikave pozitive. Përveç kësaj, përdorimi i metodologjive të kombinuara në këtë mënyrë krijon një mundësi të mirë për kombinimin e njohurive teorike me ato praktike
Certifikimi	Pjesëmarrësit të cilët do të ndjekin programin e trajnimit do të pajisen me certifikatë e pjesëmarrjes, duke specifikuar numrin e orëve që pjesëmarrësi ka ndjekur trajnimin.
Trajner	• Rodika Goci (modulet 1-5) • Agim Rysha (moduli 6) • Bleta Balaj (moduli 7)
Data	10.09.2021

Titulli i Programit	Disiplina Pozitive në Mësimdhënien e Përditshme
Titulli i organizatës	Save the Children International, Organizate joqeveritare ndërkombëtare
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Save the Children International
Adresa:	Rr. Gazmend Zajmi Nr.1, 10000 Prishtinë, Kosovë
E-mail:	scik@savethechildren.org
Telefoni:	+383 38 232 691
Numrat dhe data e aprovimit:	50/2021 30.08.2021
Kohëzgjatja e programit (orë)	24 orë (4 ditë trajnimi nga 6 orë)
Përfituesit:	Edukatorët e nivelit parashkollor Edukatorët e klasave parafillore Mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta Mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Rezultatet e programit synojnë që: • Të sigurohet një alternativë e vlefshme dhe efektive për ndëshkimin fizik dhe emocional. • Të rritet njohuria e mësuesve/edukatorëve për të drejtat e fëmijëve në një mënyrë jo kërcënuese. • Të sigurohen mjete konkrete dhe konstruktive për zgjidhjen e konfliktit mësues/edukator-fëmijë.
Përmbajtja:	Pasiqë programi bazohet në zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve, edukatorë/kujdestarë efektiv dhe në parimet e të drejtave të fëmijëve, ky program i mëson fëmijët dhe i drejton sjelljet e tyre, duke respektuar të drejtat e tyre për zhvillim të shëndetshëm, mbrojtje nga dhuna dhe pjesëmarrje në të mësuarit e tyre. Disiplina Pozitive mund të përdoret nga lindja e fëmijes e deri në moshën madhore, prandaj përmbajtja e tij është e përshtatshme për edukatorët/mësuesit e moshave 0-18. Bazuar në Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë, programi i përgjigjet të mësimdhënësve të nivelit fillestar në fushat dhe pikat përkatëse vijuese për zhvillim profesional: Fusha 2. Njohuritë profesionale dhe të kuptuarit Treguesi 2.1. E kupton zhvillimin fizik social dhe intelektual të nxënësve dhe e promovon mësimin gjatë gjithë jetës; Treguesi 2.3 I trajton të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe me

	respekt; Treguesi 2.4 Krijon mjedis mësimor të sigurtë dhe mbështetës, i cili i inkurajon nxënësit që të bëhen persona që i zgjidhin problemet, që janë vendimmarrës, që mësojnë gjatë tërë jetës dhe që bëhen pjesëtarë të dobishëm të shoqërisë; Treguesi 3.4 Zotëron strategji të ndryshme për menaxhimin e klasës. Fusha 4. Mësimi dhe angazhimi profesional 6.2. Përdor mësim të ri profesional për ta përmirësuar praktikën e mësimdhënies; 6.4. I përshtat dhe përmirëson praktikën e mësimdhënies përmes nxënies dhe reflektimit; 7.2. Komunikon në mënyrë efektive me nxënësit, mësues/edukatorë dhe kolegë.
Metodat e realizimit të programit	Ky program trajnuar ofrohet përmes përcaktimit të objektivave për secilin sesion. Organizimi i sesioneve mund të bëhet ashtu që të jepen nga dy sesione në ditë (3 orë gjithsej) dhe të përfundojë në 4 javë kronologjike, si dhe një javë shtesë pas 3.5 muajsh për ofrimin e pyetësorit përcjellës, i cili synon të ndërlidhë arritjen e objektivave. Pjesëmarrja e mësimdhënësve në sesione organizohet përmes përdorimit të librit të punës, i cili udhëzon pjesëmarrjen sipas radhës kronologjike të çështjeve lidhur me aspektet zhvillimore që nga lindja e deri te adoleshenca e fëmijës. Metodologjia përfshin prezantimin e përmbajtjes përmes leksioneve, punë simuluese në grupe, raste studimore, kuize, diskutim në grupe dhe diskutim plenar. Programi bazohet në hulumtime shkencore të zhvilluara mbi zhvillimin e shëndoshë të fëmijëve, mësimdhënie efektive dhe të bazuar në parimet e të drejtave të fëmijëve. Programi ka gjithsej tetë sesione dhe në fund të programit, mësimdhënësit marrin certifikatë të pjesëmarrjes. Sesionet mbahen një ose dy herë në javë dhe orari bëhet në bashkëpunim me pjesëmarrësit. Madhësia ideale e grupit për sesionet e programit është nga 14 deri në 16 pjesëmarrës.
Certifikimi	Pjesëmarrësit të cilët do të ndjekin programin e trajnimit do të pajisen me certifikatë të pjesëmarrjes, duke specifikuar numrin e orëve që pjesëmarrësi ka ndjekur trajnimin.
Trajner	Valid Zhubi
Data	10.09.2021

Titulli i Programit		Planifikimi dhe Udhëheqja Strategjike në Arsimin Parauniversitar	
Titulli i organizatës	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)		
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues		
Ofertuesi i programit:	SBASHK		
